



STRATEGJIA TERRITORIALE E NJËSISË VENDORE KUKËS

**Draft – Varianti Nr.3
10 Mars 2016**

Tiranë - Kukës
Mars 2016



Ky publikim është përgatitur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp), me mbështetjen financiare të Agjencisë Zvicerrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Përgatitur nga:

1. Jolanda Trebicka – Drejtuese Ekipi /Analiza Ekonomike
2. Besar Zifla – Analiza e Zhvillimit Urban dhe të Sistemeve bazë
3. Olti Belliu – Koordinator Faza II / Analiza dhe përpunimi i të dhënave statistikore
4. Edvin Puka – Analiza e Infrastrukturës Vendore
5. Alda Duraj – Analiza Demografike/Sociale
6. Tresi Trebicka – Analiza Mjedisore dhe Turizmi
7. Ina Beqo – Analiza e Sektorit Social
8. Magi Apostoli – Koordinatore Faza I / Përpunimi i të dhënave statistikore
9. Vera Isterli – Kordinatore Lokale
10. Adriana Bela – Eksperte Lokale



EuroPartners Development , Tiranë

Mbështetur nga:

Valbona Karakaçi, Elvin Hoxha

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

HELVETAS Sëëëiss Intercooperation, Shkodër, Albania

Ky publikim reflekton mendimet e autorëve dhe jo detyrimisht të SDC.

Publikuar nga:

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

HELVETAS Swiss Intercooperation (HSI) Albania

Rr. Oso Kuka, Nr. 11,

4000 Shkodër, Albania

www.dldp.al



Funded by



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confederation suisse
Conderazione Svizzera
Confederaziun svicra

**Swiss Agency for Development
And Cooperation SDC**



HELVETAS
Swiss Intercooperation

ALBANIA



Tabela e Lëndës

SHKURTIME	5
1 HYRJE	6
2 PARASHIKIMET QË RRJEDHIN NGA PLANI PËRGJITHSHËM KOMBËTAR	6
2.1.1 Përshkrim i përgjithshëm	6
2.1.2 Bashkia Kukës në kontekstin Ballkanik	7
2.1.3 Bashkia Kukës në kontekstin rajonal	9
3 ANALIZA METABOLIKE	11
3.1 Analiza e përgjithshme të gjendjes ekzistuese të territorit	11
3.1.1 Pozicioni Gjeografik dhe karakteristikat kryesore	11
3.1.2 Ndarja administrative	13
3.2 Analiza e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë	14
3.3 Elementët kryesorë mjedisorë dhe problemet mjedisore	15
3.4 Zhvillimi rajonal dhe tiparet kryesore të ndërveprimit	16
3.4.1 Profili Ekonomik dhe Karakteristikat Kryesore të Zhvillimit	17
3.4.2 Karakteristikat Kryesore të Bujqësisë - si sektori kryesor ekonomik i zonës	18
3.4.3 Turizmi -potencialet dhe sfidat kryesore të zhvillimit	22
3.4.4 Minierat	24
3.5 Analiza dhe vlerësimi i problematikave sociale	26
3.5.1 Kohezioni Social	26
3.5.2 Situata e shëndetit publik	27
3.5.3 Edukimi	27
3.5.4 Tregu i Punës dhe Struktura e tij	28
3.5.5 Situata Socio-ekonomike e Grave	29
3.6 Demografia	29
3.6.1 Popullsia, Tendenca e Lëvizjeve, Migrimi	29
3.6.2 Struktura e Popullsisë	31
3.7 Strehimi	31
3.8 Infrastruktura	32
3.9 Infrastruktura Aeroportuale	32
3.10 Telekomunikacioni	33
3.11 Elektriciteti	33



3.12	Ujësjellës-Kanalizime	33
3.13	Analiza e pronave publike	34
	Hapsirat publike	34
3.14	Analiza e marrëdhënieve të pronësisë mbi tokën.....	35
3.15	Objektet e rëndësisë kombëtare	37
3.16	Analiza e elementeve të rëndësishme territoriale.....	38
3.17	Analiza e elementeve përjashtues	40
4	NDARJA E TERRITORIT SIPAS SISTEMEVE BAZË	42
4.1	Sistemi Urban	42
4.2	Sistemi Natyror	44
4.3	Sistemi Bujqësor	45
4.4	Sistemi Ujor	45
4.5	Sistemi Infrastrukturor	47
4.6	Tabela përmbledhëse.....	48
5	DREJTIMET E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE PROBLEMATIKAT NË BAZË TË TREGUESVE TË SISTEMEVE.....	50
5.1	Zhvillimi Urban	50
5.2	Zhvillimi Natyror	51
5.3	Zhvillimi Bujqësor	52
5.4	Zhvillimi Ujor.....	52
5.5	Zhvillimi Infrastrukturor	53
5.6	Problematikat e evidentuara	55
6	VIZIONI I ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TË NJËSISË VENDORE	56
7	OBJEKTIVAT STRATEGJIKË PËR ZHVILLIMIN E TERRITORIT TË NJËSISË VENDORE 57	
8	PLANI I VEPRIMEVE (PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE)	63
9	PROGRAMET DHE PROJEKTET KRYESORE TË ZHVILLIMIT	67
9.1	Projekte në fushën e Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban	67
9.2	Projekt – propozime në Fushën e Mbrojtjes së Ambjentit.....	71
9.3	Projekt – propozime ne fushen e Zhvillimit të Turizmit dhe Ekonomise Lokale	77



SHKURTIME

ADSL	Asymetric Digital Subscriber Line
ALUIZNI	Agjensia e Legalizimit Urbanizimit dhe integritimit të zonave/ndërtimeve informale
BK	Bashkia Kukës
Dldp	Decentralization and local development program
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISDN	Integrated Service digital netëork
ISKSH	Instituti i Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor
HEC	Hidrocentral
KTP	Kusht Teknik Projektimi - Kodi Shqiptar i Projektimit
KUZ	Kolektori i Ujërave të zeza
NE	Ndihma Ekonomike
NjA	Njësia Administrative
NJMDF	Njësia për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve
NjQV	Njësia e Qeverisjes Vendore
PIK	Plani i Investimeve Kapitale
PPK	Plani Përgjithshëm Kombëtar
PPB	Prodhimi i pergjithshëm bruto
QSH	Qendra Shëndetësore
TIK	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
UK	Ujësjiellës Kanalizime



1 HYRJE

Strategjia Territoriale e Njesisë së Qeverisjes Vendore të Bashkisë Kukës, si pjesë e integruar e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, është hartuar me një orientim sa më gjithëpërfshirës duke u bazuar në orientimet dhe parashikimet që rrjedhin nga ky plan.

Përgatitja e strategjisë u realizua si një proces gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shumtë të komunitetit të Njesisë Territoriale të Kukësit, nëpërmjet Forumit Qytetar¹ të cilët kontribuan që në fazën fillestare të analizave dhe diskutimeve mbi situatën ekonomike sociale të zonës si dhe orientimet e zhvillimit të saj në të ardhmen.

Strategjia e Zhvillimit dhe Plani Vendor I Zhvillimit të Bashkisë së Kukësit ka rëndësi thelbësore për sa i përket 15 viteve të ardhshme të administrimit territorial, për të siguruar zhvillimin e një territori sa më funksional i cili të mundësojë e lehtësojë maksimalisht zhvillimin ekonomik e cilësinë e jetës së komunitetit.

2 PARASHIKIMET QË RRJEDHIN NGA PLANI PËRGJITHSHËM KOMBËTAR²

2.1.1 Përshkrim i përgjithshëm

Bashkia Kukës, për shkak të pozicionit gjeografik, përfshihet dhe trajtohet vetëm në Planin e Përgjithshëm Kombëtar, ndër tre instrumentat e planifikimit në nivel kombëtar që janë në fazë përgatitjeje³.

Strategjia e zhvillimit të territorit e bashkisë Kukës, është hartuar duke bazuar në kornizën strategjike që përcaktohet në dokumentin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar (PPK) 2015-2030, për zhvillim afatgjatë e cilësor të territorit:

- sigurimin e zhvillimit të balancuar ekonomik e social të vendit,
- menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore të tij,
- mbrojtjen e mjedisit, ndërkohë që siguron përdorimin racional të tokës .

Objektivat dhe vizioni i kësaj strategjie gjithashtu orientohet dhe nga objektivat e PPK për të siguruar një zhvillim të territorit, e parë jo vetëm nën këndvështrimin lokal të zhvillimit, por edhe në një kontekst më të gjërë, të karakterit ndërkufitar dhe rajonal.

Gjithashtu, vizioni kryesor i përcaktuar nga PPK për zhvillimin e vendit tonë i cili është: ***“Shqipëria një qendër e integruar në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor European, një***

¹ Forumi Qytetar u ngrit në kuadër të hartimit të Programit të Zonës Funksionale të Kukësit , i financuar nga projekti dldp duke vepruar në mënyrë aktive për një përiudhë 11 mujore Korrik 2014 - Maj 2015.

² Parashikimet dhe referencat e këtij kapitulli janë bazuar në draftin final të PPK vënë në dispozicion në faqen zyrtare të Ministrisë së Zhvillimit Urban

³ Plani i Përgjithshëm Kombëtar, bazuar në Ligjin 107 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, është instrumenti më i lartë i planifikimit hapësinor e territorial, për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit.

ekonomi e shumëllojshme dhe konkurruese në hapsirën Ballkanike, një shtet që synon barazinë në akses, infrastrukturë, ekonomi dhe dije. Mbrojtje të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore me synimin për t'u shndërruar në një destinacion unik" ka qenë edhe vizioni udhëheqës në hartimin e kësaj Strategjie.

2.1.2 Bashkia Kukës në kontekstin Ballkanik


Bashkia Kukës përfshihet në korridoret e mëposhtme kryesore strategjike të zhvillimit⁴:

- **Bashkia Kukës në korridoret e transportit**

Rruga e Kombit dhe pozicioni gjeografik e përfshijnë Bashkinë e Kukësit në një nga korridoret kryesore të transportit dhe komunikimit me vendet e rajonit dhe më gjërë me Europën Qendrore dhe Lindore. Investimet që po kryhen në 7 urat e aksit kombëtar Kukës – Morinë, përmbyllin realizimin e një investimi mjaft me vlerë për lidhjen e Kosovës dhe të rajonit më gjërë me pjesën përendimore-bregdetare të vendit me një rrugë me standarde të larta.

Gjithashtu një pikë e fortë e zhvillimit të Bashkisë përsa i përket infrastrukturës kombëtare të transportit është dhe përfshirja në PPK e Aeroportit të Kukësit si një ndër tre aeroportet kryesore të vendit tonë. Pavarsisht infrastrukturës pothuajse të përfunduar të këtij aeroporti, ai nuk është vënë asnjëherë në eficiencë për shkak të kontratës mes Qeverisë Shqiptare dhe grupit “Hotchief” që ka marrë me koncesion Aeroportin “Nënë Tereza” të Rinasit dhe ka ekskluzivitetin e aeroportit ndërkombëtar deri në vitin 2025. Qeveria shqiptare po përpiqet së fundmi përmes negociatash politike dhe teknike, që të zhbllokojë këtë ngërç dhe të vendosë në funksionim të plotë këtë aeroport. Ky zhvillim, i kërkuar mjaft dhe nga Qeveria e Kosovës, përveç përfitimeve direkte që do të ketë Bashkia do ndikojë mjaft dhe në zhvillimin e një nyje të rëndësishme të rajonit Shqipëri Veriore – Kosovë.

Harta 1: Korridoret kryesore të zhvillimit të transportit



⁴ PPK percakton 4 korridort kryesore strategjike të zhvillimit, të cilat sipas tipologjisë dhe rëndësisë strategjike janë përcaktuar: (i) Korridore të Transportit; (ii) Korridoret Natyrore; (iii) Korridoret Energjetike dhe (iv) Korridoret e Komunikimit

• Bashkia Kukës në Korridoret Natyrore

Në hartën në vijim të pjesës Veriore dhe Qendrore të Shqipërisë janë paraqitur në trajtë skematike korridoret dhe akset kryesore ekzistuese dhe të propozuara nga PPK. Siç konstatohet aty, në Bashkinë Kukës kalon dhe një prej korridoreve kryesore natyrore, ai i Itinerarit të Brezit të Gjelbër European.

Ne territorin e Bashkisë kalon lumi Drin me dy degët e tij, me një sipërfaqe ujëmbledhëse totale prej 25022 km² dhe baseni i Liqenit të Fierzës me sipërfaqe 72.5 km². Këto dy element natyrorë sëbashku me luginat e pyllëzuara ofrojnë ndër peisazhet më të bukura malore të vendit tonë.

Harta 2: Infrastrukturat bazë sipas PPK



.Një seri monumentesh natyrore me karakteristika unike bëjnë që kjo zonë të përfshihet në Korridoret kryesore natyrore të vendit tonë.

• Bashkia Kukës në korridoret energjetike

Në kontekstin Ballkanik roli i Shqipërisë si një Qendër Ndërlidhëse për infrastrukturën dhe Energjinë vizualizohet qartë. Lidhja Strategjike përmes projektit të Gazsjellësit Trans-Adriatik me partneret tanë në rajon (kryesisht me Italinë dhe Greqinë) tashmë rrit gjithnjë e

më shumë vlerat gjeo-politike dhe strategjike të vendit tonë përse i përket sektorit të zhvillimit energjetik mbarë europian.

Siç përcaktohet tashmë dhe në dokumentat strategjike europiane me fokus zhvillimin energjetik, një degë e korridorit të Gazsjellësit Adriatik – Jonian (IAP – Ionian - Adriatic Pipeline) kalon dhe nga Kosova. Ky fakt e përfshin Bashkinë Kukës edhe në një nga korridoret kryesore energjetike të vendit tonë dhe të rajonit në tërësi.

Gjithashtu kaskada e lumit Drin që kalon në këtë Bashki përbën një element mjaft me rëndësi si në aspektin energjetik ashtu edhe për vlerat e larta natyrore që mbart. (shih hartën 2 më lartë)

2.1.3 Bashkia Kukës në kontekstin rajonal

Bazuar në Planin e Përgjithshëm Kombëtar, tre janë tipet e rajoneve kryesore përcaktuara:

- Rajone ndërkufitare
- Rajone ekonomike kombëtare
- Rajone kombëtare të specializuara

- **Rajonet Ndërkufitare**

Ndarja në **Rajonet ndërkufitare** burojnë nga politikat e kohezionit të Komisionit Europian dhe asistencën që jepet në kuadër të instrumentit të asistencës së Bashkimit Europian IPA⁵. Ndër katër programet e bashkëpunimit ndërkufitar ku merr pjesë Shqipëria⁶, Bashkia e Kukësit përfshihet në zonat përfituese të programit të IPA CBC Shqipëri-Kosovë.

Rajoni Kukës-Prizren ka patur lidhje të forta historike dhe tregëtare. Ndërtimi i rrugës së Kombit vitet e fundit është një indikator i mirë për zhvillimin e mëtejshëm të këtij rajoni. Potencial për zhvillimin e këtij rajoni është zhvillimi turistik dhe kulturor, shkëmbimi tregëtar në produktet bujqësore komplementare.

Harta 3: Zonat përfituese të Programit IPA CBC Shqipëri Kosovë



- **Rajonet Ekonomike Kombetare**

Në bazë të parashikimeve të PPK si Rajon Ekonomik Kombëtar aktualisht performon vetëm rajoni ekonomik Tiranë Durrës, por PPK në bazë të zhvillimeve të pritshme deri në 2030

⁵ Bazuar në Rregulloren e EU (EC) No 1085/2006 të 17 Korrikut 2006 mbi themelimin e Instrumentit të Asistencës së Para-Aderimit (Pre-Accession Assistance (IPA)), e cila përfshin komponentin e II IPA Cross –Border Cooperation.

⁶ Vetëm për periudhën 2014-2020 nga programi IPA CBC Shqipëri - Kosovë do të përfitohet Fondi IPA 8.400.000 €




koncepton fuqizimin dhe ngritjen edhe të 6 rajoneve të tjera me rëndesi kombëtare. (shih hartën 4 më poshtë)

PORTAT E VERIUT

Bashkia Kukës përfshihet tek Porta e Veriut e përbërë nga Rajoni Shkodër - Lezhë dhe Rajoni Kukës – Has – Tropojë

Profili kryesor i zhvillimit në bazë të PPK është:

Harta 4: Rajonet Ekonomike në Zonën Veriore



Transport – Turizëm – Ekonomi Strategjike

Ndër zhvillimet strategjike kryesore që parashikohen nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar dhe prekin Bashkinë Kukës mund të përmendim:

- Zhvillimi i portit të peshkimit dhe portit turistik të Shëngjinit si pjesë e lidhjeve të reja funksionale me bashkinë Lezhë dhe qendrat lokale përreth, por edhe atraksion i rajonit Kukës –Has –Tropojë dhe Kosovë.
- Akses i për ne rajonin turistik malor verior të Alpeve Shqipëtare, projekt ndërkufitar ndërmjet tre shteteve Shqipëri, Mal i Zi dhe Kosovë; Majat e Ballkanit
- Zhvillimi i projektit për “Transport Ujor Liqenor” në liqenet artificiale Koman Fierzë por jo vetëm, vlerësuar si parku energjitik me i madh i vendit me vlera të larta peisazhistike natyrore.
- Fasha kombëtare Energjitike liqeni i Vaut të Dejës, Fierzës, Komanit
- Zona të pasura minerare për nxjerrjen dhe përpunimin e kromit dhe të bakrit

3 ANALIZA METABOLIKE

3.1 Analiza e përgjithshme të gjendjes ekzistuese të territorit⁷

3.1.1 Pozicioni Gjeografik dhe karakteristikat kryesore


Bashkia Kukës (BK) me qendër qytetin e Kukësit, ndodhet në një shtrirje gjeografike në verilindje të Republikës së Shqipërisë dhe zë 2% të sipërfaqes totale të vendit.

Kukësi është një qytet në kufi me Prizrenin (Kosovë) ndërsa në brendësi të territorit shqiptar, ai kufizohet me qytetin e Peshkopisë në jug, Pukës në perëndim dhe Hasin në veri. Qyteti i Kukësit është qendra administrative e Bashkisë së Kukësit, dhe qendra më e rëndësishme administrative e Qarkut Kukës. .

Relievi i territorit të Bashkisë Kukës është kryesisht malor. Në këtë zonë shtrihet Mali i Gjallicës dhe Mali i Koritnin, të cilët janë pjesë e Vargmalit të Korabit. Ndërsa Lugina e Drinit dallohet për relievin shumë të ashpër dhe grykat e ngushta, në të cilat janë ndërtuar digat e hidrocentraleve të mëdha. Shtrirja e një pjese të Vargut të Korabit në këtë zonë thekson karakteristikën e saj si zonë malore, ku vendbanimet arrijnë deri në rreth 1400 m lartësi.

Në zonën e Kukësit shtrihet një pjesë e liqenit

Harta 5: Harta Fizike e Bashkisë së Kukësit



⁷ Ky kapitull bazohet në të dhënat e r



të Fierzës, që është dhe liqeni më i madh artificial në Shqipëri. Gryka e Morinit, nëpër të cilën kalon rruga për në Prizren, e bën këtë zonë një lidhëse me Kosovën.

Gjeomorfologjia e zonës. Ngritjet e reja tektonike diferencuese kanë përcaktuar tipologjinë primare të morfologjisë të zonës. Relievet kufizuese nga perëndimi dhe juglindja kanë ndryshime të rëndësishme morfologjike ndërmjet tyre dhe janë asimetrike, dhe kjo ndodh kryesisht për shkak të ngritjeve diferencuese neotektonike. Në lartësinë 600-800 m, vëmë re formimin e një strukture të ngritur. Në zonën Juglindore bien në sy dy gryka: Gryka e Vanave dhe Kanioni i Bicajve.

Përbërja Gjeologjike. Ky rajon është i përbërë nga tre lloj depozitimesh⁸: (i) Depozitime deluvialo-proluviale Q4dl-pr; (ii) Depozitimet Pliokuaternare N2-Qp; (iii) Depozitimet Gëlqerore të kretakut Cr1. Prerje të qarta të këtyre depozitimeve janë takuar në të dyja anët e qytetit të Kukësit gjë që flet qartë për uniformitetin e përhapjes së tyre. Vetitë fiziko - mekanike janë shumë më të mira se shtresa e mësipërme.

Hidrografia: pasuritë ujore: Rrjedhjet ujore kryesore që formojnë rrjetin hidrografik të Kukësit janë: lumi Drin i Zi, lumi Drin i Bardhë, lumi i Lumës dhe përroi i Tërshenicit. Liqeni i Fierzës që është një liqen artificial i krijuar në luginën e lumit Drin.

Tabela 1: Të dhënat hidrike të zonës së Kukësit

Lumenjte	Gjatesia (km)	Sip. E pellgut (km ²)	Norma e rrjedhjes(m3/s)	Vëllimi i rrjedhjes ne %
Drin i Bardhe	134	4964	68.2	2.151
Drin i Zi	149	5885	118	3.721
Drin i bashkuar	685	14173	352	11.110

Rrjedhjet vjetore shfaqen me cikle në vazhdimësi të ndryshme nga 2-3 vjet e deri në më tepër se 100 vjet ndryshimet e të cilës ndodhin në radhë të parë nga ndikimi i faktorëve klimatikë, kryesisht i reshjeve atmosferike dhe i temperaturës së ajrit. Faktorët e tjerë fiziko - gjeografikë me përjashtim të rasteve të ndërhyrjeve në to të njeriut, kanë luhatur më të ngadalshme dhe vijnë fill pas ndryshimeve klimaterike⁹. Pa dyshim në madhësinë e koeficientit të ndryshueshmërisë së rrjedhjes vjetore, një rol të madh luan liqeni i Ohrit, sipërfaqja ujëmbledhëse e të cilit, bashkë me liqenin e Prespës, përbën rreth 50% të sipërfaqes ujëmbledhëse të Drinit të Zi.

Baseni i Liqenit të Fierzës furnizohet nga dy lumenj, Drini i Zi dhe Drini i Bardhë. Ky liqen shtrihet nga Fierza deri në Kukës, madje ai futet edhe në luginën e Drinit të Bardhë në zonën e Rrafshit të Dukagjinit. Sipërfaqja e tij është 72.5 km² dhe vëllimi i tij është 2.7 miliardë m³ ujë. Ai ka një thellësi prej 128 metrash dhe një formë shtrirjeje zig zake në përputhje me konturet e luginës kryesore.

Është e rëndësishme të theksohet se Kukësi është një territor me pasuri të mëdha hidrike. **Prandaj duhen patur parasysh në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor zonat që përmblyten ose janë në regjim kënetor.**

Situata Hidrogeologjike. Duke u bazuar në studimin hidrogeologjik, zonën në të cilën bën pjesë Bashkia e Kukësit e klasifikojmë në dy komplekse ujëmbajtëse.

- Kompleksi i parë që përbëhet nga shkëmbinjtë e shkrifët (poroz) ose **Kompleksi kuaternar (a)** Me ujëmbajtje të lartë alQh2, i cili shtrihet në zonën buzë lumit të

⁸ Në bazë të studimeve të kryera si dhe regjistrimet e bëra nga skarpitet artificiale të hapura për rrugën Durrës-Morinë.

⁹ Kështu periudha deri në vitin 1960 ka qënë në përgjithësi me më pak ujë se periudha në vijim të saj ku prurjet kapin një mesatare prej 300 m³ në sekondë.



Lumës dhe përfaqësohet nga zhavorr e zhurë ujëmbajtëse me trashësi 2 deri në 5 metra dhe (b) me ujëmbajtje mesatare deri të ulët. Ujëmbajtja është e vogël, nga 0.06 – 1.21 l/sek. por takohen edhe dy burime me debit të madh. I pari ndodhet në fshatin Kënetë dhe përfaqëson një grup burimesh që dalin në një zonë mocalore me debit të përgjithshëm 20-30 l/sek ndërsa burimi i dytë del në fshatin Bushat dhe ka një debit 3 l/sek. Të dyja burimet kanë ushqim anësor dhe nga gëlqerorët e Triasikut të sipërm dhe kanë një kuotë respektive absolute 275 dhe 325 metra dhe (c) Me ujëmbajtje të ulët (N2-Qp)

- i) Kompleksi i dytë që përbëhet nga **shkëmbinjtë kompakt**: (a) me ujëmbajtje të lartë ku janë monitoruar dy burime të fuqishme ujore, ai i Gurrës dhe i Kolosjanit, si dhe burimi i Lomjes.; (b) Me ujëmbajtje mesatare deri të ulët dhe (c) me ujëmbajtje të ulët¹⁰.

Makronizimi dhe Mikronizimi Sizmik: Sipas studimeve sizmotektonike, zona e Kukësit ndodhet në brezin sizmogjen të fuqishëm Korçë – Pogradec - Peshkopi¹¹ me shtrirje veri jug. E gjithë kjo zonë është prekur drejt përsëdrejti nga ngjarje të forta sizmike e tërmete të forta që kanë prekur rajonet fqinje. Sipas hartës së rajonizimit sizmik të vëndit, Kukësi përfshihet në një zonë ku brenda 100 viteve të ardhshëm mund të priten tërmete me intensitet $I_{max}=8$ balle MSK-64 për kushte mesatare trualli¹². **Bazuar në klasifikimin e trojeve të paraqitura në tabelën 5. Fq 11, Aneksi 1 si dhe vlerave të koeficientit sizmik është e qartë se për të gjitha strukturat deri në lartësinë e tetë kateve që do të ndërtohen në qytetin e Kukësit duhet aplikuar $kE=0.16$ për të gjitha ndërtimet në trojet e kategorisë së I. $kE=0.22$ për të gjitha ndërtimet në trojet e kategorisë së II dhe $kE=0.26$ për të gjitha ndërtimet në troje të kategorisë së III.**

Boniteti i Tokave: tokat e Bashkisë Kukës karakterizohen nga këto veçori agropedologjike: (i) me nivel pjellorie të ulët; (ii) klasifikohen si toka të kategorisë së VII, sipas shkallës së bonitetit; (iii) kanë përmbajtje mesatare të elementëve kimikë dhe (iv) kanë përbërje SAR (treguesi i përbërjes mekanike të tokës)¹³. Aktualisht tokat e qytetit të Kukësit janë pjesërisht të zëna nga ndërtime informale në periferinë e qytetit të cilat janë përfshirë brenda vijës kufizuese ekzistuese të ndërtimeve. Në një masë të konsiderueshme këto janë ndërtime me dëndësi shumë të ulët ndërtimi dhe banimi, që dëshmon për një shfrytëzim jo eficient të këtyre tokave.

3.1.2 Ndarja administrative

Bashkia e Kukësit përfshin në administrimin e vet 15 Njësi Administrative (NjA). Duke u bazuar në klasifikimin e ri të zonave urbane dhe rurale, të realizuar mbas Censurit 2011¹⁴, Bashkia Kukës dallohet për karakterin e saj rural. Ajo përfshin 1 qendër urbane dhe 14 zona rurale. Nga pikpamja e madhësisë së territorit¹⁵ pjesa më e madhe e territorit i përket Njësisë Administrative Malzi, më përkatësisht 16.58% të territorit e ndjekur nga Grykë Caje me 9.97%. Ndërsa pjesën më të vogël e zë Qyteti i Kukësit me përkatësisht 1.41% të totalit të territorit të Bashkisë së Kukësit.¹⁶

¹⁰ Per te dhena me te detajuara shih Aneksin 1, fq.7

¹¹ Potenciali sizmotektonik i zonës së luginës së Drinit te Zi dhe i zonës së Kukësit, të përfshirë në zonën e burimeve sizmike Peshkopi - Korçë me $M_{max}=6.5$.

¹² Sulstarova et al.,1980—vendos emrin e studimit.

¹³ Te dhena te detatuara te bonitetit te tokave sipas seciles NjA jepen ne Aneksin 1, fq.10

¹⁴ Shih: "Një Klasifikim i Ri Urban - Rural i Popullsisë Shqiptare. Tipologjia Gjeografike e BE-së e Bazuar në të Dhënat e Rrjetit të Qelizave" INSAT Maj 2014, fq 21-22

¹⁵ Shih Aneksi 2: Tabela 1: Të dhëna mbi sipërfaqen territoriale sipas njesive administrative të Bashkisë Kukës

¹⁶ Të dhënat Bashkia Kukës, viti 2015

Harta 6: Ndarja Administrative e Bashkisë Kukës



Qyteti i Kukësit është qendra kryesore e Bashkisë Kukës, dhe më e rëndësishme si në aspektin ekonomik, administrativ, dhe atë social. Qendra të tjera ekonomike përfshijnë Bicaj, Shtiçen, Shishtavec dhe Shemri (Malzi). Pavarësisht këtyre qendrave ekonomike, Kukësi është edhe vendi ku zhvillohet aktiviteti tregtar kryesor.

3.2 Analiza e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë

Dokumentet kryesore që kanë udhëhequr zhvillimin urban të Kukësit janë kryesisht planet e zhvillimit të Qytetit të Kukësit:

(i) **Plani i Rregullimit të 1962**, i cili konstatoi vendndodhjen, orientimin në thellësi, ndarjen në lagje. Ky plan është plotësuar më vonë gjatë 1965 - 1976 me plane të tjera për të konstatuar ndërtimin e linjës së qytetit, studioi rrugët dhe plane më të detajuara për lagjet e tjera. Përveç kësaj, në atë kohë plani është zhvilluar fillimisht me fshatin Gostil, si qendër e banuar dhe ekonomike. Në vitet '90 janë bërë përpjekje për të kontrolluar rritjen e qytetit në periferinë e tij lindore.

(ii) Të gjitha detajet e qytetit kanë qenë të përfshira në **Planin e Rregullimit të vitit 1976**. Ai e ka perceptuar qytetin në 6 lagje që janë ndarë në shërbime institucionale, arsimore, kulturore dhe shëndetësore. Qendra administrative është projektuar si pjesa kryesore e qytetit në të cilën janë vendosur institucionet kryesore që dhe sot e kësaj dite vazhdojnë të jenë të tilla. Zonat spitalore dhe sportive u krijuan si një pjesë periferike të qytetit. Gjithashtu një rëndësi të madhe në këtë plan merr edhe zona industriale, që zë një sipërfaqe të konsiderueshme, e pozicionuar në periferinë veriore të Kukësit. Kjo zonë me një sipërfaqe të madhe prej 25.5 Ha është parashikuar për të funksionuar me një kapacitet prodhues dhe përpunues.

Plani nuk ishte në gjendje të reagojë në sajë të rritjes së shpejtë të popullsisë, si dhe prej ndryshimeve të shpejta të periudhës së tranzicionit. Lëvizja e lirë ka krijuar një fluks të pakontrolluar të një kërkese të papërbalueshme për strehim dhe për këtë arsye, fluksi në qytet u shoqërua nga zhvillimi i vendbanimeve joformale në periferi të qytetit. Në kuadër të procedurës për urbanizimin dhe legalizimin e ndërtimeve informale përmes periudhës 2005-2009, blloqe që ishin vende të rastit janë identifikuar, regjistruar dhe miratuar si ndërtesa të veçuara.



3.3 Elementët kryesorë mjedisorë dhe problemet mjedisore

Bashkia Kukës ofron një biodiversitet dhe klimë të pasur, dhe dallohet për pasuritë natyrore e relievin e pasur por mbi të gjitha si një zonë e pasur me burime hidrike. E veçantë është mbledhja e të gjitha derdhjeve, rrjedhave e lumenjve që derdhen në lumin Drin, e përfundojnë me bashkimin e Drinit me Bunën. Liqeni i Fierzës mbetet qendra e të gjitha rrjedhave dhe mjedisi ujqor është mjaft i përshtatshëm për zhvillimin e peshkimit. **Mbrojtja e ruajtja e mjedisit dhe biodiversitetit përbën një fokus të veçantë për Bashkinë Kukës duke e vendosur prioritetin në ruajtjen e burimeve të pasura kundrejt shfrytëzimit të tyre.** Dëmtime të dukshme në mjedis kanë të bëjnë me pyjet (shpyllëzimi e mungesa e kujdesit), ndotjen e ujit për shkak të depozitimit të mbetjeve (menaxhimi jo i duhur i mbetjeve në përgjithësi e depozitimit të tyre) në Liqenin e Fierzës, vendosja e standardeve për bujqësinë e blegtorinë, etj. Shtimi dhe përmirësimi i mjedisëve të gjelbërta është një prioritet i strategjisë për krijimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe estetik.

Zona e Kukësit edhe nga vetë pozita gjeografike ka një peisazh të veçantë turistik dhe të vetëmbrojtur, me një **biodiversitet** të pasur, i karakterizuar kryesisht nga peisazhe malore dhe livadhore. Në vecanti Qyteti i Kukësit renditet si një ndër qytetet e vetme me një kurorë të pasur të gjelbërt dhe norma e gjelbërimit është shumë e lartë krahasuar me qytetet e tjera, si dhe me një faunë të pasur me kafshë si ariu, kaprolli ujku etj. Problem për biodiversitetin mbetet gjuetia pa kriter e cila ka filluar të degradohet së tepërmi.

Ndotja e ajrit nuk përbën ndonjë problem të madh për zonën e Kukësit, falë edhe një kurore të gjelbërt të pasur dhe sipërfaqes ujore të konsiderueshme si dhe ndikimit të vazhdueshëm të erërave. Ndër burimet e vetme të ndotjes që më së shumti ndikojnë në cilësinë e ajrit në Qytetin e Kukësit mund të përmendim: (i) trafikun e automjeteve, (ii) zonën e industrisë së lehtë në veri të qytetit¹⁷ dhe (iii) djegien e mbeturinave¹⁸. Burimi kryesor i ndotjes së ajrit është edhe djegia e mbeturinave në kodrën pranë fshatit Drinas, ndodhur në një distancë ajrore 1.5 km nga qyteti.

Problematika mjedisore në Zonën e Kukësit lidhet kryesisht me **ndotjen e ujërave sipërfaqësore, ndotjen e tokës**, dhe rrymave të tjera të gjeneruara të mbetjeve, sistemin e amortizuar të kanalizimeve të ujrave të zeza i cili në shumë segmente të qytetit pothuajse mungon plotësisht dhe në ato zona ku ai ekziston është pothuajse i amortizuar, si dhe nga mungesa e trajtimit ose oksigjenimi i ujrave të zeza dhe sanitarizimi i gropave septike. Nje burim tjetër i ndotjes së ujërave sipërfaqësore **janë edhe ndotja nga ujrart urbane** të cilat pasi shkarkohen në ujrat sipërfaqësore, ulin ndjeshëm procesin e tretjes së përbërësve në ujë duke i turbulluar ujrat. Një problem tjetër është **ndotja e ujrave sipërfaqësor (liqeni i Fierzës) nga mbetjet të cilat vijnë nga përtej kufirit (Kosovës)** si pasojë edhe e vetë pozicionit gjeografik të qytetit. Mbetjet pasi hidhen në liqen, rrjedha lumore i transporton në shumë zona të banuara, duke sjellë jo vetëm ndotjen e tyre (mundësinë e përhapjes të ndonjë sëmundje infektive) por dhe çrregullime të habitateve ujore.

¹⁷ Industria e përpunimit të drurit, që kryesisht emeton sa të grimcave të pluhurit në ajër.


¹⁸ Parametrat kryesorë të cilësisë së ajrit janë CO₂, SO_x, NO_x, PM₁₀, PM_{2.5} dhe LNP

3.4 Zhvillimi rajonal dhe tiparet kryesore të ndërveprimit


Bashkia e Kukësit mund të konsiderohet edhe si *qendra kryesore administrative* e Qarkut të Kukësit, pasi në të janë të vendosur edhe institucionet kryesore të dekoncentruara si dhe struktura të qeverisjes qendrore në nivelin lokal, si: Nënprefektura, Gjykata, Prokurori, apo drejtoritë rajonale të arsimit, shëndetësisë, bujqësisë etj. Kjo sjell si rezultat një ndërveprim institucional të zyrave në nivel rrethi të përfaqësuar në qytetin e Kukësit, Bajram Currit dhe Krumës, ndërveprim që lidhet me përgjegjësitë dhe funksionet që secila prej këtyre zyrave si në nivel rrethi dhe qarku kanë në përgjegjësinë e tyre ligjore.

Qyteti i Kukësit, si qendër administrative është qendra e gravitetit të të gjithë Rajonit

Harta 7: Nderveprimet në punësim



Harta 8 : Nderveprimet e tregjeve



Burimi: Studimi i Zonave Funkzionale, dldp

të Kukësit. Aty ndodhen të gjitha shërbimet e nevojshme sociale, administrative, ekonomike. Aktualisht Bashkia e Kukësit hyn në *modelin e përqëndruar*, në të cilin ka vetëm një qendër të rëndësishme që është qyteti ose qendra administrative e rrethit. Si i tillë ai ofron shërbime dhe është qendra e mishërimit të ndërveprimeve për të gjithë rajonin duke rritur mundësinë e gjenerimit të të ardhurave vendore për komunitetin lokal.

Bashkia e Kukësit, dallohet për *bashkëveprim për sa i përket punësimit, konsumimit dhe aksesit në shërbime*. Karakteristikë në këtë zonë është një përqendrim i ndërveprimit ekonomik nga njësitë administrative drejt qendrës Kukës,

një tendencë kjo e hasur edhe në dy bashkitë e tjera të Qarkut të Kukësit: Bajram Curri dhe Krumë.

Qyteti i Kukësit është qendra kryesore e Bashkisë, dhe më e rëndësishme si në aspektin ekonomik, administrativ, dhe atë social. Qendra të tjera ekonomike përfshijnë Bicaç, Shtiqen, Shishtavec dhe Shemri (Malzi). *Pavarësisht këtyre qendrave ekonomike, Kukësi është edhe vendi ku zhvillohet aktiviteti tregtar kryesor*. Kjo vjen për shkak edhe të strukturës ekonomike të zonës, ku Qyteti i Kukësit shikohet si i vetmi vend i rëndësishëm i tregut, në të cilin realizohen edhe ndërveprimet kryesore tregëtare.


Në aspektin e *bashkëveprimit ndërkufitar Kukësi, është edhe qendra kryesore e ndërveprimit tregëtar me Kosovën* për shkak të afërsisë së tij me tregun e Kosovës e veçanërisht me dy qytetet kryesore të Rajonit Ekonomik Jugor të Kosovës, Prizrenin dhe Gjakovën. Aksesi

direkt në rrjetin kombëtar rrugor si rezultat i ndërtimit të autostradës Durrës – Kukës, e ka afruar Kukësin edhe me tregjet e tjera brenda territorit të vendit, duke rritur në këtë mënyrë ndërlidhjen dhe aksesin si në tregun vendas edhe atë rajonal.

3.4.1 Profili Ekonomik dhe Karakteristikat Kryesore të Zhvillimit

Historia e zhvillimit të ekonomisë së rajonit të Kukësit tregon për një zhvillim gradual të shërbimeve me fokus në bujqësi e blegtori. Pavarësisht se është një rajon i pasur me burime të shumta natyrore dhe mundësi të shumta, zona e Kukësit, si i gjithë Rajoni i Kukësit është dhe një nga zonat më të varfra në të gjithë Shqipërinë. Kontributi i këtij rajoni në Prodhimin e Brendshëm vazhdon të jetë më i ulët në vitet e fundit në rang vendi, vetëm 2.2%¹⁹. Po kështu niveli i PBB për frymë është më i ulët, duke qenë në një nivel rreth 30% më të ulët se mesatarja kombëtare dhe 12% më të ulët se mesatarja e zonës veriore.

Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik të zonës lidhet më faktin se të ardhurat në këtë zonë gjenerohen kryesisht nga sektorët me produktivitet të ulët. Ekonomia e kësaj zone bazohet në sektorin e bujqësisë & blegtorisë e cila zë mesatarisht 33% të gjithë të vlerës së shtuar bruto për rajonin, ndërkohë që kontributi i industrisë është vetëm në nivelin mesatar për rreth 11%. Kontributi i këtij sektori ka ardhur në rënie në vitet e fundit, por ka pësuar një ngritje të lehtë në dy vitet e fundit.



Ekonomia

mbizotërohet nga biznesi individual apo ai familjar dhe kryesisht është e bazuar tek tregëtia e vogël. Shumica e bizneseve janë të përqëndruara në Qytetin e Kukësit (79%²⁰), ndërsa njësitë e tjera administrative paraqiten me një numër të reduktuar biznesesh në totalin e tyre. Raporti i bizneseve për banorë është tepër i ulët me rreth 46 biznese për 1000 banorë në Kukës, deri në 1 biznes për 1000 banorë në Ujmisht dhe Grykë Çajë.

Struktura e ekonomisë reflektohet edhe në strukturën e eksport importit. Pjesën më të madhe të produkteve të importit në pesë vitet e fundit e zënë "produktet vegjetale" (29.8%) të ndjekura nga "metale bazë dhe artikujt prej tyre" (15.8%), dhe "produkte minerale" (15.5%). Pesha specifike e dy produkteve të fundit ka qenë relativisht e lartë në vitin 2013, përkatësisht 36% dhe 44.8%²¹. Eksporti i produkteve minerale ka ardhur duke u rritur që nga viti 2008 me ritme shumë të larta në vitet e fundit (nga 4.9 herë:2009 në 15.2 herë:2013). Një rol të madh ka luajtur këtu eksporti i mineraleve në Kosovë për përpunim të mëtejshëm të tyre.

¹⁹ INSTAT nga viti 2008 deri në vitin 2012

²⁰ 503 biznese kundrejt 637 bizneseve në total (Burimi INSTAT)

²¹ INSTAT nga viti 2009 deri në vitin 2013

Sa i përket investimeve publike shpërndarja e tyre në të shkuarën ka qenë jo në raporte të barabarta duke krijuar pabarazi në shpërndarjen e tyre. Fokusi i investimeve ka qenë kryesisht në infrastrukturën lokale, kryesisht ndërkohë që investimet në fushën e zhvillimit ekonomik vendor pothuajse kanë munguar.


3.4.2 Karakteristikat Kryesore të Bujqësisë - si sektori kryesor ekonomik i zonës

Bujqësia dhe blegtoaria mbetet sektori që siguron nivelin më të madh të të ardhurave dhe sektori kryesor i punësimit në Bashkisë Kukës. Kjo zonë njihet për zhvillimin e blegtorisë. falë terreni gjeografik janë faktorët kryesorë që garantojnë zhvillimin e bujqësisë. Bujqësia zë një vend shumë të rëndësishëm në zhvillimin e tregut të brendshëm, ku operojnë një numër i madh tregtarësh me prodhimin vendas.

Terreni malor i zonës ndikon dhe në strukturën e tokës, ku pyjet zënë rreth 62% të territorit të zonës, ndërsa toka bujqësore zë vetëm 16%, një përqindje e vogël e tokës bujqësore, krahasuar me mesataren në shkallë vendi (24%)²². Pyjet përbëjnë pasurinë natyrore një nga më kryesoret. Në rang qarku, Bashkia e Kukësit zë 45% të tokës bujqësore, duke bërë që kjo zonë ta ketë bujqësinë një potencial më të madh krahasuar me dy zonat e tjera.

E diktuar nga kjo strukturë toke, pjesa e tokës e shfrytëzueshme për bujqësi përbëhet në një masë të madhe nga kullotat 56%, ndërsa toka arë zë vetëm 34%. Ndërsa sipërfaqet e mbjella me vreshta dhe pemtoret zënë një përqindje shumë të vogël (3% dhe 4%).

Ndër bimët e arave pjesa më dërrmuese e sipërfaqes së mbjellë dominohet nga foragjeret, e ndjekur nga drithrat. Kurse në aspektin e prodhimtarisë, patatja dhe perimet zënë peshën më të madhe të prodhimeve bujqësore në këtë zonë. Infrastruktura e dobët, si dhe futja e kësaj kulture nga vende të tjera fqinje e ka bërë më pak konkurruese në tregun lokal, pasi kjo kulturë del në treg me koste më të lartë se sa ajo e importit. Megjithatë, patatja e Kukësit është mjaft e pëlqyer për cilësinë e saj dhe së bashku me gështenjat përbëjnë dy nga produktet më tipike të zonës të cilat furnizojnë jo vetëm tregun lokal, por tregëtohen edhe në tregun kombëtar apo në Kosovë, dhe së fundi gështenja edhe në vendet europiane. Bashkia Kukës zë vendin e gjashtë në republikë për prodhimin e patates²³.



²² INSTAT Statistika e Bujqësisë 2012

²³ Krahasimi me 36 rrethet e vendit



Pemëtaria po tregon për një trend pozitiv ku si numri i pemëve frutore dhe prodhimtaria ka ardhur në rritje, ku rritjen më të madhe e kanë pasur vreshtat me 8% në vit, pemët frutore 6%, dhe pjergullat me 3% në vit. Si rezultat i rritjes së numrit të vreshtave prodhimi ka pësuar një rritje me ritme mesatare vjetore 12%. Pemëtaria është edhe dega që sjell burimin më të madh të të ardhurave, rreth 55%²⁴ për fermerët.

Aktiviteti agro-perpunues është tepër modest. Në Kukës ushtrojnë aktivitetin dy firma për prodhimin e pijeve alkoolike²⁵, të cilat përdorin si lëndë bazë produktet e zonës si kumbullat, rrushin, manaferrin, etj.

Zona e Kukësit ka potenciale shumë të mëdha për sa i përket **bimëve medicinale dhe aromatike**. Një bimë tipike medicinale e Zonës është sherebela. . Ashtu si sherebela, janë rreth 124 bimë medicinale²⁶ që rriten në zonë, por për të cilat mungon drejtimi teknik dhe duhen bërë studime të tilla për të nxitur kultivimin e tyre dhe rritur përfitimet²⁷. Bimët mbledhen në formën e tyre natyrale, dhe jo të kultivuar. Në disa ish kooperativa si në Arren, Shemri (Malzi), Surroj kanë qenë të ngritura impiante distilimi të gjetheve të pishës dhe rrëshirës, për prodhimin e esencave. Në vende si Shishtavec, Topojan, Bicaj e Tërthorë ka potenciale për rritjen e bimëve të ndryshme mjeksore që shërbejnë në industrinë farmaceutike si boronica, sherebela, sanza, trumza, lule manushaqja, lule shtogu, kokërr shtogu, mollë të egra, etj. Grumbullimi i tyre bëhet spontanisht dhe nuk ka ende ndonjë organizim të vecantë për mbledhjen e tyre.²⁸ Eksistojnë vetëm 2 pika grumbullimi të Bimëve Medicinale të cilat ndodhen në Qytetin e Kukësit. Përqëndrimi i pikave të grumbullimit vetëm në Qytetin e Kukësit, bën që kostoja e transportit të tyre nga pika të ndryshme të mbledhjes deri në pikat e grumbullimit të jetë e lartë.

Megjithatë vështirësitë në tregtimin e bimëve medicinale, ka potenciale që këto prodhime të jenë konkurrese jo vetëm në tregun lokal por edhe atë rajonal e ndërkufitar.

❖ Avantazhet dhe Sfidat e sektorit²⁹

Avantazhet konkurrese të bujqësisë në këtë zonë mund të përmenden:

- (i) *Ekzistenca e disa prodhimeve bujqësore të cilat dallohen për cilësinë e tyre;*
- (ii) *Interesi në rritje për prodhimet vendase dhe prodhimet bio;*
- (iii) *Cmimet konkurrese të produkteve bujqësore të zonës së Kukësit krahasuar me zonat e tjera të vendit;*
- (iv) *Aksesi i shpejtë në tregjet rajonale dhe ekzistenca e tregjeve kufitare;*
- (v) *Potencialet e mëdha në prodhimin e bimëve aromatike medicinale.*

²⁴ Shih: INSTAT "Statistikat e Bujqësisë 2012"

²⁵ Këto dy firma janë të pozicionuara në Qytetin e Kukësit dhe shërbejnë edhe si pika grumbullimi e përpunimi të frutave të rritura në Bashkinë e Kukësit.

²⁶ Bimët medicinale që rriten në këtë zonë janë Boronica (Vaccinium Myrtillus), Trumza (Saturea montana), Dëllinja e zezë (Juniperus communis), Dëllinja e kuqe (Juniperus Sabina), Agulicja (Primula grandiflora), Shqema (Cermodell), Lulekuqja (Papaver rhoas), Trëndafili i egër (Rosa canina), Sherebela (Salvia officinalis), Shpatore (Tiris germanica), Luleshtrydha (Fragaria vesca), Kamomili (Matricaria chamomile), Hithra (Urtica dioica), Manaferra (Robus fruticosus), Mështenka.

²⁷ Bazuar në diskutimet gjatë Takimit Konsultativ me Forumin e Zonës Funktionale të Kukësit, 25 nëntor 2014.


²⁸ Plani i Zhvillimit të Komunes Tërthorë, 2012

²⁹ Në mënyrë më të zgjeruar jepen në Aneksin I

Ashtu si në të gjithë vendin, zhvillimi i bujqësisë dhe performanca ekonomike e sektorit të bujqësisë edhe në Bashkinë e Kukësit **ndikohet negativisht nga disa faktorë ku më kryesorët janë:**

- (i) *Madhësia e vogël e fërmeve:*
- (ii) *Niveli i ulët i mekanikës dhe teknologjisë bujqësore:*
- (iii) *Kapacitetet vaditëse:*
- (iv) *Pronësia dhe regjistrimi i tokës:*
- (v) *Përdorimi i kufizuar i farave të zgjedhura që ndikojnë në rritjen e rendimentit e prodhimtarisë;*
- (vi) *Kostoja e lartë e shpenzimeve të transportit;*
- (vii) *Mungesa e pikave të grumbullimit me qëllim sigurimin e kushteve optimale të ruajtjes së produkteve bujqësore³⁰;*
- (viii) *siguria ushqimore e ofrimi i standardeve të duhura për konsumatorin.*

Blegtoria është një nga burimet kryesore të të ardhurave për zonën e Kukësit. Sipas të dhënave më të fundit të Ministrisë së Bujqësisë³¹ të prodhuara në vitin 2012, zona e Kukësit siguron rreth 60% të produkteve blegtorale nga të imtat dhe 56% të prodhimit të leshit në rang Qarku, edhe pse në nivel kombëtar shifrat janë modestë në rreth 3%. Kukës është një zonë e pasur me bagëti, Brënda grupit të të imtave, pjesën më të madhe e zënë të dhirtat, (76% numrit të kafshëve), brenda të cilit delet zënë përqindjen më të madhe në vitin 2014 (81³²%). Bletaria është sektori i cili ka pësuar rritjen më të madhe kohët në pesë vitet e fundit, me një rritje mesatare vjetore prej 4%, ose me një numër total prej 800 kosheresh. Në vitin 2014 numri i koshereve arriti në 8224. Nëse garantohet siguria ushqimore dhe ruhen elementet e brand-it, të qenurit produkt lokal dhe “bio”, kjo veprimtari mund të jetë një mundësi shumë e mirë për gjenerimin e të ardhurave.



³⁰ Aktualisht ekziston vetëm 1 pike e grumbullimit të prodhimeve bujqësore (dhoma frigoriferike për ruatjen e frutave dhe perimeve)je cila ndodhet në Tregun e Fruta-perimeve pranë Qytetit Kukës me kapacitet 30-40m3.

³¹ Vjetari Statistikor i Bujqësisë 2012

³² Sipas të dhënave të drejtorisë së Bujqësisë Kukës., numri i deleve ishte 36,446 krerë, kundrejt 44, 853 krerë të leshta.



Përqëndrimi më i madh i krerëve gjendet në zonat e Bicajt (19% e totalit për vitin 2014) Shishtavecit (10%) dhe Ujmisht (10%), ku numri i krereve të imta, gjedhëve është më i madh, për të gjitha llojet e tyre, ndjekur nga Grykë Cajë e Bushtricë për numrin e deleve dhe Shishtavec (22%) e Zapod (16%) për njëthundrakët. Raca më përhapur në zonë është tipi i deles “Rude”. Vlen të përmendet zona e Bicaj ku blegtoria është sektori i vetëm që ka njohur vetëm rritje këto 20 vitet e fundit.³³

Edhe blegtoria si bujqësia ka të njëjtat avantazhe konkurruese. Ndër produktet e preferuara konsiderohet mjalti i zonës së Kukësit prodhimi i të cilit ka ardhur në rritje, si dhe produktet blegtorale, e sidomos djathi i dhisë.

Duke qenë një sektor vital për ekonominë e zonës blegtoria **përballet me disa sfida**³⁴:

(i) *Rendimenti i ulët prodhimit:*

(ii) *mungesa e mbulimit me shërbime veterinare:*

(iii) *mangësi në grumbullimin dhe përpunimin e produkteve blegtorale, që ndikon direkt në zinxhirin e vlerës në këtë sektor:*

(iv) *mungesa e shtrirjes së sistemit të ofrimit të shërbimeve këshillimore për fermerët;*

(v) *mungesa e infrastrukturës që ndikon në uljen e sigurisë ushqimore;*

(vi) *mungesa e zinxhirit të duhur grumbullues dhe përpunues:*

Peshkimi përbën një potencial mjaft të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Zonës. Liqeni i Fierzës, përbën një mundësi të madhe për për kultivimin e peshkimit me rreth 5000 ha sipërfaqe ujore (pra mbi 70%) duke e kthyer peshkimin në Liqenin e Fierzës, në një veprimtari të rëndësishme ekonomike për gjithë zonën. Ujrat janë tipike për kultivimin natyror të popullatave peshkore që në këtë zonë marrin një zhvillim vërtetë të dukshëm³⁵. Sot në Fierzë rriten rreth 13 lloje peshqish përfshirë edhe rritjen e midhjeve të vogla të ujërave të ëmbla.

Nga Liqeni është marrë deri në 5 mijë tonë peshk në vit, por prodhimi ka pësuar rënie në dhjetëvjeçarët e fundit për shkak të mos shtimit, por edhe për arsye të peshkimit të pa kontrolluar, shpesh dhe me mjete shfarosëse si dhe ndotja e liqenit. Po kështu mungojnë edhe kushtet për rritjen e ruajtjen e peshkut. Megjithatë, problemi më i madh që ekziston është se ky liqen ndotet shumë nga mbetjet urbane ku pjesa më e madhe vjen nga rrjedhjet e lumenjve të Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi, të cilat ndikojnë negativisht në cilësinë e ujit, faunës, ambjentit përreth, si dhe shfrytëzimin e terrenit për plazh dhe aktivitete ujore.

Marrja e masave për të përmirësuar kushtet aktuale të liqenit e rritur peshkimin, nëpërmjet pastrimit i Liqenit të Fierzës dhe zonës përreth tij, sistemit të bregut të Liqenit dhe përshtatjes së tij në një Pikë Turistike, si dhe peshkëzimit artificial si të Liqenit të Fierzës dhe ujëmbledhësve të Qarkut Kukës ka qenë dhe mbetën si prioritet për zhvillimin e këtij

³³ Është rritur dyfish numri i gjedhëve dhe është trefishuar numri i të imtave.

³⁴ Në mënyrë më të detajuar paraqiten në Aneksin 1

³⁵ Që nga formimi, struktura peshkore u tjetërsua me lloje peshqish liqenorë, e shoqëruar me largimin e llojeve të ujërave të rrjedhshëm që më parë popullonin lumin Drin, si trofta, ngjala dhe gjetën mjedis të përshtatshëm shumimi dhe ushqimi, peshq si ballëgjeri i bardhë dhe ai larosh, krapi, luçiperka, karasi dhe gjuhca (cironka), sharmaku.




sektori në mënyrë të qëndrueshme dhe kthimin e tij në një potencial për zhvillimin e ekonomisë lokale dhe turizmit.

3.4.3 Turizmi -potencialet dhe sfidat kryesore të zhvillimit

Zona e Kukësit është një ndër zonat që mbart potenciale për zhvillimin e këtij sektori por në të njëjtën kohë vazhdon të jetë një ndër zonat ku ky potencial mbetet ende i pashfrytëzuar. Në këtë aspekt, zhvillimi sa më i shpejtë i këtij sektori do të mobilizojë potencialet më të mëdha ekonomike për rajonin dhe familjet kuksiane mbetet një nga prioritetet kryesore.

Turizmi Kulturor: Zona e Kukësit ka histori e kulturë të gjerë, tradita vendase, shumëllojshmëri e produkte bujqësore, kulinari, të cilat janë potenciale mjaft të vlefshme për zhvillimin e disa llojeve të turizmit të tilla si ai **Kulturor, Historik, Fetar, Kulinar** etc. Kjo zonë është e pasur në qendra kulturore, fetare, monumente e historike, si dhe tradita e folklori, të cilat janë bërë pjesë e trashëgimisë kulturore kombëtare.³⁶ Artizanati i pasur Kuksian, veshjet karakteristike, traditat në dekorimin e shtëpive apo pritjen e miqve përbëjnë disa nga elementët më tërheqës për turistët. Megjithatë mungesa e një muzeu Etnografik dhe “marketimi” i dobët i kulturës vëndase dobëson percepticionin e turistëve mbi potencialin e vërtetë që ky vënd ofron. Duke qënë se puna e dorës dhe artizanati Kuksian janë në rrezik zhdukjeje, objekte kulturore si Muzeu Etnografik apo festa që promovojnë traditat e zonës janë një mundësi e mirë për ruajtjen e këtyre traditave dhe tërheqjen e sa më shumë turistëve kuriozë.



Turizmi rural: Duke qënë më së shumti një zonë rurale ekzistojnë potenciale mjaft të rëndësishme për zhvillimin e turizmit rural duke përfshirë brënda kësaj kategorie edhe lloje të tjera turizmi të të njëjtës familje si ai **malor, peisazhor, eko-turizmi, agriturizmi** etj. Eksistenca e disa objekteve si monumente natyrore si Sasati në lartësinë e mbi 1700 metrave mbi nivelin e detit, Kroji i Bardhë³⁷, Guri Mëngjesit në Shishtavec , Pylli i Mështeknave etj janë kthyer në pika të rëndësishme që vizitohen si nga vizitorë të ardhur nga zona të ndryshme, por edhe të huaj, kryesisht nga Kosova. Zhvillimi i turizmit malor ka bërë hapa të rëndësishëm përpara duke çuar në shtimin e numrit e banesave turistike në zonat rurale. Po ashtu edhe ndërtimi i autostradës, ka krijuar mundësi efikase për zhvillimin cilësor të turizmit malor, për të cilin kërkesat janë gjithnjë në rritje si nga vizitorët nga Shqipëria dhe zonat e Kosovës, si Prizrenit e Dragash.

Turizmi Kurativ. Një mënyrë tjetër më inovative për të kapur edhe më tej interesin e turistëve do ishte zhvillimi i paketave turistike inovative të cilat shfrytëzojnë resurset rurale duke shënjestruar turistin "urban". Më saktësisht, shumëllojshmëria e bimëve medicinale, burimet e shumta ujore nga majat e maleve, pyjet dhe ajëri i pastër me oksigjen janë receta perfekte për zhvillimin e një lloji jo shumë të njohur turizmi sic është Turizmi Kurativ.

³⁶ Banesa e Hasan Rexhepit, Kalaja e Lekes (Mal Zi), Gradishta e Bardhocit (Tërthore), Banesa e Asllan Fetahut, Banesa e Rustem Shahinit, “Hisari” në Domaj, Kështjella e Bushatit, Shkolla e Vjetër e Bicajve (Bicaj) dhe Kalaja e Vilës (Bushtricë).

³⁷ Nga keto monumente janë në pronësi të shtetit dhe 5 pronësi private.

³⁸ Është vetëm 30 kilometra larg qytetit të Kukësit.



Zhvillimi i këtij lloji turizmi në Kukës do të sillte një risi jo vetëm në këtë zonë por edhe në vënd pasi ky lloj turizmi nuk është mjaft i përhapur në Shqipëri. Gjithashtu bizneset do të mbështeteshin jo vetëm tek tregu Shqiptar por mund të shkojnë edhe më tej. Krijimi i paketave turistike të alternuara, duke e pasuruar më tej ofertën turistike të alternuar më qëndrat kurative në vendet kufitare mbështetur nga cmimet e ulëta të zonës do ishin mjaft tërheqëse për grupe të caktuara turistësh pasi do t'u mundësonte pushime më të gjata, me kosto më të ulët në krahasim me vëndet e tyre duke u lejuar gjithashtu eksplorimin e një kulture të re.

Turizmi Natyror -Dimëror: Zona e Shishtavecit njihet si një nga zonat ku, edhe pse modest, zhvillohet turizmi dimëror. Ushtrimin i sportit të skive tashmë realizohet tashmë prej më shumë se 7 dekadash³⁸. Pika të tjera turistike si Kroji i Ramës, Kroji i Kishës dhe Kroji Tatzot, vizitohen vetëm nga pasionuarit pas alpinizmit dimëror. Gjithashtu edhe në zonën e Tërthorës, megjithëse infrastruktura ka bërë që bjeshka të mos frekuentohet, mbetet një resurs i pashfrytëzuar për turizmin alpin. Në Bicaj e gjithë pjesa e bjeshkës (duke filluar nga Laku i dardhës e deri tek Kroji i kuq) është një vend i mrekullueshëm për vizitorët dhe turistët që janë të interesuar për klimën e freskët malore. Para disa vitesh në këtë zonë kalonin pushimet verore mjaft vendas dhe të huaj. Zhvillimi i turizmit shoqërohet me zhvillimin e prodhimeve bujqësore, blegtorale, riparimin, përmirësimin e shtëpive të banorëve, rregullimin/ ngritjen e vendeve të përshtatshme për kalimin e kohës së lirë të vizitorëve, si dhe përmirësimi i prodhimeve lokale, etj.

Turizmi Liqenor: Ekzistenca e liqenit është një potencial i madh për zhvillimin e turizmit pasi pika të caktuara të tij mund të shfrytëzohen gjatë verës si plazhe që mund të përdoren nga banorët vendas për larje dhe banjo dielli, por njëkohësisht mund të frekuentohen edhe nga banorët e zonave kufitare më Kosovën, të cilëve të tilla vende ju mungojnë. Sporte të tilla si garat me kanoe mund të jenë një mundësi e mirë për t'u zhvilluar nisur nga sipërfaqja e madhe e liqenit dhe lidhja e tij me degët e Drinit, në periudha të favorshme kur niveli i ujit në verë i favorizon të tilla sporte ujore. Por marrja e masave për pastrimin dhe mbajtjen pastër të liqenit dhe krijimin e infrastrukturës së duhur për sportet liqenore apo pikat e plazheve përgjatë liqenit duhet të jenë në vëmendjen e autoriteteve lokale.

Turizmi i aktiviteteve të biznesit apo "business tourism" është një tjetër lloj turizmi që mund të zhvillohet, duke qënë një zonë kufitare dhe mjaft aktive në projektet e shkëmbimave e bashkëpunimit ndërkufitar. Ky lloj turizmi është një mjet mjaft efikas për të zbutur paksa problemet me sezonalitetin turistik duke ndihmuar që hotelet të kenë mundësi për të përfutur edhe gjatë sezoneve të ulta turistike, kryesisht ato dimërore por jo vetëm. Megjithatë, zhvillimi i këtij turizmi kërkon të shtohen kapacitetet dhe infrastruktura e duhur për mbajtjen e konferencave apo aktiviteteve duke shtuar sallat e konferencave apo hotelet që mund të ofrojnë këtë lloj shërbimi në mënyrë cilësore.

Turizmi Aventuresk: Malet e larta, liqenet e lumenjtë, grykat, shpellat, kanionet e me rradhë janë tiparet kryesore që një turist i këtij lloji kërkon të eksplorojë. Eksplorimi i zonës mund të shijohet nëpërmjet hipizmit, trekking, alpinizmit, ngjitjes në shkëmbinj (rock climbing), ndërkohë që ka mjaft mundësi për zhvillimin e sporteve të tilla si sportet ujore, skive apo edhe atyre me më shumë adrenalinë si bungee-jumping, paragliding, zip lining etj. Këto të fundit janë ende të pazhvilluara në Shqipëri, me përjashtim të paragliding e cila po bëhet një aktivitet gjithmonë e më i suksesshëm vitet e fundit.

³⁸ Ky sport ka filluar të ushtrohet që prej vitit 1953, pavarësisht se infrastruktura e lehte si veshja e skiatorëve, skitë dhe gjithë pajisjet e tjera kurrë nuk kanë qënë në nivelin e ushtrimit në mënyrë profesioniste.



❖ Avantazhet dhe Sfidat e sektorit

Avantazhet kryesore dhe mundësitë që ofron zona për zhvillimin e turizmit në Bashkinë e Kukësit në mënyrë të përmbledhur janë:

- (i) *pasuria natyrore e pakursyer dhe relievi piktoresk;*
- (ii) *histori e kulturë të pasur;*
- (iii) *tradita të punimeve të artizantit;*
- (iv) *afërsia rrjetin kombëtar rrugor*
- (v) *cmimet konkurruese;*
- (iv) *interesi gjithmonë e më tepër në rritje dhe mundësi të mëdha për zhvillim të qëndrueshëm të zonës.*

Edhe pse potencialet ekzistuese janë të mëdha **zhvillimi i turizmit përballë më shumë sfida**, të cilat kryesisht janë:

- (i) *infrastruktura e dobët;*
- (ii) *transporti i paorganizuar dhe sinjalistika e pazhvilluar;*
- (iii) *mungesa e tregut të sipërmarrjeve turistike;*
- (iv) *Mungesë ndërgjegjësimi kundrejt mundësive që ofron turizmi;*
- (v) *ndotja urbane dhe mungesa e rregullimit urban;*
- (vi) *probleme me pronat dhe ndërtimet pa leje;*
- (vii) *mungesa e aplikimit të skemave favorizuese të mbështetjes financiare.*
- (viii) *Mungesa e një qasje të koordinuar dhe të integruar të ofertës turistike;*
- dhe së fundi por më e rëndësishme (ix)mungesë kapacitetesh akomoduese dhe cilësi e ulet shërbimi.*

Në bashkinë e Kukësit janë të regjistruara dhe në funksionim rreth 20 Hotele dhe Bujtina të cilat janë kryesisht të përqëndruara në Kukës dhe në Shishtavec. Ndërsa rritet numri i vizitorëve, i domosdoshëm mbetet zgjerimi i shërbimit të hotelerisë, përmes ndërtimit të hoteleve turistike, apo bujtinave në zonat e thella malore.

3.4.4 Minierat

Zona e Kukësit dallohet për burimet e shumta minerale. Rezervat kryesore të kromit ndodhen tek shkëmbinjtë Ultrabazik të Zonës së Kalimashit. Burime të mineralit të kromit ka dhe në zonën e Surroit por nxjerrja e tyre bëhet nëpërmjet karrirave. Minerali i bakrit nxirret në zonën e Gjegjanit dhe Ngdhesht. Në zonën e Shënmrisë ndodhet miniera e bakrit në Lerpoj, e pashfrytëzuar deri tani. Hekur-Nikel dhe Nikel-Silikat: përqëndrimi kryesor në

Kolsh, Surroj dhe Arren³⁹.

Boksidet dhe alumini shtrihen në Qafë- Bëne, ndërsa mineralet radioaktive (ende rezervat të papërcaktuara) ndodhen në Nimce, ndërsa kuarcitet në Kallabak e Shishtavec.

Në Bashkinë Kukës ushtrojnë aktivitetin e tyre 25 subjekte minerare⁴⁰. Kontributi i këtij sektori në zhvillimin e ekonomisë së zonës lidhet vetëm me punësimin e fuqisë së aftë për punë dhe kontributin në buxhetin e Bashkisë ku janë të vendosura nëpërmjet dhënies së 6% të vlerës së prodhimit që quhet *renta minerare*. Pjesa më e madhe e mineralit të Kromit përpunohet në një fabrike të ngritur në Bashkinë e Hasit. Minerali i hekur - nikelit eksportohet në Kosovë, në Uzinën e Shkrires së Hekur-Nikelit në Drenas.

Në këtë zonë siç jepet edhe në hartën e mesipërme ekzistojnë

edhe një numër i madh i HEC-ve. Në njësinë administrative Bicaj ndodhet edhe masivi i shfrytëzimit të rërës së bardhë e cila furnizon gjithë zonën e Kukësit dhe Hasit. Kjo pasuri përbën një burim shumë të rëndësishëm për popullsinë e zonës, vetëm se shfrytëzimi i saj duhet të kryhet me kriter, dhe duhet të investohet në mënyrë të studiuar në drejtim të shfrytëzimit dhe përpunimit të saj.

Veprimet që mund të ndërmerren në lidhje me këtë sektor do të fokusohen në nisma të përbashkëta të aktorëve të ndryshëm. Këtu përfshihen promovimi dhe shfrytëzimi i planifikuar i bazuar në kërkime të mineraleve nëpërmjet aplikimit të metodave e teknologjive moderne, metoda e teknologji që konsiderojnë aspektet dhe pasojat mjedisore.

Konkluzione


Analiza e sektorëve të mësipërm ekonomik nxjerr disa karakteristika që janë të përbashkëta për të tre sektorët kryesorë bazë të zhvillimit ekonomik të cilat janë:

1. Një zonë më e pasur me burime minerare, prodhimtari të pasur bujqësore e blegtorale dhe me pasuri natyrore të vecanta;
2. Avantazhe konkurruese të cmimeve të produkteve bujqësore e blegtorale të ndryshme të prodhuara në zonë;
3. Mundësi e potenciale të mëdha për të përdorur elementin "BIO" në shumë sektorë si industrinë agro-përpunuese dhe turizëm;

³⁹ Këto miniera janë sot në potencialin e tyre më të madh (rezerva maksimale), të cilat llogariten në masën prej 74 milion ton rezerve minerali.

⁴⁰ Burimi: Prefektura Kukes

Harta 12: Vendodhja e Minerave dhe HEC-ve





4. Interes në rritje nga tregu i brendshëm dhe ai rajonal për produktet bujqësore e blegtorale;

Por potencialet e mëdha që kjo zonë ka si rezultat i pasurive të saj nëntokësore, mbitokësore dhe trashëgimisë kulturore nuk shfrytëzohen si rezultat i ndikimit të një sërë faktorësh të cilët ndikojnë paralelisht dhe respektivisht në gjithë sektorët. Ndër këta, faktorët me ndikim negativ më të ndjeshëm janë:

1. *Infrastruktura rrugore ende e pazhvilluar që ul aksesin e shpejtë në tregje dhe rrit koston;*
2. *Infrastruktura e bujqësisë e pazhvilluar në të gjitha elementet e saj, përfshi edhe sigurinë ushqimore;*
3. *Kapacitetet e burimeve njerëzore të pazhvilluara, si rezultat edhe i mungesës së një sistemi të trajnimit profesional multi-disiplinor;*
4. *Mungesë të këshillimeve profesionale të shtrirë në të gjithë sektorët dhe shërbimeve specifike për fermerët, strukturat akomoduese e mikëpritëse;*
5. *Mungesë e sistemeve financiare mbështetëse;*
6. *Probleme me marrjen në pronësi të tokës;*

3.5 Analiza dhe vlerësimi i problematikave sociale


3.5.1 Kohezioni Social

Kukësi njihet si një nga katër qarqet më të varfër në vend. Sipas Instat 2015 burimet e të ardhurave për këtë zonë variojnë si më poshtë:

- 46,70% vijnë prej ndihmës Ekonomike (NE),
- 35,12% janë të ardhura nga punësimi,
- 28,54% janë prej pensioneve,
- 4,08% janë të ardhurat nga remitancat.

Sic shihet dhe nga shifrat burimi kryesor i të ardhurave për këtë bashki mbetet ndihma ekonomike. Në vitin 2014, numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike është 1917. Përgjithësisht numri më i madh i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike jetojnë në zonat rurale ku ky tregues është 1.5 herë më i madh se në qytetin e Kukësit (Instat 2015). Sipas LSMS në 2012, Kukësi shënon një nivel varfërie prej 21.8%. Thellësia e varfërisë është 3.7% dhe ashpërsia 0.9%. Bashkia e Kukësit ka dhe numrin më të madh të njerëzve që jetojnë nën nivelin e varfërisë. Madhësia mesatare e Njesisë Ekonomike

Grafiku 1: Shkalla e popullsisë së trajtuar me ndihmë ekonomike



Burimi: Qarku i Kukësit



Familjare mbetet sërisht e lartë prej 4.98 personash.

Të ardhurat mesatare mujore janë mjaft të ulta për shkak se shumë familje jetojnë me ndihmë ekonomike. Shumica e familjeve jetojnë me rroga nga sektori publik që ka një mesatare prej 19.000 lekësh. Një nga tiparet shoqëruuese të nivelit të varfërisë është niveli i trajtimit të popullsisë me ndihmë ekonomike. Në shkallë të NJA 43.3% e popullsisë trajtohet me ndihme ekonomike, ndërsa njësitë ku ky nivel është tepër i ndjeshëm janë Kolsh (69.8%), Ujmisht (66.4%) dhe Tërthorë (64.3%)⁴¹.

3.5.2 Situata e shëndetit publik

Të dhënat mbi vdekshmërinë foshnjore tregojnë se ka përmirësime të këtij treguesi përgjatë viteve 2006-2010. Treguesi i vdekshmërisë foshnjore për 1000 lindje është 4.4 në 2010 dhe ka rënë me 67%. Vdekshmëria 1-5 vjec (për 1000 lindje të gjalla) në Bashkinë e Kukësit dhe Tropojës është 1.6%. Në 2010 pati 14 vdekje nga 901 lindje të gjalla.

Numri i qendrave shëndetësore për 10.000 banorë është 2.3 dhe nuk ka ndryshuar që nga 2006, kurse numri i ambulancave është 5 për 10.000 banorë për 2014. Në 2014 ka 33 shtretër për 10.000 banorë në rajon, 12% më shumë se në 2010. Sipas të dhënave të fundit të Drejtorisë së Shëndetit Publik numri mjekëve në zonë është 55. Raporti është 0.5 mjekë për 1000 banorë në rajon.

Në Bashkinë Kukës funksionon Spitali Rajonal i cili ofron shërbime mjekësore për banorët e Bashkisë dhe të gjithë Rajonit. Në territorin e Bashkisë Kukës ushtrojnë aktivitetin e tyre ISKSH (Dega Rajonale) dhe Drejtoria Rajonale Shëndetësore, nga varet shërbimi i mjekut të familjes (24 orësh) në të cilin shërbejnë 9 mjekë dhe 55 personel mjekësor. Gjithashtu në shërbim të banorëve janë: (i) Një maternitet Rajonal; (ii) Një konsultore për nënat dhe fëmijët Shërbimi i Urgjencës (brenda spitalit) Shërbimi stomatologjik për fëmijë dhe (iii) 6 farmaci private.

Në përgjithësi, mund të thuhet se shërbimi shëndetësor është përmirësuar. Shërbimi ambulator është rritur në zonat rurale me qëllim ofrimin e një shërbimi parësor shëndetësor më të mirë dhe më të shpejtë popullatës rurale. Çdo fshat ka një ambulancë dhe cdo njësi ka një qendër shëndetësore.

Gjithashtu, një ndikim pozitiv që qendrat shëndetësore kanë pasur janë edhe fushatat sensibilizuese që janë nisur nga to. Megjithatë, për shkak të infrastrukturës së dobët dhe distancave të largëta nga spitalet që ndodhen në zonat urbane, transporti në kohë i pacientëve drejt tyre mbetet një sfidë. Për sa i përket numrit të personave me aftësi të kufizuar në 2014 është 13.3% përfshirë këtu me aftësi të kufizuar në shikim, në dëgjim, në lëvizje, në kujtesë, në komunikim dhe në kujdesin e përditshëm.

Duhet theksuar fakti se cilësia e shërbimeve të ofruara ende ka nevojë për përmirësime si dhe nevojitet kualifikim i personelit dhe pajisja me aparatura dhe medikamentet e duhura.

3.5.3 Edukimi

Qyteti ka tradita arsimdashëse të cilat e tejkalojnë një shekull. Shkolla e parë shqipe është hapur që në vitin 1911 në Kolesjan-, por ajo u zhvillua ndjeshëm mbas vitit 1944. Ndërsa shkolla e mesme është hapur që në vitin 1956, e cila krijoi një traditë të mirë duke u bërë e njohur në shkallë kombëtare për cilësinë e mësimdhënies dhe numrin e studentëve që

⁴¹ të dhënat i referohen vitit 2013




vazhdonin shkollat e larta. Sot aktualisht në Bashkinë e Kukësit (qytet) ka 6 shkolla 9-vjeçare me 2735 nxënës dhe 3 shkolla të mesme, 2 të profilit të përgjithshëm ku studiojnë 1380 nxënës, dhe 1 profesionale me 134 nxënës⁴².

Megjithë tendencën në rritje të investimeve në infrastrukturën arsimore dhe përmirësimin e treguesve në këtë drejtim, statistikatat tregojnë për një rënie të ndjekjes së arsimit parauniversitar, një fenomen ky i alternuar edhe me braktisjen e shkollës.

Grafiku i mësipërm tregon numrin dhe tendencën e regjistrimeve për katër vitet akademike të fundit. Sic shihet ndjekja e arsimit të mesëm (parauniversitar) ka ardhur në rënie. Nga të dhënat vihet re një rënie e përgjithshme e regjistrimeve. Në vitin akademik 2015- 2016 krahasuar me vitin akademik 2012-2013 kjo rënie shkon në - 16%.

Në vitin 2008, Universiteti i Tiranës hapi degët e tij në Kukës, me tre fakultete. Numri i nxënësve të regjistruar në nivelin e lartë të arsimit u rrit me 75 % - nga 240 studentë në vitin 2008 në 420 në vitin 2010, ndërsa 680 në vitin 2011. Pas vitit 2013 në kuadër të Reformës në Arsimin e Lartë të dy filialet u mbyllën⁴³.

Grafiku 2: Regjistrimi në arsimin parauniversitar (NJV Kukës)¹



Burimi - Qarku Kukës

3.5.4 Tregu i Punës dhe Struktura e tij


Pjesa më e madhe e popullsisë është e punësuar në sektorin e shërbimeve, (57.3%) ndërsa rreth 33% në sektorin e bujqësisë dhe vetëm 9.5% në sektorin e industrisë. Ndërsa në nivel njësie vendore kjo strukturë ndryshon ç'ka lidhet edhe me vendndodhjen e minierave në këtë zonë. Punësimi në sektorin e bujqësisë dominon në njësi administrative Arren, Shishtavec dhe Topojan.

Ekziston një lidhje e drejtë ndërmjet sektorëve të punësimit dhe statusit të punësimit. 51.6% e personave që punojnë janë të punësuar, ndërsa mesatarisht 48.4% janë të vetë-punësuar ose punojnë në bizneset familjare, ndërkohë që statusi i punësimit është i ndryshëm nga njësia në njësi. Punësimi zë një peshë më të madhe specifike në qytetin e Kukësit, në njësitë administrative Kolsh, Ujëmisht dhe Zapod. Ndërsa vetëpunësimi ose punësimi në ekonomitë familjare është më i shpeshtë në njësitë administrative Arren, Shishtavec dhe Bushtricë. Pjesa më e madhe e të punësuarve (61%) punojnë më kohë të pjesëshme, çka lidhet edhe me natyrën rurale të zonës edhe me aktivitetin bujqësor, dhe vetëm 33.2% punojnë me kohë të plotë.

⁴² Burimi: Bashkia Kukës për vitin akademik 2015 - 2016


⁴³ Burimi: Bashkia Kukës viti 2016

Grafiku 3: Punësimi sipas Sektorëve të ekonomisë 2014



Burimi: INSTAT

Grafiku 4: Statusi i Punësimit 2014



Niveli i papunësisë është shumë i lartë⁴⁴. Niveli më i lartë i papunësisë është regjistruar ndërmjet të rinjve 65.9%, ndjekur nga papunësia ndërmjet grave në masën 51.5%, ndërsa ndërmjet meshkujve arrin në masën 50.1%.

Bujqësia mbetet ndër sektorët më të rëndësishëm ekonomikë që ofron rreth 33% të të gjithë të vlerës së shtuar bruto për rajonin e kryesisht për Bashkinë e Kukësit, duke siguruar edhe nivelin më të lartë të punësimit.

3.5.5 Situata Socio-ekonomike e Grave

Të drejtat ekonomike të grave përfaqësohen me nivelin e pjesëmarrjes në forcat e punës, mbajtjen e vendit të punës dhe pagës. Por shumë faktorë sot pengojnë zhvillimin e mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat e reja si dhe punësimin e tyre. Detyrimet e shumta ndaj familjes, rritjes së fëmijëve, mungesa e kualifikimit përkatës profesional, kurseve, aksesit i vogël ndaj pronës dhe pamundësia në këtë mënyrë për të marrë kredi për zhvillim biznesi privat, janë vetëm disa prej pengesave që hasen nga gratë. Edhe në ditët e sot vazhdojnë të mbeten ende strukturat tradicionale shoqërore të cilat nuk i krijojnë shumë hapësira angazhimit të gruas në biznes dhe vendimmarrje, fuqizimit të saj ekonomik apo angazhimit të pavarur.

3.6 Demografia

3.6.1 Popullsia⁴⁵, Tendenca e Lëvizjeve, Migrimi

Popullsia e Bashkisë Kukësit sipas të dhënave të gjendjes civile pranë kësaj bashkie është 60,800 banorë. Popullsia e qytetit të Kukësit përbën 34% të popullsisë totale të Bashkisë së Kukësit. Popullsia mesatare për njësi të qeverisjes vendore në këtë qark rezulton 4,053

⁴⁴ Të dhënat e Censurit 2011 nxorën një nivel papunësie në masën 50% të forcave të afta për punë.

⁴⁵ Burimi i të dhënave mbi popullsinë është Bashkia Kukës, Drejtorja e Gjendjes Civile.

banorë/NJA, ose 50.6% më e ulët se mesatarja kombëtare prej 8,016 banorë/NJA. Njësitë më numrin më të vogël të banorëve janë Arrën dhe Kalis.

Dendësia mesatare është 66 banorë/km². Qyteti i Kukësit, si qendër urbane ka dendësi popullsie 1,597 banorë/km², ndërsa në zonat e tjera dendësia nuk kalon 100 banorë/km², përveç NJA Shtiqen me dendësi rreth 112 banorë/km². Ka njësi ku dendësia arrin në shifra fare minimale si Arrën (afërsisht 9 banorë/km²). NJA që janë larg nga qendra, janë pak të banuara dhe me ndërveprime shumë të dobëta, duke qenë të distancuara nga Kukësi si qendra e bashkisë.

Analizat e kohëve të fundit nxjerrin në pah dy tendenca të rëndësishme lidhur me popullsinë: (i) **shpopullimi i përgjithshëm** (ii) dhe **shpopullimi i ndjekur nga migrimet ndër-rajonale nga zonat rurale në qendrat urbane**.

Vitet e fundit popullsia e Qytetit të Kukësit u rrit me 3.8%, ndërsa në njësitë e tjera administrative ajo ka rënë me 2.5%. Sic tregohet edhe nga harta e mëposhtme, njësi administrativet që kanë përjetuar rënien më të madhe janë; Kalis (42.8%), Kolsh 30.6%, dhe Topojan (12.8%)⁴⁶. Shifrat më të ulëta të dendësinë janë vërejtur në njësi administrativet Arrën (9 banorë/km²)⁴⁷. Harta tregon lëvizjet e popullsisë, ku ngjyra kafe e fortë tregon ku kanë rezultuar lëvizjet më të mëdha dhe koncentrimi i popullsisë.


Faktorët kryesorë që kontribuojnë në këto zhvillime demografike janë të lidhura me tranzicionin ekonomik: mbylljen e shumë ndërmarrjeve në pronësi shtetërore dhe papunësisë që e shoqëroi; infrastrukturën e transportit dhe të komunikimit tepër të dobët; terrenit në përgjithësi të vështirë; kushteve të pafavorshme klimatike dhe bujqësore, etj. Migrimi nga zonat rurale në ato urbane brenda qarkut lidhet gjithashtu me kushtet e vështira të punës në bujqësi, produktiviteti i ulët i këtij sektori dhe aksesit i kufizuar ndaj shërbimeve në zonat rurale.

Tabela 2: Popullsia dhe dendësia

Njësitë e Qeverisjes Vendore	Popullsia	Dendësia Banorë/km ²
Kukës	20698	1597
Shtiqen	3365	112
Malzi	3853	25
Tërthorë	3698	55
Zapod	3141	83
Surroj	1810	23
Bicaj	6536	76
Shishtavec	5075	79
Arrën	568	9
Grykë Cajë	1910	21
Bushtricë	1936	53
Kolsh	2340	59
Kalis	934	28
Topojan	2495	35
Ujmisht	2441	50
TOTAL	60800	66

Burimi: Bashkia Kukës, Drejtoria e Gjendjes Civile

Harta 13: Lëvizja e Popullsisë



⁴⁶ Në hartë këto zona janë shënuar me ngjyrë bezhë të celët. Strategjia e Zhvillimit Rajonal Kukës, 2012-2016

⁴⁷ Në nivel qarku në krahasimin 2001-2011 ka pasur një rënie prej 23% si ndër shifrat më të larta për shkak të emigracionit. (shih Shqipëri: Popullsia dhe Dinamikat e Saj-Horizonte të Reja Demografike? - INSTAT, Maj 2014)



Në rang qarku, Kukësi paraqitet me një normë neto migrimi prej -9.6 në vitin 2014.⁴⁸ Ndërsa raporti ndërmjet të ardhurve e të larguarve nga zona paraqet një balancë të thellë negative të migracionit të brendshëm me përjetimin e një fluksi shumë më të larta dalës të popullsisë, krahasuar me fluksin hyrës (32% me 68%).⁴⁹

3.6.2 Struktura e Popullsisë

Popullsia Bashkisë Kukës përbëhet nga një popullsi relativisht të re duke qenë një karakteristikë që e dallon atë edhe në rang vendi⁵⁰. Tendencat e tre grup-moshave kanë qenë pak a shumë të qëndrueshme që nga viti 2006. 49% e popullsisë e përbën moshë e aftë për punë dhe pjesa tjetër 14% përbëhet nga fëmijët (mosha e re) dhe 37% e përbën grup moshë 65 vjet e lartë. Koeficienti i shkallës së mbulimit për të rinjtë është në total 76%, dhe paraqitet më i lartë edhe se vetë mesatarja e koeficientit për gjithë qarkun e Kukësit (46.3%)⁵¹. Po kështu, edhe shkalla e mbulimit për të moshuarit paraqitet e lartë nëse e krahasojmë me mesataren për qarkun e Kukësit (12.4%)⁵², apo në rang vendi. Kjo nënkupton një barrë të konsiderueshme të personave të varur brenda njësive ekonomike familjare dhe ekonomisë së zonës në përgjithësi. Kjo shkallë varësie vjen si rezultat i shkallës së lartë të lindjeve që vazhdon të jetë më e larta në republikë.

Shtimi natyral i popullsisë në shtatë vitet e fundit paraqitet me një mesatare prej 120 banorë në vit.

Prespektiva e ardhshme lidhur me dinamikën e popullsisë e parë nën këndvështrimin edhe të tregut të punës paraqitet pozitive, me tendencë në rritje të fuqisë punëtore të aftë për punë në të ardhmen. Kjo tendencë nga ana tjetër shtrihet përpara sfidën e ndërrmarjes së politikave të duhura për tregun e punës me qëllim punësimin e kontigjenteve të reja që i shtohen tregut të punës.

3.7 Strehimi

Megjithëse këto vitet e fundit popullsia e qytetit nuk është rritur (ka ndryshime të vogla), qyteti ka marrë një zhvillim në aspektin urban ku janë realizuar shumë ndërtime të reja banesash private kryesisht në Lagjen e Re si dhe në fshatrat rreth qytetit e rrethinat e tij. Sipas të dhënave një banesë në zonën e Kukësit ka mesatarisht 2.92 dhoma.

Numri i banesave sociale aktualisht është 62 banesa, të cilat janë të tëra në përdorim. Ndërkohë që kanë aplikuar për statusin si të pastrehë 706 familje⁵³. Nga këto familje kanë përfutur kredi të lehtësuara nga Enti Kombëtar i Banesave 232 familje.

Pra sic duket dhe nga të dhënat një investim i vecantë duhet për të rritur numrin e banesave sociale për grupet në nevojë dhe kjo mund të jetë e mundur nëse Bashkia operon me një fond të vetëadministruar prej saj për këtë arsye. Por dhe ndertesa private të pashfrytëzuara mund të merren nën administrim prej Bashkisë e cila mund ti shpërndajë sipas kërkesave për banesa sociale të përkoshme apo të përhershme.

⁴⁸ Shih INSTAT "Vjetari Statistikor Rajonal 2015"

⁴⁹ Idem

⁵⁰ Shih INSTAT "Shqipëri Projektionet e Popullsisë 2011-2031" Maj 2014

⁵¹ Shih INSTAT "Vjetari Statistikor Rajonal 2015".

⁵² Sipas të dhënave të Census 2011: shih Shqipëri:Popullsia dhe Dinamikat e Saj-Horizonte të Reja Demografike? - INSTAT, Maj 2014

⁵³ Burimi Bashkia Kukës



3.8 *Infrastruktura*

Infrastruktura Rrugore: Aksi Durrës – Morinë është një pjesë e akseve rrugore kombëtare që lidhin Kosovën dhe Shqipërinë e cila kalon nëpër këtë rajon. Rrugët kryesore që lidhin pjesën qendrore të rajonit, qytetin e Kukësit me rajonet e tjera janë: aksi Durrës-Kukës (1.5 orë), aksi Kukës-Peshkopi (1,5-2 orë), Kukës-Has aksin (30-40 minuta), aksi Kukës-Shishtavec (30 minuta) dhe aksi Krumë-Curri (1 orë dhe 45 minuta).

Në këtë rajon ndodhet pika kryesore e kalimit kufitar që lidh Shqipërinë me Kosovën, Morinë / Kukës dhe 4 (katër) pika të tjera kufitare (Shishtavec / Kukës, Orgjose / Kukës, Borje / Kukës për këmbësorët dhe Qafë Prush / Kukës për transportin e mallrave dhe automjeteve).

Edhe pse krijimi i autostradës Durrës-Kukës-Morinë ka krijuar një lehtësi e madhe e aksesit në qytet nga brenda shtetit, si dhe duke krijuar ura lidhëse me kombet e tjera, infrastruktura e brendshme që përfshin njësitë administrative ende ka nevojë për punë për shkak të terrenit të vështirë dhe kushteve të pafavorshme klimatike.

Bashkia e Kukësit ka 122.5 kilometra akse rrugore rajonale dhe 181 kilometra rrugë kombëtare, ose përkatësisht 67% të të gjithë rrjetit rrugor rajonal të Qarkut Kukës . Niveli i infrastrukturës rrugore lë shumë për të dëshiruar edhe pse investimet kanë qënë të shumta. Tani, rreth 119 km të rrugëve rurale në këtë rajon, vazhdojnë të jenë të paasfaltuara. Koha e udhëtimit nga Bashkia Kukës si qendër administrative e deri në Njësinë Administrative më të afërt merr rreth 47 min, ndërsa në qendrat më të largëta rreth 150 minuta (Arrën, Ujmisht, Bushtricë, Kalis).

Me rritjen e territorit mund të krijohet mundësi për shërbimet e njësive administrative, në të cilat banorët e këtyre njësive mund të marrin shërbimet e nevojshme në fushën që u duhet.

Përdorimi i transportit publik nga qytetarët për lëvizje ndërmjet zonave të ndryshme është tepër minimal (0.6%). Niveli më i lartë i përdorimit të transportit publik rezulton në Shtiqën me 2.9%. Pjesa tjetër e shërbimeve të transportit ofrohet nga sektori privat nëpërmjet shërbimit të furgonave dhe shërbimit taksi. Aktualisht, infrastruktura e fragmentuar ndërmjet bashkive e njësive administrative bën që aksesin ndaj këtij transporti të jetë i ulët. Në gjithë zonën mungojnë stacionet e udhëtarëve, c'ka bën që lëvizja e automjeteve dhe pikat e ndalimit të pasagjerëve të vendosen arbitrarisht edhe pa një plan të caktuar të pikave të transportit urban e ndërurban.

3.9 *Infrastruktura Aeroportuale*

Aeroporti i Kukësit është një favor me perspektivë për këtë zonë duke qënë aeroporti i dytë më i madh në Shqipëri. Qyteti i Kukësit shërben si pikë lidhëse mes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë. Avantazhi strategjik i këtij aeroporti është vendndodhja kyçe midis këtyre tre shteteve që në një të ardhme të afërt do lehtësojë komunikimin ekonomiko-shoqëror midis tre vëndeve fqinje. Edhe pse është ndërtuar që në vitin 2004 në qytetin e Kukësit, për shkak të koncesionit të Aeroportit të Rinasit, Aeroporti i Kukësit nuk është në gjendje pune. Por ky aeroport përbën një mundësi për mbarë rajonin dhe kryesisht për zhvillimin turistik vendas.



3.10 Telekomunikacioni

Shërbimet e ofruara, përpos telefonisë, janë ISDN, ADSL dhe shërbimi “pay-phone”. Shtrirja territoriale që mbulohet nga shërbimi i fundit, kufizohet në kabina “pay-phone” të ndodhura vetëm në zonën administrative të Bashkisë Kukës. Duke qënë se nuk ka të dhëna të përditësuara sipas Njësive të Qeverisjes Vendore, të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë Qarku i Kukësit renditet një ndër dy qarqet me penetrim më të ulët në të gjithë territorin e Republikës, me më pak se 3%.

Këto statistika janë një avantazh për Bashkinë Kukës nëse marrim parasysh ndryshimin infrastrukturor që imponohet me ndërrimin e sistemit në fibra optike ose krijimi i një rrjeti që mbulon të gjithë territorin me pika shërbimi “ëëëireless”.

3.11 Elektriciteti⁵⁴

Elektrifikimi i qytetit të Kukësit ka përfunduar në vitin 1975. E megjithatë nevoja për përmirësim të rrjetit sa vjen edhe shtohet. OSHEE ka nisur investimet për vitin 2015 në Bashkinë Kukës. Vlera e këtij investimi shkon deri në 26.1 milionë lekë dhe konkretisht konsiston në vendosjen e një rrjeti të ri me kapacitet 20kV, rinkonstruksioni dhe ndërtimi i kabinave 20/0.4 dhe blerja e makinerive apo pajisjeve të nevojshme.

Qyteti i Kukësit furnizohet nga 5 fidera (burime energjie elektrike) të ndryshëm që ndahen në 85 kabina elektrike. Ndërsa pjesa tjetër e Njësive Administrative të Bashkisë Kukës furnizohen nga 8 fidera që ndahen në 216 kabina elektrike. Ndarja sipas pikave të nënstacioneve të furnizimit vijon si më poshtë:

- Bashkia Kukës (me përjashtim të NJA Bushtricë, Grykëçajë, Kalisë, Malzi, Surroj dhe Kolsh) furnizohet nga nënstacioni elektrik në fshatin Rexhepaj të NJA Shtiqen e cila është ndërtuar në vitin 1967 dhe ka një kapacitet prej 10KË.
- NJA Bushtricë, Grykëçajë dhe Kalisë furnizohen me energji elektrike nga nënstacioni i Fushë Aliaj (që i përket rajonit të Dibrës).
- NJA Malzi, Surroj dhe Kolsh furnizohen me energji elektrike nga nënstacioni i Kalimashit.

Humbjet në rrjet për qytetin e Kukësit janë në nivelin 45%⁵⁵, ndërsa niveli i arkëtimeve mbetet i ulët: (i) 15% nga abonentët familjarë; (ii) 70% nga abonentët privatë dhe 80% nga abonentët me statusin institucione shtetërore.

3.12 Ujësjellës-Kanalizime

Ndërmarrja e ujësjellës-kanalizime Kukës ka formën ligjore Sh.A dhe i shërben qytetit të Kukësit dhe dy njësive administrative Shtiqen dhe Bicaj. Ajo i shërben një popullsie rreth 40,000 banorë me një orar mesatar furnizimi me ujë prej 9 orësh në ditë dhe një cilësi uji brenda normave⁵⁶. Shërbimi i jepet 25,000 banorëve që jetojnë në qytet dhe 15,000 banorëve që jetojnë në fshatra⁵⁷. Sipas të dhënave për Kukës UK Sh.A. 39,600 banorë e marrin shërbimin në shtëpi, ndërsa 400 të tjerë në cezma publike. Ndërsa shërbimi i sistemit të

⁵⁴ Të dhënat janë marrë nga burime të fundit të OSHEE

⁵⁵ Të dhënat janë nga OSHEE për vitin 2014

⁵⁶ Analizimi i situatës dhe të dhënat janë të vlefshme për vitin 2013.

⁵⁷ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizime (DPUK)



ujërave të zeza i ofrohet vetëm banorëve të qytetit 100% ndërsa banorëve të njësi administrativeve të tjera nuk i ofrohet fare ky shërbim.

Prodhimi i ujit është me rënie të lirë gjë që lehtëson kostot operative të ndërmarrjes. Gjatësia totale e sistemit të ujësjellësit është 115.6 km të cilat ndahen në 25.1 km tubacionet e rrjetit kryesor dhe 90.5 rrjeti dytësor ose shpërndarës. Sistemi kryesor dhe dytësor i tubacioneve përbëhet nga materiale të ndryshme ku 0.18 % e zënë tubacionet prej celiku⁵⁸.

Niveli i faturimit të ujësjellësit nuk realizohet 100%. 17.5% e ujit është i pafaturuar. Kjo diferencë vjen për shkak të dëmtimeve të rrjetit dhe carjeve të tubacioneve të cilat janë në një nivel shumë të lartë – 2681 carje në total.

Pjesa më e madhe janë klientët pa matësa 61% ndërsa sipas vendodhjes (qytet ose fshat) klientët e qytetit zënë 69% të totalit.⁵⁹ **Mbetet problem zonat informale dhe të drejtat e pronësisë mbi kanalizimet dhe tubacionet e ujësjellësit. Kjo çështje do të jetë një nga prioritetet e Bashkisë në të ardhmen me qëllim që të realizohet një hartë e qartë e shërbimeve për të gjithë zonën, përfshirë edhe zonat informale.**

Shërbimi i KUZ ofrohet vetëm qytetit të Kukësit. Gjatësia totale e sistemit është 32 km dhe e gjitha është material prej betoni. Numri total i lidhjeve me sistemin është 3,434. Vëllimi total i ujit që faturohet për KUZ është 459.9 mijë m³. Vetëm 60.4% e shërbimit arrin të faturohet, ndërsa norma mesatare e arkëtimit është 55,3%.

Ndërsa në njësitë e tjera administrative shërbimi i ujësjellësit ofrohet nga vetë njësi administrative (Shishtavec, Terthore, Kolsh, Malzi, Topojan, Ujmisht, Grykë-Cajë, Arren, Surroj). Furnizimi i banorëve me ujë në disa fshatra bëhet përmes cezmave publike gjë që e bën mjaft të vështirë situatën e banorëve.

Përmirësimi i situatës së ujësjellës-kanalizimeve kërkon marrjen e një sërë masash për përmirësimin e shërbimit, të tilla si: (i) riorganizimi i prodhimit e trajtimi i ujit; (ii) përmirësimi i menaxhimit dhe rrjedhimisht një shërbim më të mirë dhe efikas banorëve; (iii) forcimi i kontrollit sanitar dhe krijimi i sistemeve të nevojshëm për klorifikim dhe dezinfektim të ujit sipas standarteve; (iv) rritja e nivelit të faturimit nëpërmjet gjetjes së mënyrës më efikase për vjeljen e faturave; (v) përmirësimi i infrastrukturës nëpërmjet rritjes së investimeve publike; (vii) rritjen mbulimit të zonës me infrastrukturën dhe shërbimet e kanalizime të ujërave të zeza; të drejtat e pronësisë dhe vlerësimi i saktë i inventarit të aseteve të Bashkisë.

3.13 Analiza e pronave publike

Hapsirat publike⁶⁰

Kukësi mund të konsiderohet si një "qytet i rrethuar nga natyra", kjo është edhe për shkak të përmasave të tij modeste. Vendi përreth praktikisht në shumicën e rasteve është ruajtur në gjëndjen e tij natyrore, kjo është arsyeja pse nuk ndihet mungesa e parqeve periferike. Zona më e rëndësishme ku natyra bëhet e pranishme në qytet, ndodhet në brigjet e liqenit, përgjatë së cilës është e mundur prania e hapësirave të hapura, duke përfshirë vende natyrore që banorët e qytetit i shfrytëzojnë si plazhe në sezonin e verës.

⁵⁸ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizime (DPUK)

⁵⁹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizime (DPUK)

⁶⁰ Të dhënat për hapsirat publike i referohen vetëm qytetit të Kukësit, pasi të dhënat janë mundur të sigurohen vetëm për qytetin e Kukësit.



Për sa i takon hapësirave “bosh” në brendësi të qytetit dhe lidhjes së tij me hapësirat e jashtme mund të themi se rolin kryesor këtu e luajnë rrugët sipas kurrizeve të kodrës ku shtrihet qyteti të cilat të lidhin me territorin e jashtëm nëpërmjet panoramës dhe pamjes së malit të Gjalllicës që ndodhet në prespektivën jug-lindore të tyre. Elemente të tjerë të rëndësishëm të boshit të brendshëm janë edhe hapsirat publike në mes të komplekseve të banimit si edhe zona e shkollave me sheshet e hapura dhe terrenet sportive, dhe ish - industriale.

E rëndësishme për t’u përmendur është se si nga projektuesit e qytetit është konceptuar një shëtitore përgjatë bregut jug-perëndimor të liqenit, e cila ka përmasa shumë të mëdha dhe që nga njëra anë mbetet e “zbuluar” në hapësirën rrethuese, duke bërë kështu ndërfutjen e dy hapsirave boshe me njëra – tjetrën.

Plani i Përgjithshëm Vendor duhet të përcaktojë qartë destinacionin e zonës së gjelbëruar jashtë qytetit të Kukësit si të rëndësishme dhe si një pjesë të natyrës pranë qytetit, që në pjesën jugore të saj, bën lidhjen e brendshme të hapësirës së qytetit me hapsirat e jashtme. Kjo do të ndihmojë për të krijuar vazhdimësinë sa më organike midis këtyre hapësirave dhe për të rritur efektin psikologjik të gjelbërimit në qytet. Kjo do të shihet në kontekstin e organizimit të hapësirave rurale në formën e një "parku territorial", ku rrugët rurale duhet t'i nënshtrohet dëmshpërblimit ekzistues me qëllim për të theksuar peisazhet më të mira që rrethojnë qytetin.

Plani i Përgjithshëm Vendor duhet të gjithashtu të shikojë mundësinë e zbutjes së kufirit të qytetit me hapësirën në pjesën jug-perëndimore të tij. Ndoshta një brez me volume të ulta, që njëkohësisht do të ishin në forcimin e idesë së një rekreacioni përgjatë shëtitores kryesore, e cila aktualisht mbetet e rrezikuar sidomos në periudhën e ftohtë. Duhet të studiohen lidhjet e hapësirave të brendshme të zonës së re të qytetit midis tyre nëpërmjet korridoreve të cilat potencialisht ekzistojnë në brendësi të qytetit për t'i bërë këto korridore pjesë të “lexueshme” të qytetit, si dhe të frenojë mënyrën se si qyteti tenton të shtrihet horizontalisht në boshin natyror dhe bujqësor, duke e copëzuar hapësirën në një mënyrë të çrregullt dhe jo uniforme dhe duke krijuar peisazhe të shëmtuara.

3.14 Analiza e marrëdhënieve të pronësisë mbi tokën

Të dhëna mbi Pronësinë⁶¹

Nga pikëpamja e pronësisë në hartën e qytetit të Kukësit dallojmë disa zona si më poshtë:

- **Zona që u janë kthyer pronarëve** dhe në përgjithësi nuk paraqesin probleme pronësie. Këto sipërfaqe janë të shpërndara në të gjithë territorin e qytetit.
- **Zona që përgjithësisht nuk paraqesin probleme pronësie.** Gjithësesi, në këto zona paraqiten raste të konflikteve pronësore midis shtetit dhe pronarëve të vjetër. Më të shumta këto raste janë për objektet publike.
- **Zona ku njihen pronarët, por që po përdoren për qëllime të tjera** dhe nga pronarë të rinj privatë ose publikë. Kjo është zona e bregut jugor të liqenit, pranë qytetit dhe në drejtim të ish-Hotel Turizmit.
- **Zona informale, njihen pronarët por pronat janë zënë nga ndërtimet pa leje** të vetë pronarëve ose janë pushtuar nga banorë të shpërngulur nga fshatrat përreth. Zona të tilla

⁶¹ Të dhënat janë mundur të sigurohen vetëm për qytetin e Kukësit.

përmendim ato që shtrihen në pjesën lindore të qytetit, e quajtur "Lagjia e re" dhe Zona Informale No 1. Në Zonen Informale 1, Sipërfaqja prej 16,246 m² është sipërfaqe në pronësi të pronareve private ndërsa 60 ha tokë e Zonës Informale 1 është e pa pronësuar (pa pronarë), është tokë që administrohet nga shteti. Në bazë të ligjit 7850, në Zonen Informale 1 ka ndodhur shpronësimi 52 parcela ndërtimore me sipërfaqe trualli 14, 891.

- **Zona ku pronarët e banesave kanë pronësi mbi tokën**, në kuadër të Ligjit 7501, për ndarjen e tokës bujqësore. Kjo është zona në jug të qytetit, e populluar në përgjithësi nga banorë të ish-fshatit Gostil, që sot është lagje e qytetit. Zona Informale 2 përfshin një pjesë të ndërtimeve të Lagjes Gostil e cila është pjesërisht nën pushtetin e ndërtimeve informale. Sipas ligjit 7501 pjesa për tu pronësuar është një sipërfaqe rreth 30 – 35 ha.

- **Zona industriale**, ku mund të radhitim ish-Kombinatit e Drurit, ish-Uzinën Mekanike, Fabrikën e pijeve etj. Këto zona janë privatizuar nga shteti dhe përdoren për qëllime industriale ose thjesht nuk janë në përdorim. Në këtë zonë sipërfaqe shtetërore të privatizuara janë 18 ha.

Harta 14: Harta e Pronësisë dhe Zonave Informale



- **Zona të ish NB-Kukës**, të cilat janë në proces të kalimit të pronësisë mbi bashkinë Kukës. Këtu përfshihen një pjesë e tokave – Kjo është zonë e ndërtimeve Informale. Pronësia e truallit është shtetërore sepse nuk është bërë kalimi mbi njësinë e qeverisjes vendore. Kjo



zonë kufizohet me Gostilin dhe Shtiqen . Zona ka sipërfaqe prej 50 ha. Zona përdoret kryesisht për ndërtim me funksion banime dhe më pak shërbime.

3.15 Objektet e rëndësishme kombëtare

Disa nga elementet e rëndësishme që trajton PPV-ja, kanë ndikim në një shkallë më të gjërë se qyteti, pra shtrijnë ndikimin e tyre në një shkallë rajonale ose kombëtare. Nga më kryesoret mund të përmendim: (i) Autostrada; (ii) Aeroporti; (iii) Tregu Rajonal; (iv) Burimet historike ; (v) Spitali rajonal; (vi) Pasuritë Ujore; (vii) Pasuritë pyjore dhe kullotat dhe (viii) Radio Kukësi

1- **Autostrada Durrës - Kukës:** Rruga e Kombit përbën aksin kryesor të hyrjes për në qytet si dhe një ndër elementët kryesorë të zhvillimit jo vetëm të Kukësit por dhe të rajonit më gjërë. Per ta kthyer këtë autostradë në një element pozitiv për zhvillimin e mëtejshëm të Kukësit dhe jo në një element ndarës të tij nga territori përreth, duhet të përcaktohen akset strategjike për zhvillime të reja ekonomike të rëndësishme rajonale, si edhe lidhjen e qytetit me këtë arterie në më shumë se një pikë (pa dëmtuar funksionin e saj si rrugë shpejtësie). Kjo do të bëjë që Kukësi të ekspozohet sa më mirë nga kjo rrugë e re dhe të mos mbetet i “harruar” nga flukset në drejtim të Prishtinës dhe të Tiranës. Duhet ti kushtohet rëndësi të veçantë trajtimit të fashës midis qytetit ekzistues dhe arteries së re të autostradës duke përcaktuar qartë kufinj të zhvillimit në këtë territor dhe duke krijuar breza me gjërësi të përshtatshme ku mund të akomodohen njësi me aktivitet ekonomik dhe shërbime. Kjo do ti japë frymëmarrje qytetit për zonat e reja të banimit, sepse do të largojë njësitë ekonomike që kërkojnë sipërfaqe relativisht të mëdha dhe ndoshta dhe ndotëse nga qyteti. Meqënëse fusha në periferi synohet të mbetet zonë agropeizazhistike me aktivitet kryesor bujqësinë urbane, brezi përgjatë autostradës dhe fushës mund të ofrojë lehtësira ekonomike për përpunimin e tregëtimit e produkteve bujqësore.

2- **Aeroporti:** Dhe pse akoma nuk ka filluar funksionimi i tij, aeroporti mbetet një nga faktorët më të rëndësishëm në rajon dhe në qytetin e Kukësit që do të gjenerojë zhvillim dhe do të vendosë qytetin në një kontekst të ri në rajon në lidhje me një hapsirë më të gjërë, sepse e tillë do të jetë edhe rrezja e mbulimit të shërbimeve të tij.

3- **Burimet historike:** Vendbanimet e lashta Ilire të gjetura në zona të ndryshme të Kukësit si vendbanimi neolitik i Kolshit që i takon një kohe rreth 4000 vjet para Krishtit, Tuma e Qinamakut që përfaqëson nekropolin tumular (varrezë kolektive) nga më të mëdhatë në Shqipëri e më gjerë, tumat e Kënetest, janë një element i rëndësishëm që plotësojnë tablonë e gjetjeve të tjera të këtij niveli në gjithë vendin. Gjithashtu, janë një nga elementet kryesore që mund të gjenerojnë zhvillimin e qytetit si elementë të rëndësishëm të zhvillimit të turizmit historik.

4- **Pasuritë ujore:** Kukësi është i dyti me rezervat më të mëdha ujore në vend pas Shkodrës, në të cilin ndodhen basenet e hidrocentraleve Fierzë dhe Koman të ngritur mbi lumin Drin dhe shtrijnë ndikimin e tyre në gjithë vendin. Liqeni i Kukësit është një nga liqenet artificiale më të mëdha në vend. Me një gjatësi prej 72 km dhe një sipërfaqe prej 8169 ha, ky liqen përbëhet nga 40 gjire. I krijuar në 1978 nga lumenjtë Drin i Bardhë, Drin i Zi dhe lumi I Lumës është habitat i 13 llojeve të peshqve, molusqeve, gaforreve dhe amfibeve. Është i përshtatshëm për udhëtime me target, udhëtime turistike me anije, peshkim dhe banjë dielli.

5- **Tregu Rajonal:** Qyteti ka një traditë të krijuar për të qënë tregu kryesor në rajon dhe një element i rëndësishëm i tij është tregtia ndërkufitare. Ky element duhet të theksohet dhe të gjejë mbështetje në propozimet e PPV. Tregu aktual shtrin rrezen e tij në një pjesë të mirë të



njësive administrative përreth Bashkisë, duke përfshirë këtu edhe banorë të Rretheve Has dhe Tropojë. Ndërkohë një element me rëndësi për t'u përmendur është tregëtia ndërkufitare. Parë në një perspektivë afatgjatë, kjo dinamikë e pritshme rritjeje nënkupton më shumë klientelë për tregun e ri të qytetit, më shumë kërkesë për hapësira ekonomike tregtare, më shumë zhvillim. Kjo dinamikë implikon konsideratën e ndërtimit të një tregu të ri në kontekstin e një qyteti në rritje, me hapësira më të mëdha dhe më të shumta për aktivitete tregtare, me shërbime më cilësore etj.

6- Spitali Rajonal: Spitali i Kukësit është vendosur në pjesën veriperëndimore të qytetit në një sipërfaqe prej 2.02 ha. Në strategjinë e menaxhimit të spitalit mendohet të shtohen funksionet e tij dhe të rritet gama e shërbimeve për të rritur kështu rrezen e mbulimit.

7- Pasuritë Pyjore dhe Kullotat: Pyjet dhe kullotat zënë rreth 50% të sipërfaqes së përgjithshme në qarkun e Kukësit ku rrethi i Kukësit ka një sipërfaqe pyjore 44 mijë ha.

8- Institucionet Mediatike, Radio Kukësi: Që më 16 tetor 1959, kur u dha sigla zanore "Ju flet Kukësi...", kjo radio ka afirmuar vlerat në ruajtjen e ndjenjës kombëtare të gjuhës, kulturës dhe historisë, sidomos të shqiptarët jashtë kufijve si në Kosovë e Maqedoni. Koha vlerëson si të pazëvendësueshme punën e radios që identifikohet me emrin e qytetit.

9- Monumentet e kulturës: Monumentet e kulturës të shpallura dhe në proces shpalljeje për Bashkisë së Kukësit jepen të renditura në tabelën 3 ku përshkruhen të gjitha objektet me këtë status.

Tabela 3: Monumentet e trashëgimisë kulturore të shpallura

NR	EMRI I MONUMENTIT	FSHATI	NJËSI ADMINISTRATIVE	BASHKI	KATEG.	VITI I SHPALLJES
1	KESHTEJELLA E BUSHATIT	BUSHAT	BICAJ	KUKËS	I	05.11.1984
2	KALAJA E VILES	VILE	BUSHTRICE	KUKËS	I	05.11.1984
3	HISARI NE DOMAJ	DOMAJ	BICAJ	KUKËS	I	05.11.1984
4	GRADISHTA E BARDHOCIT	BARDHOC	TERTHORE	KUKËS	I	05.11.1984
5	BANESA E ASLLAN FETAHUT (NURI SHAQIRI DHE NEZIR ASLLANI)	BICAJ	BICAJ	KUKËS	I	10.06.1973
6	BANESA E HASAN REXHEPIT (PRONAR RAM REXHEPI)	SHTAN		KUKËS	I	08.01.1977
7	BANESA E RUSTEM SHAHINIT (GEZIM ALI SHAHINI)	OSMAN BICAJ	BICAJ	KUKËS	I	10.06.1973
8	SHKOLLA E VJETER E BICAJT (AKTIVITETET E REVOLUCIONIT TE QERSHORIT)	BICAJ	BICAJ	KUKËS	I	10.06.1973

Burimi: Këshilli i Qarkut Kukës

3.16 Analiza e elementeve të rëndësishme territoriale

Elementët e rëndësishëm territorialë, të dalë nga analiza metabolike janë ato elemente ku do bazohet procesi i hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për të nxjerrë në pah karakteristikat e zonës dhe për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm.

Përsa i përket gjithë territorit të Bashkisë Kukës ndër elementët e rëndësishëm territorialë mund të përmendim:

- 1. Elementët e rëndësishëm natyrorë:** (i) Vargamalet; (ii) Lumenjtë dhe brigjet e tyre; (iii) Liqeni i Fierzës dhe liqene të tjerë artificial ose natyror; (iv) Pyjet dhe (v) Zonat e mbrojtura dhe monumentet natyore




2. **Elementët e rëndësishëm administrativë** si pikat kufitare që e kthejnë Bashkinë e Kukësit në një prej Portave Kryesore të vendit tonë
3. **Zonat e zhfrytëzimit minerar**
4. **Zonat me rëndësi për infrastrukturën e transportit dhe atë energjetike** (ekzistuese dhe të parashikuara në PPK): (i) Korridori 10 dhe planet për zgjerimin; (ii) Aeroporti; (iii) Stacioni i ri multimodal; (iv) Landfilli i parashikuar
5. **zonat e banuara dhe territori i parashikuar për zhvillim**
6. **zonat me rëndësi ekonomike**

Më poshtë është bërë një përshkrim i elementëve kryesorë gjenerues të transformimit hapësinor të Qytetit të Kukësit si qendra kryesore të Bashkisë. Transformimi hapësinor i qytetit të Kukësit do të ndodhë në përputhje të plotë me objektivat e zhvillimit ekonomik dhe social të tij. Nevojat për krijimin e hapësirave për biznesin dhe për lehtësirat në shërbimet sociale të qytetit do të pasqyrohen nga pikpamja hapësinore përmes PVP të Bashkisë së Kukësit. Ndërhyrjet konkrete janë në vetvete elementi gjenerues në transformimin hapësinor të Kukësit dhe janë rezultat i kombinimit të masave apo ndërhyrjeve të karakterit ekonomik me ato fizikë dhe ndërtimore. Këto elemente janë strategjike sepse do të influencojnë jo vetëm formën urbane, por edhe të sjellin një kulturë të re jetese dhe të influencojnë në jetën e banorëve. Elementet gjenerues bazohen mbi parimet hapësinore të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe përqëndrohen në:

- Fashat urbane të Qytetit
- Rrjeti rrugor dhe lidhja me korridorin lindje-perendim dhe rajonin
- Tregu rajonal
- Evidentimi dhe ruajtja e vlerave urbane të qytetit
- Spitali Rajonal
- Ndërtimi i lehtësirave për turizmin
- Zona ekonomike përgjatë autostradës
- Forcimi i zonave ekonomike ekzistuese
- Zonat e rikuperimit mjedisor
- Zonat e bujqësisë urbane

ELEMENTET E FORTA DHE TË RËNDËSISHME TË TERRITORIT





Këta elementë do jepen në mënyrë të detajuar duke evidentuar mënyrën se si janë trajtuar si dhe ndikimin në qytet.

Rikonceptimi funksional dhe Fashat Urbane të Kukësit

Rikonceptimi funksional i Kukësit merr për bazë shpërndarjen territoriale të funksioneve ekzistuese dhe përpiket të japë një trajtë më të integruar të tyre. Qëllimi nuk është të krijohen njësi administrative krejtësisht të shkëputura por krijimi i njësive më të detajuara, të shpërndara sipas një hierarkie të caktuar në shtresën urbane të qytetit. Vec kësaj disa pole kryesore zhvillimi apo akse gravitacionale duhet të krijohen për të shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme një standard të përmirësuar të cilësisë së jetesës.

Gjatë evidentimit dhe zonimit të funksioneve kryesore në qytet si dhe përdorimin e tokës, është vënë re tendenca e grupimit të funksioneve me karakteristika të veçanta fizike, hapësinore apo tipologjike që i bëjnë lehtësisht të dallueshme nga zonat e tjera. Këto tipare mund t'i atribuohen një elementi urban, gjeografik apo natyror të caktuar. Gjatë hartimit të planit, është bërë evidentimi i këtyre korridoreve ose fashave urbane të cilat tentojnë të tërheqin dhe gjenerojnë aktivitete të ndryshme si dhe fluks të madh të qarkullimit të njerëzve. Këto funksione dominuese janë mbajtur parasysh gjatë hartimit të tabelave të treguesve në mënyrë që misioni i tyre i rikonceptimit hapësinor dhe funksional i qytetit të arrihet plotësisht.

-Fasha ekonomike shtrihet përgjatë aksit kryesor veri-jug të qytetit dhe përfshin brenda saj funksione ekonomike, përpunimi dhe magazinimi si dhe tregëtimi dhe tendenca për zhvillime të ngjashme. Në këtë fashë përfshihen edhe territore të degraduara të ish zonës industriale që kanë nevojë për rivitalizim.

-Fasha e shërbimeve është një integrim i qendrës së konsoliduar urbane me të gjithë zonën në të cilën janë përqëndruar shërbimet kryesore të qytetit.

-Fasha e gjelbërt përmbledh brenda saj natyrë, argëtime dhe sport duke krijuar një hapësirë qendrore publike të re të shkallës së qytetit, me vijueshmeri linere, e cila do të integrojë elementin e gjurmës së përroit me qytetin e Kukësit, me synimin për të sjellë natyrën brenda në qytet.

-Fasha e bregut bashkon brenda kufijve të saj banimin rezidencial dhe parkun periferik me disa funksione brenda: plazh, park zoologjik, botanik, lunapark. Ajo bën një përforsim të lidhjes jug-veri të qytetit, nëpërmjet bregut perendimor të liqenit.

-Fasha e autostradës është një korridor zhvillimi me interes strategjik, që do të tërheqë investitorët me potencialin e lartë që paraqet.

Janë pikerisht fashat elementet kryesore hapësinore që vendosin bazën për mënyrën se si do të trajtohet më në detaje territori i qytetit. Nëse një zonë është edhe pjesë e fashës, nga pikpamja funksionale dhe e formës urbane ajo do të trajtohet ndryshe nga një zonë e cila nuk ndodhet brenda kufijve të fashës. Në rastet kur fashat kryqëzohen me njëra-tjetrën, kjo ndodh në pikat nyje të qytetit, me karakter të fortë katalitik.

3.17 Analiza e elementeve përjashtues

Elementët përjashtues janë zonat ku duhen marrë masa mbrojtëse dhe penguese, ose ato zona ku koha ka treguar që natyra i kundërvihet parashikimeve tona. Termi “përjashtues” në kontekstin e këtij dokumenti ka kuptim kryesisht ndalimin e urbanizimit në disa zona të caktuara, duke i dhënë prioritet një zhvillimi tjetër ose thjesht konservimit.



Ndër elementët kryesorë përjashtues të dalë nga analiza e gjendjes ekzistuese mund të përmendim:

1. Territore ku duhet penguar zhvillimi, për të mundësuar investimet strategjike të së ardhmes
 - zonat e burimeve hidrike, që shërbejnë për furnizimin me ujë e që duhen mbrojtur nga ndotjet
 - zonat ujore që duhen klasifikuar për zhvillimin e turizmit
 - zonat e mundshme për ndërtimin e HEC-eve të tjera përgjatë kaskadës së Drinit

2. Territore ku natyra duhet mbrojtur prej zhvillimit njerëzor
 - rezervatet natyrore
 - pyjet, fauna dhe flora karakteristike
 - zonat me interes historik, kulturor ose arkeologjik
 - zonat ku kushtet klimaterike dhe tradita kanë çuar në zhvillimin e kulturave bujqësore ose blegtorale unike për zonën

3. Territore ku banorët ose investimet strategjike duhet të mbrohen nga rreziqet që ofron natyra
 - zona ku relievi behet pengesë për zhvillimin e infrastrukturës
 - zona ku për shkak të erozionit ka rrezik shkarjesh për pasuritë dhe banorët e bashkisë
 - zona ku pasuritë natyrore, ose shfrytëzimi i tyre pa kriter sjell rrezik për banorët
 - territori i vendburimeve me natyrë radioaktive;
 - territori i burimeve të bakrit e boksideve helmuese;
 - territoret ku kanë qënë vendosur uzinat e përpunimit të materialeve toksike.



4 NDARJA E TERRITORIT SIPAS SISTEMEVE BAZË

Në këtë kapitull jepen udhëzimet dhe parimet e përgjithshme për ndarjen e territorit në pesë sisteme bazë, që duhet të merren në konsideratë gjatë hartimit të PPV-së. Objektivat dhe konceptet e kësaj ndarjeje dalin nga përcaktimet në këto dokumente ligjore kryesore:

- LIGJ Nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"
- VKM Nr. 671, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit"
- Plani i Përgjithshëm Kombëtar

Territori i Njësisë së qeverisjes vendore, për qëllime planifikimi, ndahen në pesë sisteme bazë, si më poshtë:

- Sistemi urban (UB);
- Sistemi natyror (N);
- Sistemi bujqësor (B);
- Sistemi ujor (U);
- Sistemi infrastrukturor (IN).

Këto sisteme duhet të organizohen në marrëdhënie mes qendrave të banuara, korridoreve dhe zonave, mbi bazën e të cilave do të detajohet dokumenti i PPV-së. Ndarja në këto sisteme nuk duhet parë vetëm si përcaktime për përdorimin e tokës, por edhe si mundësi për zhvillimin në përputhje me karakteristikat primare të sistemeve.

4.1 Sistemi Urban

Sistemi urban formohet nga bashkimi i territoreve urbane dhe kufizohet nga vija e gjelbër. "Territori urban" është hapësira gjeografike e vazhdueshme, e ndërtuar nga aktiviteti njerëzor. "Rritja inteligjente" dhe "Zhvillimi policentrik, densifikimi, gjithë përfshirja" janë objektiva dhe politika e përcaktuar për këto sisteme në PPK.

Tendenca e zhvillimit urban në Bashkinë e Kukësit në 25 vitet e fundit është karakterizuar nga 2 tipare kryesore:

- Migrimi drejt rajonit qendror urban (kryesisht në aksin Tiranë-Durrës), territorit të qytetit të Kukësit, ose jashtë territorit të Republikës,
- Shpërhapje urbane në dëm të tokës bujqësore dhe tokës së lirë natyrore

Të dy këta faktorë kanë sjellë si pasojë uljen e ndjeshme të popullsisë në disa fshatra dhe gjendjen gati statike të popullsisë në qytetin Kukës. Në disa zona ka një dendësi mjaft të ulët të popullsisë, gjë që vështirëson efikasitetin e investimeve në infrastrukturë dhe shërbime për këto pjesë të territorit të bashkisë.


Kjo tendencë rezulton në një zhvillim monocentrik të rajonit, me tipare të theksuara të pabarazisë ekonomike dhe sociale. Mungesa e infrastrukturës cilësore, rrugë, kanalizime, shkolla dhe kopshte, kanë bërë që pjesa më e madhe e popullsisë që braktisi fshatin e lindjes për një jetë më të mirë të mos e gjejë atë.

Nga njëra anë një pjesë e territorit karakterizohet nga një depopullim i lartë, mungesë e forcës punëtore, mungesë shërbimesh, kurse nga ana tjetër në qytet kemi përqendrim të popullsisë, por pa infrastrukturë e nevojshme sociale e inxhinierike.

Informaliteti, shpërhapja urbane, stoku i banesave që në shumicën e rasteve nuk plotësojnë kushtet minimale për ndriçim dhe ajrim, ndërtimi masiv në ish zona bujqësore apo natyrore, dhe përsëri mungesa e strehimit për një kategori të popullatës janë tiparet dominuese që karakterizojnë zhvillimin urban të 25 viteve të fundit.

Në paraqitjen grafike të mëposhtme jepen zonat e urbanizuara bazuar Vendimin e KKT nr. 5 datë 29.12.2014 “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e RSH dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban”.

Harta 15: Zonat e urbanizuara – Bashkia KUKËS



Plani Kombëtar prezanton:

- 6 rajone ekonomike parësore
- 9 qendra primare,
- 10 qendra te specializuar,
- 42 qendra lokale

Rajoni Kukës – Prizren është tashmë pjesë e Planit Kombëtar si Rajon Ndërkufitar mes Shqipërisë dhe Kosovës. Duke u nisur nga plani kombëtar, PPV-ja duhet të përcaktojë:

Qendrat primare, në zonat e banuara me popullsi të stabilizuar dhe shërbime bazike të karakterit infrastrukturor, si elementë të hierarkisë lokale. Këto qendra do të mund të intensifikojnë infrastrukturën e shërbimeve primare si arsimi dhe transporti, të përshtatshme për të mbuluar kërkesat e qendrave administrative më të vogla, në rrezen e shërbimit prej 45 min. kohë udhëtimi. Investimet në infrastrukturë do të bëhen me qëllim rritjen e aksesit të popullsisë së zonave përreth drejt qendrave primare.

Qendrat e specializuara, që do të zhvillohen në përputhje me potencialet e tyre dhe karakteristikat specifike të karakterit ekonomik, llojit të aktivitetit bujqësor-blegtoral më të zhvilluar apo tipareve të spikatura natyrore që promovojnë një tip të caktuar turizmi, për tu kthyer në zona tërheqëse për të jetuar e punuar dhe për të tërhequr investime e profesionistë të specializuar. Për t'u veçuar në Bashkinë Kukës janë burimet e shumta minerare dhe përfitimi që do të kish zona nga përpunimi në vend i këtyre pasurive. Orientimi i qendrave të specializuara drejt kësaj lloji industrie (pa lënë pas dore format e tjera të mundshme) do të ishte me interes të madh ekonomik dhe strategjik.


4.2 Sistemi Natyror⁶²

Menaxhimi inteligjent i pasurive natyrore dhe trashëgimisë kulturore siguron ruajtjen e identitetit dhe diversitetit kulturor përballë rritjes e globalizimit. Në të njëjtën kohë i bën aktive dhe kontribuese në rritjen ekonomike të zonës duke i riaktivizuar si asete nëpërmjet përmirësimit të arritshmërisë së përshtatshme të tyre.

"Zhvillimi i qëndrueshëm" dhe "Rritje e zonave të mbrojtura natyrore, promovimi dhe aksesimi i tyre." janë objektivi dhe politika e zhvillimit e përcaktuar, për këtë sistem në PKK.

Përdorimi i tokës si pasojë e rritjes dhe zhvillimit, ka bërë që njëkohësisht të humbasin vazhdimisht sipërfaqe të lira së bashku me funksionet e tyre në ndihmë të ekosistemeve natyrore dhe mbrojtjen e klimës, çlodhjen, si edhe funksionet e tyre të kapacitetit ekonomik për pylltarinë dhe bujqësinë, prodhimin e energjisë së rinovueshme, si edhe mbrojtjen e burimeve të nëntokës së zonave përkatëse. Prandaj në kushtet e një zhvillimi të qëndrueshëm, shfrytëzimi i nëntokës në mënyrë të pakontrolluar dhe fragmentimi i hapësirës së lirë, si edhe në mënyrë të veçantë shfrytëzimi i burimeve natyrore të parinovueshme, duhet të mbahet në një nivel sa më të ulët të jetë e mundur.

Harta 16. Pyjet, zona e mbrojtur dhe munomentet e natyres



Në hartën vijuese janë paraqitur zonat e pyllëzuara, zona e mbrojtur e kategorisë së IV dhe munomentet e natyres në territorin e Bashkisë. Siç konstatohet, përafërsisht 40 % të territorit sipërfaqe të mbrojtur natyrore. Nuk mungojnë gjithashtu mjaft Peisazhe të mbrojtura dhe përafërsisht 60 Monumente Natyrore, por shumë pak të vizituara, dhe aspak të trajtuara si pjesë e ndonjë sektori ekonomik.

⁶² Sistemi natyror (N) përbëhet nga peizazhet, hapësirat e paprekura të natyrës, korridoret ekologjike dhe hapësirat që kanë një kategori bazë të përdorimit "natyrë" dhe në përputhje me legjislacionin e posaçëm. Është detyrë primare e PPV-së të promovojë dhe mundësojë aksesin e zonave me karakteristika natyrore e peisazhistike.

4.3 Sistemi Bujqësor

Sistemi bujqësor (B) përbëhet nga toka bujqësore, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë dhe kanalet, rezervuarët në shërbim të saj⁶³. Sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar:

Objekti kryesor: Eficiencë për një sektor bujqësor konkurrues

Politika: Ruajtje, konsolidim, modernizim.


Duhet përsëritur që konceptimi i sistemit bujqësor nuk konsiston vetëm në zonimin funksional bazuar në përdorimin e tokës, por në evidentimin e mundësive për zhvillim të qëndrueshëm dhe

profilizim të zgjuar. Aq më tepër merr rëndësi ky aspekt në kushtet e Bashkisë Kukës, ku cilësia e ulët e tokës nga njëra anë, dhe kushtet specifike klimatike nga ana tjetër, kërkojnë orientimin e projekteve drejt produkteve karakteristike të zonës.

Zhvillimi dhe ndërtimi në zona bujqësore kryhen sipas dokumenteve të planifikimit dhe legjislacionit të posaçëm për tokën bujqësore. Çdo dokument i përgjithshëm ose sektorial planifikimi që parashikon edhe ndryshim të kategorisë së përdorimit të tokës nga bujqësi në

përdorime të tjera dhe anasjellas shoqërohet, sipas rastit, me aktet përkatëse të ndryshimit sipas legjislacionit të posaçëm. Toka bujqësore zë rreth 15% të territorit të bashkisë Kukës, me rreth 11374.2 ha, një përqindje e vogël krahasuar me mesataren në shkallë vendi (24%) të tokës bujqësore. Duhet theksuar se boniteti i kësaj toke është i cilësisë së dobët dhe me prodhimtari të ulët.

Harta 17. Sistemi Bujqësor – Bashkia KUKES



4.4 Sistemi Ujor

Sistemi ujor (U) është tërësia e burimeve nëntokësore dhe mbitokësore ujore, që përmban të gjithë trupat ujorë, përfshirë brigjet sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm. Sistemi ujor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “ujë”.

⁶³ Sistemi bujqësor formohet nga bashkimi i tokave me kategori bazë të përdorimit të tokës “bujqësinë”. Ky sistem është rezultat i ndërveprimit në kohë midis aktiviteteve njerëzore, për kultivim dhe ndërtim me karakter bujqësor në territor. Zonimi i sistemit bujqësor bazohet në bonitetin e tokës dhe në aktivitete e funksione që zhvillohen brenda këtij sistemi, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.

Procesi i planifikimit dhe zhvillimit në territore, që i përkasin kategorisë bazë të përdorimit “Ujëra dhe ligatina” rregullohet sipas legjislacionit të posaçëm dhe konventave ndërkombëtare në të cilat ka aderuar Shqipëria.

Çdo zhvillim në brigjet ujore, si dhe kufijtë e zonave mbrojtëse përkatëse përcaktohen nga legjislacioni i posaçëm dhe kjo rregullore. Zonat e mbrojtjes përbëhen nga:

- Zonat higjeno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm;
- Një zonë e mbrojtjes së afërt, brenda së cilës do të jetë e ndaluar të kryhet çdo lloj ndërtimi dhe shkarkimi, përveçse ndërtimeve për mbrojtjen e trupit ujor;
- Një zonë e mbrojtjes së largët, brenda së cilës ndërtimet do të jenë objekt lejeje administrative para marrjes së lejes së ndërtimit.

Ndërtimi i veprave dhe objekteve për shfrytëzimin e rezervave ujore dhe për parandalimin e veprimeve të dëmshme të ujit janë objekt i lejeve administrative ose koncesioneve, kur këto janë brenda kuadrit të shërbimeve publike.


Është i ndaluar magazinimi i materialeve dhe lëndëve, që mund të shpëlahen në ujë dhe ndërtimi i objekteve të reja në zonat e kërcënuara nga përmbytjet.

Menaxhimi shkencor i ujit dhe energjisë ka qenë dhe mbetet një target thelbësor me pasojë të rëndësishme për të sotmen dhe mirëqenien e brezave të ardhshëm.

Bashkimi Evropian ngulmon, që rritja ekonomike nuk duhet të kondicionohet me përdorimin intensiv të burimeve në përgjithësi e sidomos të atyre ujore e energjetike në veçanti. Kjo duhet të kompensohet me zhvillimet në teknologji efektive për ruajtjen e bilanceve të përdorimeve të tyre me kërkesat në rritje të nevojave jetike për to: të ruajtjes dhe të rigjenerimit të tyre. Raportet aktuale midis rritjes ekonomike, konsumimit të resurseve ujore e energjetike dhe prodhimit të mbetjeve të ndryshojnë në mënyrë thelbësore. Zhvillimi ekonomik duhet të shoqërohet me përdorimin racional e të qëndrueshëm të burimeve të ujit dhe energjisë, me prodhimin e sasive të kufizuara të mbetjeve, duke ruajtur biodiversitetin, ekosistemet dhe mënjeluar transformimin e mjedisit në djerrinë.

Bashkia Kukës zotëron burime të mëdha hidrike. Në territorin e saj kalon lumi Drin me dy degët e tij, me një sipërfaqe ujëmbledhëse totale prej 25022 km² dhe baseni i Liqenit të Fierzës me sipërfaqe 72.5 km². Me rëndësi është të nënvizohet se këto burime përfshihen në burimet natyrore të ripërtëritshme dhe janë pjesë e rëndësishme e sektorit të energjisë

Harta 18. Sistemi Ujor – Bashkia KUKES



kombëtare, që mbështetet rreth 99% në burimet hidrike. Si të tilla janë ndoshta pasuria natyrore më e madhe dhe më e rëndësishme e vendit, kjo për shkak të një cilësie të veçantë që nuk e zotëron as edhe një pasuri tjetër. Ato janë të pashtershme dhe të rinovueshme.

4.5 Sistemi Infrastrukturor

Sistemi infrastrukturor (IN) përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës, në nivel kombëtar, nivel qarku dhe vendor. Sistemi infrastrukturor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “infrastrukturë”.

Sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar:

Objektivi kryesor: Integrimi hapësinor, rritja e aksesueshmerisë së vendit dhe shpërndarje e balancuar të flukseve.

Politika: Krijimi dhe konsolidimi i një Sistemi të integruar multimodal mbarë kombëtar, rritje dhe konsolidim i pikave të aksesit dhe të lidhjes së territorit.


Me qëllim realizimin e integritit hapësinor të vendit dhe të shpërndarjes së balancuar të flukseve brenda territorit të tij, aplikimi i korridoreve të planifikuara nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar qëndron në themel të Sistemit Infrastrukturor të PPV-së së Bashkisë Kukës. Ky plan duhet më tej, të parashikojë korridoret prioritare për lidhjen e qendrave prioritare të territorit të bashkisë në një rrjet të integruar multimodal.

Me formulimin e kërkesave të aksesueshmerisë për qendrat kryesore dhe sekondare duhet të garantohet roli qendror i tyre dhe të sigurohet cilësia e qendrave prioritare si pika spirancë në hapësirën dhe mobilitetin e njerëzve për sa i përket ofrimit të shërbimeve publike. Më tej, hierarkizimi i rolit të këtyre qendrave, kërkon vendosjen e prioriteteve lidhur me sigurimin, zgjerimin, dhe sipas rastit ngritjen e rrjeteve dhe korridoreve të reja infrastrukturore dhe mirëfunksionimin e tyre.

Nga PPK-ja vijnë disa zhvillime të rëndësishme për bashkinë Kukës që janë prioritate në Sistemin Infrastrukturor:

- Parashikimi i aeroportit të ri në Kukës.
- Përvijimi i Korridorit Strategjik, pjesë e Korridorit 10, Durrës – Kukës – Morinë.
- Stacion i ri Intermodal në Kukës, që do të përmbushë nevojat ndërkombëtare dhe tranzitore të lëvizjes dhe shkëmbimit të modaliteve të transportit me vendet e tjera
- Si qendër kryesore

Harta 19. Infrastruktura rrugore dhe qendrat e banuara





urbane, Kukësi shndërrohet në qytete çelës, portë hyrje - dalje kombëtare. Qytet ku intersektohen jo vetëm rrugë kombëtare të rëndësisë së parë që na lidhin me korridoret evropiane por edhe siguri për transport e shkëmbim mallrash alternativ nëpërmjet transportit ajror.

Një përparësi themelore është krijimi i furnizimit të vazhdueshëm, me ujë të pijshëm në të gjitha banesat dhe bizneset. Po kështu, përmirësimet, zgjerimet dhe në disa raste zhvillimi i të gjithë sistemeve të ujërave të zeza dhe drenazhimit, përveç rrjeteve rrugore dhe një shërbimi efektiv dhe gjithëpërfshirës për mbledhjen e mbeturinave (duke përfshirë një mjedis landfill-i të ri), janë të domosdoshme për një cilësi më të mirë të jetës në njësitë administrative. Veç kësaj, rreziqet potenciale sizmike dhe kërcënimi nga rrëshqitja e tokës do të konsiderohet gjatë rinovimeve të ndërtesave ekzistuese dhe gjatë planifikimit dhe ndërtimit të ndërtesave të reja dhe lagjeve tërësisht të reja. Cilësia mjedisore dhe garantimi i shërbimeve publike, duke përfshirë cilësinë e ajrit, shëndetit, arsimit e kështu me rradhë, duhet të theksohen dhe të përmirësohen. Rritja e këtyre sistemeve dhe shërbimeve do të rrisë aftësinë e Bashkisë Kukës për t'u ofruar banorëve të vet një cilësi më të mirë jetese.

4.6 *Tabela përmbledhëse*

Në tabelën 17 jepen në mënyre të përmbledhur gjithë informacioni që duhet të përmbajë Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Kukës, për të konsideruar të plotë përcaktimin e cilësive të territorit sipas Sistemeve të sipërpërmendur.



Tabela 4: Elementet për përcaktimin e cilësisë së territorit

	Territori	Zona	Njësia
Sistemi Urban	1. Sipërfaqja e territorit urban (Stu. të përgjithshme); 2. Sipërfaqja e infrastrukturës/banore 3. Popullsia (ekzistuese dhe e parashikuar/piramida e popullsisë); 4. Strehimi privat/social 4. Shërbime administrative; 5. Shërbime sociale/banorë, arsim/banorë dhe shëndetësi/banorë; 6. Transporti publik dhe privat (nr. makina/ familje) 7. Ndarja në zona; 8. Sipërfaqet e gjelbra/ banorë dhe sportive/ banorë; 9. Hapësira kulturore dhe për rekreacion/banore; monumentet dhe objektet e trashëgimisë kulturore; 10. Detyrimet në lidhje me kërkesat fetare; 9. Intensiteti për ha; 10. Parkime/banore; 11. Indikatorët ekonomikë (GDP / sektorë / lloji bizneseve/çmimet/punësimi/ punësimi për sektor /taksat vendore/borxhi/shpenzimet sipas sektorit); 12. Pronat publike dhe private; 13. Tendencat e zhvillimit në territor	a) hapësira publike; b) kategoritë e banimit; c) Nënkatëgoritë e banimit; ç) Sipërfaqja bruto; d) Sipërfaqja neto; dh) Dendësia për ha; e) Dendësia për ha = njësi/banimi për ha; f) Sipërfaqja e infrastrukturës; g) Gjellbërimi në nivel zone; gj) Parkimi; h) Ndarja në njësi; i) Vlëra e tokës	Ksht Kshr Kshp I (Intensiteti) L (në kate dhe metra) Gjellbërimi/banorë Parkimi/banorë Nr. banorësh Nr. përdoruesish Shërbimet Nënkatëgoritë e lejuara Funksionet/aktivitetet e lejuara
Sistemi Bujqësor	Sip. Territor bujqësor; Sip. Primar (Boniteti I-IV); Sip. Territor Bujqësor Dytësor (Boniteti V-X); Sip. T Bujqësor me sistem ujëtieje; Sip. T Bujqësor pa sistem ujëtieje; Sip. T. Pafryt	Kategoria Bazë Nënkatëgoria Ndarja në njësi	Ksht/ Kshr/ Kshp I (Intensiteti) L (në kate dhe metra) Nënkatëgoritë e lejuara Funksionet/aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara
Ujor	Ujëra tokësore	Sip- Liqene Lumenj Përrenj Ligatina	
Sistemi Infrastruktura	Sip. rrugë kombëtare Sip. rrugë interurbane Sip. rrugë urbane parësore Aeroporte Gaz-sjellës Elektrik Ujësjellës-Kanalizime Menzhim mbetjesh		
Sistemi Natyror	Sip. e përgjithshme Sip. pyjore Sip. Kullota Sip. të gjelbra (jo urbane) Zona të mbrojtura sipas legjislacionit të posaçëm	Kategoria Bazë Nënkatëgoria Ndarja në njësi	Ksht/ Kshr/ Kshp I (Intensiteti) L (në kate dhe metra) Nënkatëgoritë e lejuara Funksionet/aktivitetet e lejuara Dhe të ndaluara



5 DREJTIMET E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE PROBLEMATIKAT NË BAZË TË TREGUESVE TË SISTEMEVE

Në Kapitullin e mësipërm, u shqyrtuan 5 sistemet bazë për ndarjen e territorit, jo vetëm në aspektin e thjeshtë sipërfaqësor, por duke diskutuar parimet respektive të zhvillimit, objektivat dhe konceptet cilësësore me anë të të cilave interpretohen elementët ekzistues të sistemeve dhe projektimet e të ardhmes.

Nga sa më sipër duhet të nënvizojmë si parime të përgjithshme pikat e mëposhtëme:

1. Dhënien prioritet maksimal të gjithë projekteve të Infrastrukturës, në nivel transporti dhe energjetik, si sektor me rëndësi kombëtare dhe strategjike.
2. Evidentimin dhe mbrojtjen e zonave natyrore në territorin e bashkisë Kukës.
3. Mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotjet dhe aktiviteti njerëzor.
4. Disiplinimin e zonave urbane dhe përcaktimin e kriterëve të qarta të zhvillimit të zonave të banuara.

Në mënyrë më të detajuar, sipas çdo Sistemi, dalin si më të rëndësishëm objektivat e poshtëshënuar:

5.1 Zhvillimi Urban

Sistemi urban i Bashkisë mund të përkufizohet sipas indikatorëve të mëposhtëm:

- **Kompaktësia.** Bashkia ka në përbërjen e vetë vetëm një qendër të banuar kompakte, që është qyteti I Kukësit. Zonat e tjera janë me kompaktësi të ulët.
- **Përqëndrimi ndaj aksit.** Nisur nga përvoja aktuale, është me vend të mendojmë që aksi “Durrës-Kukës” do të tërheqë zhvillimi përgjatë tij.
- **Centralizimi.** Zhvillimi i fortë urban i qytetit të Kukësit mund të çojë në përthithjen prej tij të popullsisë nga gjithë qendrat e banuara të territorit të bashkisë, madje edhe nga bashki kufitare.

Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm, Sistemi Urban bazuar në direktivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Analizës Metabolike të Bashkisë Kukës duhet të zhvillohet në bazë të këtyre prioritete kryesore:

- **Zhvillim Policentrik hapësinor** dhe një marrëdhënie të re Urban –Rurale
- **Përcaktimi i zonave urbane prioritare**, krahas qytetit Kukës, që të funksionojnë si një lidhëse për fshatrat më pak të populluara dhe si lokalitet për shpërndarjen e shërbimeve.
- **Kontroll i ekspansionit fizik** të qytetit Kukës dhe zonave të urbanizuara **duke promovuar densifikimin në vend të shpërhapjes urbane;**
- **Përcaktimi i saktë i vijave të gjelbëra kufizuese** për zonat urbane, duke marrë parasysh legalizimin e zhvillimeve të deritanishme.
- **Përcaktimin me vizion të zonave të zhvillimit të mëtejshëm** në bazë të sugjerimeve të PPK-së dhe tendencave demografike.
- **Akses më i mirë në një infrastrukturë multimodale** e cila është jo vetëm më efektive por edhe miqësore ndaj ambientit;



- **Funksione mikse dhe komplementare;**
- **Përdorim dhe menaxhim inteligjent i ekosistemit urban** në veçanti i ujit, energjisë dhe menaxhimit të mbetjeve.
- **Konservim dhe zhvillim të trashëgimisë historike kulturore,** në kuptim të përmirësimit dhe të aktivizimit të këtyre aseteve në jetën urbane.
- **Hierarkizimin e qendrave dhe profilizimin e tyre** në akomodimin e sektorëve ekonomikë të përshtatshëm duke shfrytëzuar potencialet ekzistuese.
- **Orientimin e investimeve** të qeverisjes qendrore, lokale dhe të donatorëve për mbulim 100% me shërbime parësore për qytetaret duke garantuar cilësinë e jetës urbane.

5.2 Zhvillimi Natyror

Aspektet mjedisore nuk shihen thjesht si ruajtje e territorit nga veprimtaria e njeriut, por si konservimi i asetit kryesor në shërbim të njeriut dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Pra si parim kryesor evidentojmë që natyra dhe ruajtja e mjedisit janë asetet kryesore që bashkëveprojnë potencialisht me sektorët e tjerë të ekonomisë së zonës

Me përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe lidhjen e përgjithshme të Bashkisë Kukës me rajonin, rritet niveli i aksesimit të tij nga banorë të ndryshëm jo vetëm të Shqipërisë, Kosovës por dhe shteteve të ndryshme të rajonit dhe më gjerë. Kjo bën që Kukësi të mund të shihet dhe si një qytet mbi të cilin mund të zhvillohet turizmi alternativ si ai i agroturizmit, eko-turizmit, etj.

- Kukësi, si vija e parë e vendit për vizitorët nga Kosova;
- Identifikimi, mbrojtja dhe mirembajtja e parqeve dhe pasurive natyrore, Faunës dhe Florës specifike. Element i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës, bazuar në shfrytëzimin e mençur të burimeve natyrore;
- Turizmi malor dhe natyror. Përvijimi i itinerarëve përgjatë zonave malore dhe sipërfaqeve të veshura me pyje. Kombinimi i këtyre itinerareve me element të trashëgimisë historike, kulturore dhe kulinare të zonës.

Synimi i PPV-së për 2030 do të jetë shtimi i sipërfaqes së zonave të mbrojtura 20 % për tokën dhe 12-15 % të sipërfaqes ujore. Ruajtja dhe shtimi i zonave të mbrojtura natyrore do të bëhet nëpërmjet:

- Vendosjes së prioritetit të përdorimit të Zonave të lira natyrore, me përparësi mjedisin.
- Rrjeti i rrugëve me biçikletave (apo dhe këmbësore) që akseson zonat natyrore me vlera peisazhistike natyrore si dhe në zonat e trashëgimisë historike dhe kulturore duhet të jetë një prioritet për Bashkinë Kukës.
- Krijimi dhe konsolidimi i Korridoreve lidhëse Natyrore përgjatë luginave ujore të cilët bëjnë njëkohësisht lidhjen e qëndrueshme të sistemit të zonave të mbrojtura, por edhe ruajtjen e sistemit ujor.

Njëkohësisht PPV-ja duhet të evidentojë:

- **Zonat me rrezikshmëri natyrore** ndaj njeriut si rrjedhim i erozionit, rrezikut sizmik, prezencës së mineraleve të dëmshme për shëndetin, etj.



- *Zonat e degraduara* prej aktiviteti njerëzor, si punime minerare, depozitim mbeturinash, shfrytëzim i pa kriter i burimeve natyrore, etj. Të vendosen objektiva kohorë për rikthimin e këtyre zonave në gjendjen e mëparshme.
- Të përcaktohen *fasha mbrojtëse* për këto zona, që funksionojnë si hapësirë “tampon” ndaj efekteve të dëmshme që mund të kenë ndaj banorëve të bashkisë.

5.3 Zhvillimi Bujqësor

Plani i Përgjithshëm Vendor e bazon zhvillimin e territorit të Sistemit bujqësor sipas këtyre objektivave kryesore:

- *Ruajtje maksimale e fondit të tokës bujqësore*, me anë të politikave të densifikimit të zhvillimit urban. “Asnjë ndërtim i ri në tokë bujqësore që nuk i shërben Sistemit Bujqësor”.
- *Vendosja e një rrjeti eficient të zinxhirit ekonomik bujqësor*: prodhim – grumbullim – përpunim - eksportim, me qëllim rritjen e vlerës së zinxhirit ekonomik.
- *Krijimin e tregjeve & rrugëve lidhëse* për inkurajimin dhe mbështetjen e zinxhirit të vlerës së produkteve bujqësore
- *Ulja e kostos dhe rritje e cilësisë* nëpërmjet investimeve në:
 - teknologjinë e prodhimit për modernizimin e saj;
 - investime në infrastrukturën e mirëmbajtjes, kanale ujitëse, vaditëse, hidrovore, etj.
- *Integrim dhe bashkëpunim* me sektorët e tjerë të ekonomisë:
 - **Bujqësi – Turizëm**: ku veçantia e sektorit turistik të zonës identifikohet lehtësisht edhe nga produktet bujqësore karakteristike në shije e cilësi.
 - **Bujqësi – Transport**: infrastruktura e transportit i shërben rrjetit eficient të shpërndarjes dhe grumbullimit të prodhimeve bujqësore.
 - **Bujqësi – Energji**: ku energjia e përdorur në përpunimin e produkteve bujqësore shkon drejt përdorimit të burimeve të rinovueshme.
- *Krijimi i qendrave të specializuara bujqësore dhe profilizimi i tyre* sipas karakteristikave të prodhimit lokal.
- *Specializim në prodhim dhe përpunim të prodhimeve dhe produkteve karakteristike*:
 - Bimë Mjekësore
 - Pemë frutore dhe arvore
 - Vreshtat me varietete të përshtatshme për klimën.
 - Perime karakteristike të zonës (patatja)
 - Produkteve bujqësore të përpunuara

5.4 Zhvillimi Ujor

Shumë e rëndësishme është njohja e potencialit ujor të rrjetit hidrografik të bashkisë , që do të përfshijë elemente të tillë të rëndësishëm të natyrës së zonës si, burimet, liqenet, lumenjtë, ujërat nëntokësore, si dhe hapësirën e rëndësishme që zë liqeni artificiale i Hidrocentralit të



Fierzës, me rëndësi energjetike dhe strategjike, si rregullatori i parë i gjithë kaskadës së Drinit.

Strategjia lidhur me burimet hidrike dhe potencialin ujqr këto objektiva kryesore të cilat do të udhëheqin edhe PPV-në:

- Prioritet maksimal mbrojtjes së burime hidrike të zonës.
- Përcaktimin e vijës blu, të mbrojtjes së sipërfaqeve hidrike dhe fashat mbrojtëse të kërkuara nga kuadri ligjqr.
- Përcaktimi i fashës së mbrojtës së lumenjve nga burimet potenciale të demtimit dhe ndotjes, si:
 - Shfrytëzimi i pakontrolluar i inerteve,
 - Vend depozitime të mbetjeve urbane
 - Aktivitet bujqësor e industrial i konsiderueshëm.
- Evidentimi i zonave të rrezikshme për njeriun si rezultat i përmbajtjeve, ose që janë në rrëgjim kënetor.
- Evidentimi i zonave të ndotura nga aktiviteti njerëzor dhe përcaktimi i afateve kohore për mundësinë e rigjenerimit të tyre.
- Përcaktimi i zonave të përshtatshme për zhvillim turistik ujqr.
- Përcaktimi i zonave me prioritet zhvillimin e peshkimit dhe infrastrukturës së nevojshme.

5.5 Zhvillimi Infrastrukturor

Bashkia Kukës duhet të karakterizohet nga standarde të larta shërbimesh dhe do t'iu ofrojë banorëve të saj një cilësi të mirë jete. Ajo do të jetë një bashki tërheqëse ku njerëzit të kërkojnë të jetojnë, punojnë, argëtohen dhe vizitojnë ose pushojnë. Bashkia do të ofrojë shërbime urbane cilësore sipas standardeve moderne deri në nivelin e qendrave primare. Duhet të sigurohet furnizimi me ujë të pijshëm në mënyrë të vazhduar, një sistem efektiv të trajtimit të ujërave të zeza, një rrjet drenazhimi (kanalizime të ujrave të bardha) me kapacitet të mjaftueshëm për të drejtuar vërshimet e ujit të stuhive dhe një rrjet rrugor që lehtëson aksesin dhe lëvizjen nëpër të gjithë territorin e bashkisë.

Objektivat e Bashkisë Kukës në lidhje me pjesën e transportit në Sistemin infrastrukturor janë:

- *Integrimi i prioriteteve që vijnë nga Plani i përgjithshëm Kombëtar*, duke përcaktuar hapësirat e nevojshme
- *Përcaktimi i zonave mbrojtëse* ku nuk lejohet zhvillimi për tre objektivat kryesore që vijnë nga PPK: Aeroporti, Korridori 10, Stacioni intermodal.
- *Parashikimi i rrjetit të transportit që mundëson lidhjen e shpejtë të qendrave fqinje urbane me Kukësin* si qendër kryesore urbane.
- *Parashikimi i rrjetit të transportit që mundëson lidhjen e shpejtë të qendrave prioritare të bashkisë me qytetin e Kukësit*, si qendër që ofron shërbime publike të specializuara e të avancuara.



- *Hartimi i projekteve të përbashkëta ndërkufitare* me fokus rritjen e konektivitetit dhe përmes përmirësimit të infrastrukturës së transportit.
- *Promovimi i transportit publik qytetas* dhe ndërqytetës i transportit alternativ nëpërmjet infrastrukturës së butë, rrugë për biçikleta dhe këmbësorë.
- *Ngritjen e terminalit të pasagjerëve* si stacion multimodal ndërqytetas, sipas standarteve të Bashkimit Evropian për sigurinë dhe aksesueshmërinë në transport.
- *Klasifikimi rrjetit rrugor ekzistues* dhe të parashikuar të bashkisë në:
 - rrjet të kategorisë I
 - rrjet të kategorisë II
 - rrjet të kategorisë III
- *Përcaktimi i “Vijës së kuqe”* ose vijës së ndërtimit të rrugës për çdo tip rrjeti dhe korridori të përfshirë në Sistem. Vija e kuqe është kufiri i lejuar për vendosjen e një ndërtimi në anët e trupit të rrugës që i referohet ose vija kufizuese e të gjithë brezave mbrojtës, si p.sh., brezat mbrojtës të përcaktuar nga Kodi Rrugor, të zonave të mbrojtura nga legjislacioni i mjedisit, kulturës, energjisë etj., si edhe breza mbrojtës të përcaktuar nga dokumentet e planifikimit.
- *Unifikimi i korridoreve të transportit me korridoret energjetike* jo vetëm për korridoret në plan për t’u hartuar, por edhe duke vlerësuar rrjetin ekzistues.
- *Mirëmbajtja dhe restaurimi i të gjithë strukturës urbane* është një zhvillim tjetër prioritar për të siguruar një cilësi më të lartë të jetës. Rrugët urbane, hapësirat publike dhe të gjelbërta, të tilla si parqet, kopshtet, sheshet e lojërave, mjediset sportive dhe rikrijuese, duhet të rriten dhe të krijohen në gjithë bashkinë. Kjo bën thirrje për implementimin e strategjive të reja; për shembull: mbjelljen e pemëve dhe programet për ndriçimin e rrugëve, zhvillimin e një hierarkie të rrugëve të bashkisë dhe kultivimin e hapësirave të reja me gjelbërim të lartë. Aplikimi i masave për të rinovuar strukturën urbane të Kukësit, do të promovojë rritjen e bashkisë dhe jetën e banorëve.

Rritja e cilësisë së jetës për të gjithë banorët në mënyrë të barabartë përfaqëson një aspekt të rëndësishëm të PPV-së dhe Bashkia duhet të ndjekë integrimin social të popullsisë së saj duke krijuar masat për reduktimin e hendeqeve sociale, të tilla si një rrjet perkujdesjeje shoqërore të fortë, dhe të ngushtojë hendeqet në zhvillimin urban, e sidomos problemeve të infrastrukturës në zonat informale. Duke bërë këtë, do të përmirësohet aksesimi ndaj shërbimeve dhe krijimi i një Sistemi të infrastrukturës efektiv dhe të qëndrueshëm për të gjithë banorët e bashkisë.

Objektivat e strategjisë në lidhje me pjesën e energjisë dhe sistemeve të tjera në Sistemin infrastrukturor janë:

- Propozimi i metodave dhe projekteve për të patur një rrjet eficient me kursim të energjisë dhe përdorim të energjisë së rinovueshme:
- Përcaktimi i zonave të nevojshme për stacionet energjetike dhe infrastrukturës së shërbimeve të tjera publike, për përmirësimin e rrjetit ekzistues dhe shtrirjes së tij në qendrat primare.
- Përcaktimi i zonave mbrojtëse të njeve stacionare të Infrastrukturës ku nuk lejohet zhvillimi.



- Planifikimin e impiantit të pastrimit të ujërave urbane para derdhjes së tyre në Liqenin e Fierzës
- Parashikimin e masave për eliminimin e mbeturinave urbane të bashkisë (landfill).

Në përfundim mund të themi që drejtimet e zhvillimit të territorit bazuar në pese sistemet bazë, do të synojnë:

1. *rritjen e cilësisë së shërbimeve publike ndaj qytetarëve* dhe të qasjes së tyre në këto shërbime (punësimi, shëndeti, edukimi, kultura, mbrojtja sociale, etj);
2. *rritjen e efikasitetit, inkurajimin e flukseve të mallrave, të energjisë, dhe të informacionit* brenda bashkisë dhe me bashkitë përreth, për të nxitur dinamikën pozitive dhe vitalitetin e komunitetit;
3. *planifikimin dhe zhvillimin e një strukture urbane* që trajton gjithë territorin si një njësi të vetme, duke harmonizuar zhvillimin e territorit dhe elementët e sistemeve bazë.

5.6 Problematikat e evidentuara

Ndër problematikat kryesore të dala nga analiza e gjendjes ekzistuese mund të përmendim:


- a. *Cilësia e dobët e tokave bujqësore të Bashkisë Kukës*, si pengesë jo e vogël për zhvillimin prioritar që i jepet këtij Sistemi Bazë (Bujqësisë);
- b. *Dendësia e ulët e zonave të banuara periferike dhe tendenca migruese e popullsisë*, që rrezikon efikasitetin e investimeve në infrastrukturë dhe ofrimin e shërbimeve;
- c. *Transformimi i Kukësit në një Qendër kryesore Urbane*, e shoqëruar me zhvillimin e sektorit të energjisë dhe atij minerar, mund të rrezikojë resurset natyrore të bashkisë, e veçanërisht burimet hidrologjike të tij;
- d. *Zhvillimi i akseve të forta të transportit*, nyje e fortë e të cilit kthehet qyteti i Kukësit, rrezikon ekzistencën e zonave të banuara periferike të Bashkisë, duke vështirësuar Zhvillimin Policentrik hapësinor të territorit, si cilësi e rëndësishme për Hierarkinë e qendrave të banuara.

6 VIZIONI I ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TË NJËSISË VENDORE

Strategjia e Zhvillimit të Bashkisë së Kukësit udhëhiqet nga një vizion i përbashkët ndryshimi dhe zhvillimi të metejshëm që në qendër të tij ka përmirësimin e mirëqenies, jetës së banorëve të zonës dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ky vizion është:

Kukësi vijë e parë hyrëse atraktive e vendit në kufirin veri-lindor që u ofron qytetarëve të tij mirëqënie, dhe mundësi për kthimin e potencialeve të pasura natyrore, kulturore e sociale në vlera ekonomike e sociale.

Skema e Vizionit



Ky vizion mbështetet në tre shtyllat kryesore që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik: **Zhvillimin e Bujqësisë, Zhvillimin e Turizmit dhe Industrisë Minerare.**

Zhvillimi i këtyre sektorëve do të mund të realizohet nëse do të zhvillohen e fuqizohen më tej, nëpërmjet zhvillimit dhe modernizimit të **Sistemeve të infrastrukturës të zhvilluara, Zhvillimit të Kapaciteteve dhe Cilësisë së Tregut të Punës dhe Kapitalit njerëzor.**

I gjithë ky zhvillim do të mbaj parasysh dhe do të realizohet duke siguruar **Mbrojtjen dhe Konservimin e mjedisit si aseti kryesor në shërbim të komunitetit dhe zhvillimit ekonomik**



të qëndrueshëm" duke kontribuar në këtë mënyrë në zhvillimin e harmonizuar e të balancuar.

Shtyllat e mësipërme që mbështetin arritjen e vizionit përcaktojnë edhe prioritet kryesorë të politikave zhvillimore strategjike që parashikohet të zbatohen në vitet e ardhshme dhe që do të sigurojnë rritjen e rolit të Bashkisë së Kukësit në sistemet kombëtare të zhvillimit dhe në mënyrë të vecantë zhvillimin lokal, i parë në gjithë dimensionet e tij social, ekonomik e ambjental.

Vizioni mund të realizohet përmes objektivave strategjike të mëposhtëm dhe zbatimit të një plani të harmonizuar zhvillimi, i cili do të zbatohet nga aplikimi i instrumentave të shumtë financiarë si dhe përdorimi optimal dhe sa më eficient i burimeve financiare dhe njerëzore.

7 OBJEKTIVAT STRATEGJIKË PËR ZHVILLIMIN E TERRITORIT TË NJËSISË VENDORE

Realizimi i objektivave strategjike të mësipërm, do të materializohet nga zbatimi i Planit të Zhvillimit i cili do të operacionalizohet nëpërmjet zhvillimit të programeve dhe projekteve të ndryshme të investimeve.

Strategjia e zhvillimit sipas secilit prioritet të politikave do të realizohet përmes objektivave strategjike të mëposhtëm dhe zbatimit të një plani të harmonizuar zhvillimi nëpërmjet zhvillimit të programeve dhe projekteve të ndryshme të investimeve, kombëtare dhe lokale.

Shtyllat e Politikave Objektivat e Zhvillimit dhe Masat për realizimin e tyre

Prioriteti I Bujqësi Konkuruuese e bazuar në *zhvillimin e promovimin e produkteve organike* dhe shfrytëzimin e balancuar të pasurive natyrore

Objektivi I.1 Ruajtje maksimale e fondit të tokës bujqësore dhe zhvillimi i infrastrukturës bujqësore

Masa 1: Ruajtja e fondit të tokave bujqësore dhe përmirësimi i cilësisë së tokave nëpërmjet masave agro-teknike;

Masa 2: Rehabilitimi dhe shtimi i sistemeve të ujitjes;

Masa 3: Formalizimi i pronësisë së tokës.

Objektivi I.2 Ulja e koston dhe rritje e cilësisë së produkteve bujqësore dhe vendosja e një rrjeti eficient të zinxhirit ekonomik dhe të vlerës të sektorit bujqësor

- **Masa 1:** Promovimi i iniciativave private për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë agro-përpunuese;

- **Masa 2:** Krijimi i kushteve lehtësuese për ngritjen e pikave të reja të grumbullimit dhe ruajtjes së produkteve bujqësore e blegtorale;



- **Masa 3:** Ngritja e qendrave frigoriferike për ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale;
- **Masa 4:** Zgjerimi i skemave të këshillimit bujqësor në drejtim të sigurimit të cilësisë së produkteve bujqësore e blegtorale.

Objektivi I.3 Rritja e profilizimit dhe specializimit të produkteve bujqësore me orientim sa më të madh drejt prodhimeve BIO

- **Masa 1:** "Logoja e Cilësisë dhe Traditës" . Shtrirja e procesit të certifikimit të prodhimeve bio nën logon "*AL-Quality Products-KS*". me qëllim promovimin e produkteve organike dhe tradicionale në tregun rajonal dhe europian turistik (*lidhja bujqësi-turizëm ndërkufitar*);
- **Masa 2:** Përcaktimi i zonave me prioritet zhvillimin e peshkimit, dhe peshkatarisë sportive, dhe infrastrukturës së nevojshme.

Prioriteti II : Turizëm , Eco-alternativ që promovon potencialet natyrore që ofron reliev tërheqës dhe i pashfrytëzuar malor e liqenor, dhe **vlerat historike e kulturore**

Objektivi II.1 Zhvillimi i infrastrukturës në mbështetje dhe funksion të turizmit

- **Masa 1:** Hartëzimi i infrastrukturës e lehtësirave që ekzistojnë dhe duhet të zhvillohen përqark qendrave dhe pikave me potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit;
- **Masa 2:** Zhvillimi i shërbimeve lehtësuese përqark qendrave dhe pikave me potenciale të mëdha për zhvillimit e turizmit;
- **Masa 2:** Zhvillimi i rrjetit të rrugëve për biçikletat (apo dhe këmbësorë) që akseson zonat natyrore me vlera peisazhistike natyrore si dhe në zonat e trashëgimisë historike dhe kulturore;
- **Masa 3:** Përcaktimi i zonave të përshtatshme për zhvillim turistik ujor.

Objektivi II.2 Promovim intensiv i vlerave kulturore dhe historike të zonës

- **Masa 1:** Identifikimi, mbrojtja dhe mirëmbajtja e parqeve dhe pasurive natyrore të zonës, Faunës dhe Florës specifike;
- **Masa 2:** Realizimi i aktiviteteve promovuese me operatorët turistike dhe OJF-të në nivelin kombëtar dhe rajonal;
- **Masa 3:** Hartimi i kalendarit të eventeve historike dhe kulturore lokale.

Objektivi II.3 Rritja e tërheqjes turistike nëpërmjet zgjerimit dhe alternimit të ofertës turistike të brëndshme dhe rajonale



- **Masa 1:** ***Turizmi malor dhe natyror.*** Përcaktimi i itinerarëve përgjatë zonave malore dhe sipërfaqeve të veshura me pyje. Kombinimi i këtyre itinerareve me elemente të trashëgimisë historike, kulturore dhe kulinare të zonës;
- **Masa 2:** ***Oferta turistike rajonale:*** Krijimi i ofertave të kombinuara rajonale që përfshijnë itinerare udhëtimi dhe eksplorimi të vlerave natyrore e historike brënda zonës verilindore ;
- **Masa 3:** ***Oferta turistike ndërkufitare:*** Krijimi i ofertave turistike që përfshijnë pikat turistike dhe qendrat historike të zonave ndërkufitare të Kukësit & Tropojës (Shqipëri) dhe Prizrenit & Gjakovës (Kosovë);
- **Masa 4:** ***Traditat kulinare - bio turizmi:*** Promovimi intensiv i prodhimeve që marrin logon " ...". në tregun rajonal dhe europian turistik (*lidhja turizëm- bujqësi*).

Prioriteti III Industria Minerare dhe Energjike, Që mbështetet në *shfrytëzimin e kontrolluar të burimeve minerale* dhe hidrike dhe shtimin e vlerës

Objekti i III.1 Shfrytëzimi i burimeve minerale dhe hidrike në mënyrë të qëndrueshme dhe ngritja e kapaciteteve përpunuese me qëllim rritjen e vlerës së shtuar.

- **Masa 1:** Rritja e bashkëpunimit dhe e transparencës me qëllim shfrytëzimin e kontrolluar për nxjerrjen e përpunimin e mineraleve;
- **Masa 2:** Promovimi i teknologjive më të mira të mundshme për zhvillimin e industrisë përpunuese të mineraleve të nxjerra;
- **Masa 3:** Propozimi I Qeverisë Qëndrore për aplikimin e tarifave lehtësuese për përdorimin e energjisë nga institucione publike;
- **Masa 4:** Diskutimi me Qeverinë Qëndrore për rishikimin e shpërndarjes së % të rentës minerare për pushtetin vendor;
- **Masa 5:** Zhvillimi i qëndrueshëm nëpërmjet planifikimit të ngritjes së fermave diellore apo atyre me erë;
- **Masa 6:** Parandalimi i rrezikut për ndotje të Ujërave dhe Ajrit si pasojë e shfrytëzimit të mineraleve në karrierë dhe mos-zbatimi i kontratave të shfrytëzimit mineral.

Prioriteti IV Kapitali Njerëzor dhe Kapacitete të zhvilluara të tregut të punës

Objekti i IV.1 Orientimi i Arsimit profesional në funksion të tendencave dhe nevojave të ekonomisë lokale.



- **Masa 1:** Ngritja e degëve dhe kurseve të reja në Shkollën Profesionale që t'i shërbejë gjithë Qarkut të Kukësit, me orientim drejt shërbimeve të përgjithshme⁶⁴, shërbimeve të hotelieri - turizmit, kulinarisë, bujqësi – frutikulturë, përpunimit dhe ruajtjes së bimëve medicinale, bletarisë , shërbimeve elektrike etj.

Objektivi IV.2 Zhvillimi i infrastrukturës arsimore me qëllim rritjen e mëtejshme të cilësisë në arsim

- **Masa 1:** Zhvillimi i infrastrukturës së arsimit parashkollor dhe shkollor;

- **Masa 2:** Krijimi i shkollës profesionale të ndarë nga Gjimnazi “Havzi Nela” dhe funksionimi i saj si një godinë më vete me shumë funksione ku të mundësohen edhe kurse profesionale afatshkurtra.

Objektivi IV.3 Zhvillimi i infrastrukturës si shëndetin parësor e shërbimeve sociale

- **Masa 1:** Ngritja e qendrave të reja dhe rehabilitimi i qendrave ekzistuese;

- **Masa 2:** Parashikimi i qendrave të shërbimit social të bëhet me kujdes dhe në konsultim të ngushtë me bashkinë duke marrë parasysh përfituesit përfundimtarë.

Objektivi IV.4 Rritja e kapaciteteve të Bashkisë në fushën e zhvillimit e menaxhimit të territorit

- **Masa 1:** Trajnimi i stafit të bashkisë në fushën e zhvillimit e menaxhimit të territorit.

Prioriteti V Sisteme të infrastrukturës urbane të zhvilluara

Objektivi V.1 Zhvillimi Policentrik hapësinor dhe vendosja e një marrëdhënie të re urbane

- **Masa1:** Krahas qytetit Kukës, përcaktimi i zonave urbane prioritare, duke përfshirë Bicaj e Malzi , që të funksionojnë si një lidhëse për fshatrat më pak të populluara dhe si lokalitet për shpërndarjen e shërbimeve;

- **Masa 2:** Përcaktimi i saktë i vijave të gjelbëra kufizuese për zonat urbane, duke marrë parasysh legalizimin e zhvillimeve të deritanishme;

- **Masa 3:** Akses më i mirë në një infrastrukturë multimodale e cila është jo vetëm më efektive por edhe miqësore ndaj ambientit;

⁶⁴ -Kurset e mundshme që duhet të hapen për t'i shërbyer qytetarëve dhe bizneseve mund të jenë : riparues elektronik; rrobaqepësi; kuzhinë; përpunim brumi dhe ëmbëlsirash; turizëm familiar; elektroaut; saldator; instalues rrjetesh elektrike; riparues elektroshtëpiake; instalues panelesh diellore/fotovoltaike; instalues riparime sisteme ngrohje/ftohje.



- **Masa 4;** Zhvillimi i sistemeve të infrastrukturës me funksione mikse dhe komplementare;
- **Masa 5;** Përdorim dhe menaxhim inteligjent i ekosistemit urban në veçanti i ujit, energjisë dhe menaxhimit të mbetjeve;
- **Masa 6;** Konservim dhe zhvillim të trashëgimisë historike kulturore, në kuptim të përmirësimit dhe të aktivizimit të këtyre aseteve në jetën urbane;
- **Masa 7:** Hierarkizimin e qendrave dhe profilizimin e tyre në akomodimin e sektorëve ekonomikë të përshtatshëm duke shfrytëzuar potencialet ekzistuese.

- Masa 8: Ngritja e sistemi të ngrohjes me gaz për godinat publike dhe banesat private, pas përfundimit të gazësjellësit.

Objektivi V.2 Zhvillimi i infrastrukturës së transportit me qëllim rritjen e fluksit të lëvizjeve dhe lehtësimin e aksesit të mallrave e produkteve drejt tregjeve lokale, rajonale e ndërkufitare

- **Masa 1:** Integrimi i prioriteteve që vijnë nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar, duke përcaktuar hapësirat e nevojshme;
- **Masa 2:** Përcaktimi i zonave mbrojtëse ku nuk lejohet zhvillimi për tre objektivat kryesore që vijnë nga PPK: Aeroporti, Korridori 10, Stacioni intermodal;
- **Masa 3:** Parashikimi i rrjetit të transportit që mundëson lidhjen e shpejtë të qendrave fqinje urbane me Kukësin si qendër kryesore urbane;
- **Masa 4:** Parashikimi i rrjetit të transportit që mundëson lidhjen e shpejtë të qendrave prioritare të bashkisë me qytetin e Kukësit, si qendër që ofron shërbime publike të specializuara e të avancuara;
- **Masa 5:** Identifikimi dhe hartimi i projekteve të përbashkëta ndërkufitare me fokus rritjen e konektivitetit dhe përmes përmirësimit të infrastrukturës së transportit;
- **Masa 6:** Promovimi i transportit publik qytetas dhe ndërqytetës i transportit alternativ nëpërmjet infrastrukturës së butë, rrugë për biçikleta dhe këmbësorë;
- **Masa 7:** Klasifikimi rrjetit rrugor ekzistues dhe të parashikuar të bashkisë në tre kategori dhe përcaktimi i “Vijës së kuqe” ose vijës së ndërtimit të rrugës për çdo tip rrjeti dhe korridori të përfshirë në Sistem.

Objektivi V.3 Mirëmbajtja dhe restaurimi i të gjithë strukturës urbane është një zhvillim tjetër prioritar për të siguruar një cilësi më të lartë të jetës.

- **Masa 1:** Zgjerimi dhe mirëmbajtja e rrugëve urbane, ndricimit publik, hapësirave publike dhe rekreative (sheshet e lojërave, mjediset sportive dhe rikrijuese);
- **Masa 2:** Zgjerimi dhe kultivimi i hapësirave të reja me gjelbërim të lartë.



Prioriteti VI *Mbrojtja dhe konservimi i mjedisit si aset kryesor në shërbim të komunitetit dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm"*

Objektivi VI.1 **Zhvillimi dhe mbrojtja e pasurive dhe burimeve natyrore të zonës**

- **Masa 1:** Krijimi dhe konsolidimi i Korridorëve lidhëse Natyrore përgjatë luginave ujore të cilët bëjnë njëkohësisht lidhjen e qëndrueshme të sistemit të zonave të mbrojtura, por edhe ruajtjen e sistemit ujor;
- **Masa 2:** Identifikimi, mbrojtja dhe mirëmbajtja e parqeve dhe pasurive natyrore, Faunës dhe Florës specifike, si element i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës, bazuar në shfrytëzimin e mençur të burimeve natyrore;
- **Masa 3:** Vendosja e prioritetit të përdorimit të Zonave të lira natyrore, me përparësi mjedisin;
- **Masa 4:** Ngritja e sistemeve të monitorimit të ambjentit në territorin e bashkisë dhe e sistemeve të përbashkëta ndërkufitare.

Objektivi VI.2 **Intensifikimi i mbrojtjes dhe kontrollit të territorit ndaj rreziqeve natyrore**

- **Masa 1:** Përcaktimi i zonave me rrezikshmëri natyrore ndaj njeriut si rrjedhim i erozionit, rrezikut sizmik, prezencës së mineraleve të dëmshme për shëndetin, etj.;
- **Masa 2:** Rikthimi i zonave të degraduara prej aktivitetit njerëzor, si punime minerare, depozitim mbeturinash, shfrytëzim pa kriter i burimeve natyrore, etj në gjëndjen e mëparshme;
- **Masa 3:** Përcaktimi i fashave mbrojtëse për zonat e rrezikshme që funksionojnë si hapësirë “tampon” ndaj efekteve të dëmshme që mund të kenë ndaj banorëve të bashkisë.

Objektivi VI.3 **Përmirësimi i infrastrukturës dhe menaxhimit të mbetjeve urbane**

- **Masa 1:** Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta;
- **Masa 2:** Përmirësimi i rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve.

Objektivi VI.4 **Mbrojtja e biodiversitetit dhe pasurive natyrore**

- **Masa 1:** Mbrojtja e kurorës së gjelbër nga dukuritë e prerjeve masive dhe shpyllëzimeve dhe pyllëzimi i zonave periferike me pyje karakteristike të zonës në përshtatje me klimën malore të rajonit;
- **Masa 2:** Mbrojtja e habitave specifike nga ndërtime të mundshme apo vepra të tjera që shkatërrojnë ekosistemet e këtyre zonave;
- **Masa 3:** Mbrojtja dhe përmirësimi i biodiversitetit, zonat dhe llojet e mbrojtura me qëllim ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të mjedisit në përputhje me angazhimet kombetare dhe ndërkombëtare;
- **Masa 4:** Forcimi i kapaciteteve të Administratës së Zonave të Mbrojtura Kukës lidhur me menaxhimin, administrimin dhe monitorimin e Zonave të Mbrojtura;



- **Masa 5:** Forcimi i sistemit të monitorimit periodik për fushatat e gjuetisë në zonë dhe zbatimin e rregullores për moratoriumin e gjuetisë së kafshëve.

8 PLANI I VEPRIMEVE (PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE)

Plani i mëposhtëm i investimeve parashikon investimet e mundshme që duhet të kryhen në Bashkinë e Kukësit në përputhje me objektivat dhe masat e përcaktuara në këtë strategji, për periudhën e ardhshme 14 vjeçare. Në aspektin kohor investimet ndahen në tre kategori, afat-shkurtër, afat-mesme dhe afat-gjata. Duke qenë se një pjesë e investimeve kërkojnë së pari kryerjen e studimeve paraprake, zbatimi i investimeve do të duhet të shtrihet në periudhën afatmesme (3-5 vjet). Ndërsa disa investime madhore mund të realizohen në një periudhë më afat-gjatë (5-10 vjet).

Nr	Prioriteti/Emërtimi projektit	Lloji i Projektit	Kostoja e vlerësuar në EURO	Afatet Kohore	Prioriteti dhe Rëndësia
1	Prioriteti 1: Bujqësia				
1.1	Peshkëzimi artificial I Liqenit të Fierzës dhe ujëmbledhësve të Zonës së Kukësit	Investime	200,000	Afat shkurtër	
1.2	Ngritja dhe forcimi i laboratorëve bujqësorë dhe shërbimeve veterinarë	Investime	200,000	Afat mesëm	
1.3	Ngritja e kapaciteteve të inspektorëve të bujqësisë dhe fermerëve për aplikimin e "Logos së Cilësisë dhe Traditës"	Trajnime	200,000	Afat shkurtër	
1.4	Rehabilitim i infrastrukturës së vaditjes së tokave bujqësore	Studim	45,000	Afat shkurtër	
2	Prioriteti 2: Turizmi				
2.1	Sistemimi i bregut të Liqenit dhe përshtatja në pikë turistike	Investime	150,000	Afat mesëm	
2.2	Përpilimi i hartës elektronike të Kukësit me synim promovimin e turizmit.	Investime ITC	200,000	Afat shkurtër	
2.3	Krijimin e një Moli për varka lundrimi në Liqenin e Fierzës	Investime	120,000	Afat mesëm	
2.4	Inventarizimi/hartëzimi i lehtësirave dhe shërbimeve rreth pikave me potencial turistik	Studim	100,000	Afat shkurtër	
2.5	Katalogu promovues i qëndrave/pikave turistike (natyrore, kulturore dhe historike) dhe aktivitetëve kulturore dhe tradicionale	Botim	50,000	Afat shkurtër	
2.6	Krijimi dhe ndërtimi i Adresarit për Bashkinë Kukës (Qyteti+Fshatrat)	Studim / Investim	18,000 / 360,000	Afat shkurtër	
3	Prioriteti 3: Industria Minerare dhe Energjitike				
3.1	Evidentimi dhe Rehabilitimi i Mbetjeve Sterile dhe Karrierave si Rezultat i shfrytëzimit të	Studim & Investim	200,000	Afat shkurtër/ Afat mesëm	



	Mineraleve				
3.2	Ndërtimi i Digës së Betonit mbi Lumin Drin i Zi (Vepra hidroteknike) për mbajtjen e nivelit të liqenit në kuotën 296.00	Studim / Investim	800,000 / 20,000,000	Afat Gjatë	
3.3	Furnizim me ujë teknologjik i qytetit Kukës	Studim / Investim	38,000 / 750,000	Afat shkurtër/ Afat mesëm	
4	Prioriteti 4: Infrastruktura				
4.1	Programi për Zhvillimin e Infrastrukturës Rrugore dhe Sistemit të Transportit Urban	Studim	67,000	Afat shkurtër/	
4.1.1	Harta e Rrjetit Rrugor sipas klasifikimit në tre kategori	Studim	50,000	Afat shkurtër	
4.2	Ndërtimi i Rrugës turistike Topojan-Kroi i Kuq-Tërshenë-Bicaj	Punime Civile	200,000	Afat mesëm	
4.3	Projekti për zhvillimin e rrjetit të rrugëve për biçikletat (apo dhe këmbësorë) që akseson zonat natyrore të trashëgimisë historike dhe kulturore	Studim	50,000	Afat shkurtër	
4.4	Ndërtimi i Terminalit Multi-Modal të pasagjerëve	Investim	Investime të Qeveris	Afat mesëm	
4.5	Ndërtimi i Stacionit Intermodal në Kukës			Afat mesëm	
4.6	Ndërtimi i rrugës Aeroport – Austostradë Kukës	Studim / Investim	55,000 / 850,000	Afat shkurtër/ Afat mesëm	
4.7	Ndërtim i 2-3 mbikalimeve në Autostradë për lidhjen e qytetit Kukës me Liqenin Fierzë	Studim / Investim	3,000 / 60,000	Afat shkurtër/ Afat mesëm	
4.8	Rrethrotullimet dhe hyrje-daljet e fshatrave të njësisë Administrative Shtiqen dhe Tërthorë në Autostradë	Studim	90,000	Afat shkurtër	
4.9	Ndërtim i Tregut Industrial Kukës	Studim / Investim	50,000 / 1.000,000	Afat shkurtër/ Afat mesëm	
4.10	Rehabilitimi, sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve në qytetin Kukës	Studim / Investim	100,000 / 2,400,000	Afat shkurtër/ Afat mesëm	
4.11	Rehabilitimi, sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve në të gjithë njësitë e Administrimit të Bashkisë Kukës	Studim / Investim	1,000,000 / 20,000,000	Afat shkurtër/ Afat mesëm	
4.12	Vlerësim i ndërhyrjes në infrastrukturë dhe matje e koston financiare për ngritjen e sistemit të ngrohjes me gaz	Studim	90,000	Afat mesëm	
5	Prioriteti 5: Arsimi dhe Shëndetësia				
5.1	Ngritja e degëve për Profesione që lidhen me Shërbime të Ndryshme si dhe të Degës së Turizmit dhe Kulinarisë e Mesme Profesionale	Investim	50,000	Afat shkurtër/	
5.2	Mjedise sportive, rekreative	Investim	100,000	Afat shkurtër/ Afat mesëm	
5.3	Ndërtimi i shkollës 9 vjeçare Lagje e Re Kukës (Ndërtimi+Shpronësimi)	Studim / Investim	52,000 / 1,600,000	Afat shkurtër/ Afat mesëm	
5.4	Ndërtim i sistemit të ngrohjes në shkollën, kopshte dhe godina të bashkisë Kukës	Studim	90,000	Afat shkurtër	
6	Prioriteti 6: Mjedisi				
6.1	Zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane	Studim /	67,000 /	Afat shkurtër Afat shkurtër/	



6.1.1	Ndërtimi i Landfillit Kukës	Studim / investim	90,000 / 1,800,000	Afat mesëm	
6.2	Zhvillimi e Sistemit të Rrjetit të Ujësjetës-Kanalizimeve	Studim	67,000	Afat shkurtër	
6.3	Projekti për ndërhyrjet ndaj erozionit të tokës (faza e I)	Studim	80,000	Afat shkurtër	
6.5	Pyllëzimi i Grykës së Vanave	Investime	151,500	Afat mesëm	
6.6	Përmirësimi i infrastrukturës së Gjellbërimit të Qytetit të Kukës	Investime	50,000	Afat mesëm	
6.7	Pastrimi i Liqenit të Fierzës dhe Zonës përreth tij	Investime	200,000	Afat mesëm	
6.8	Pyllëzime të zonave periferike				
6.9	Ngritja e kapaciteteve të Administratës së Zonave të Mbrojtura Kukës lidhur me menaxhimin, administrimin dhe monitorimin e Zonave të Mbrojtura.	Trajnime	20,000	Afat shkurtër/	
6.10	Magjistrali i KUZ të qytetit Kukës	Studim / Investim	43,000 / 900,000	Afat shkurtër/ Afat mesëm	
6.11	Rehabilitim KUZ qytet dhe ndërtim KUZ Lagje e Re Kukës	Studim / Investim	53,000 / 1,100,000	Afat shkurtër/ Afat mesëm	
6.12	Ndërtimi i KUZ në Njësinë Administrative Shtiqen (Fshatrat Shtiqen,Kodër-Lume, Muje, Gjalicë dhe Krenxë)	Studim / investim	75,000 / 1,500,000	Afat shkurtër/ Afat mesëm	
6.13	Impianti i pastrimit të ujrave të zeza (Në 3 vend-derdhjet) Kukës	Studim / investim	200,000 / 4,000,000	Afat shkurtër/ Afat mesëm	
	Total		61,744,500.00		

Sic shihet investimet e parashikuara më sipër kategorizohen nga rëndësia e tyre, dhe nevojshmëria e realizimit të tyre për komunitetin. Kriteret e vlerësimit të projekteve në bazë të prioritetit dhe rëndësisë vlerësohen në tre shkallë: 1 deri në 3 pikë⁶⁵.

Kostoja e përlogaritur e zbatimit të planit të investimeve

Plani i mësipërm i investimeve vlerësohet të ketë një impakt financiar i cili shkon deri në 61,74 milion Euro. Duhet thënë se një ndikim në nivelin e konsiderueshëm financiar të planit kanë dy investime të parashikuara të cilat për nga kostoja paraprake e vlerësuar zënë rreth 65% të shumës totale të investimeve (40 milion Euro). Këto dy investime janë:

(1) Ndërtimi i Digës së Betonit mbi Lumin Drin i Zi (Vepra hidroteknike) për mbajtjen e nivelit të liqenit në kuotën 296.00 (referenca 3.2) dhe

⁶⁵ 1 – Shumë i rëndësishëm për komunitetin, 2 – I rëndësishëm, 3 – Mund të qëndrojë në Planin e Investimeve por nga rëndësia e prioriteti mund të mos jetë prioritar



(2) Rehabilitimi, sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve në të gjithë njësitë e Administrimit të Bashkisë Kukës (referenca 4.11)

Duhet theksuar se Ndertimi i Digës së Betonit mbi Lumin Drini i Zi, është një investim i cili ashtu sikurse investimet 4.4 Ndërtimi i Terminalit Multi-Modal të pasagjerëve dhe 4.5 Ndërtimi i Stacionit Intermodal në Kukës, janë të një rëndësie kombëtare dhe duhet të financohen direkt nga Qeveria Qëndrore.

Vlera e studimeve të parashikuara për tu realizuar në një fazë të parë të investimit vlerësohet të jetë rreth 3.36 milion euro ose 5% e totalit të planit. Duhet theksuar se peshën më të madhe e zënë studimet & projektimet për dy investimet e përmendura më lartë të cilat zënë një vlerë prej 1.8 milion euro.

Investimet e tjera zënë rreth 30% të totalit të shumës së investimeve të parashikuara në plan, dhe do të duhet të përfshihen në planin e investimeve të Bashkisë Kukës.

Plani i mësipërm është vetëm një plan indikativ, i cili do të rishikohet herë pas here nga stafi i Bashkisë. Financimi i tij, nga burimet e brendshme, Qeveria qendrore, si dhe komuniteti i donatorëve përben një nga sfidat më të mëdha për të mundur materializimin e zbatimit të tij.



9 PROGRAMET DHE PROJEKTET KRYESORE TË ZHVILLIMIT

Në këtë kapitull paraqiten në mënyrë më të detajuar disa nga projektet që parashikohen në planin e investimeve.

9.1 Projekte në fushën e Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban

1. Titulli I projektit	Programi për Zhvillimin e Infrastrukturës Rrugore
Lloji I projektit	<i>Infrastrukturore</i>
Vendodhja e projektit	<i>Bashkia Kukës</i>
Vlera e Buxhetit ne total	<i>23,617,000 Euro</i>

1. Sfondi dhe analizimi I projektit

Bashkia Kukës ka në përbërjen e saj 122.5 km rrugë rajonale, 181 km rrugë kombëtare, ndërkohë që mungon një inventar i saktë dhe kategorizim i rrugëve rurale. Cilësia e infrastrukturës rrugore lë shumë për të dëshiruar ku shume pak nga rrugët lokale janë të asfaltuara dhe pjesa tjetër është e pashtuar. Zonat më të largëta nga pikëpamja e udhëtimit janë: Arren, Ujmisht, Bushtrece, Grykë Cajë, Kalis ku koha e udhëtimit nga qendrat e këtyre njësi administrativeve në Kukës është rreth 2.5 – 3 orë. Ndërsa mesatarja e pjesës tjetër të njësi administrativeve me Kukësin është rreth 45 – 60 minuta.

Kukësi është një zonë me tipare të forta koncentrike ku në përgjithësi ndërveprimet janë mes njësi administrativeve aktuale dhe Kukësit si qendër e Bashkisë dhe shumë pak mes njësi administrativeve me njëra-tjetrën. Transporti i udhëtarëve bëhet në mënyrë jo të rregullt. Lëvizja e qytetarëve bëhet kryesisht nga njësi administrativet në Kukës kjo për faktin se Kukësi është Qendër Qarkut dhe ku janë përqendruar institucionet kryesore shtetërore. Mjetet kryesore të transportit janë minibuset dhe taksi, pasi transporti urban është shumë i kufizuar, pothuaj inekzistent. Këto për lëvizjet brenda zonës i.e. mes njësive administrativeve. Transporti urban është inekzistent në njësi administrative dhe në Bashkinë e Kukësit, kjo edhe për faktin se janë njësi me sipërfaqe të vogla. Nuk ka linja të dedikuara për shërbimin e transportit të qytetarëve nga njësi administrativet drejt Kukësit si qendër. Transporti në njësi administrative të largëta dhe të thella është më i rrallë dhe kryhet nga Njësi administrative drejt Kukësi në mëngjes dhe në drekë është kthimi nga Kukësi në Njësi administrative.

2. Objektivi kryesor i projektit

Zhvillimi i një sistemi të integruar të infrastrukturës së transportit më qëllim lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve nga Qendra e Bashkisë drejt periferive dhe anasjelltas.

3. Objektivat specifike të projektit

OS1: Përmirësimi i infrastrukturës së rrugore dhe asaj të transportit

OS2: Sigurimi i një situate të qartë të kategorive të rrugëve në territorin e Bashkisë së Kukësit.

OS3: Përmirësimi i shërbimit të transportit urban nëpërmjet disiplinimit dhe krijimit të një sistemi lëvizjeje të mirëstudjuar

OS4: Hartëzimi i Rrjetit Rrugor sipas klasifikimeve në tre kategori

4. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit



- R.1 Inventari i rrugëve të Bashkisë i ngritur
- R.2 Zhvillimi i infrastrukturës rrugore bazuar në një strategji të qartë ndërhyrjeje;
- R.3 Siguria rrugore e përmirësuar
- R.4. Mobiliteti i lëvizjes së qytetarëve në të 15 NjA i përmirësuar
- R5: Zhvillimi i infrastrukturës bazuar në sistem ekonomike eficient (kostoje)
- R6: Harta e Rrjetit Rrugor sipas klasifikimeve në tre kategori të përfunduar

Përfitues të këtij programi janë gjithë NjA dhe gjithë popullsia e Bashkisë.

Projekti mendohet të zgjasë për një periudhë 3 - 5 vjetecare, pasi është konceptuar në formën e një programi i cili do të mund të realizohet me dy faza. Faza e parë do fokusohet tek kryerja e studimeve dhe strategjisë së ndërhyrjes dhe faza e dytë tek realizimi i ndërhyrjeve në infrastrukturën rrugore dhe të transportit.

5. Aktivitetet e projektit

Faza e Parë:

1. Inventarizimi i menjëhershëm dhe kategorizimi i rrugëve duke marrë në konsideratë rristurimin e njësive të qeverisjes vendore.
2. Hartimi i strategjisë rrugore për zhvillimin e infrastrukturës rrugore të Bashkisë
3. Përllogaritja e kostos: Gjithashtu duhet të merret në konsideratë përllogaritja e kostove për mirëmbajtjen e rrugëve e studiuar dhe hartuar nga FShZh, e cila aktualisht nuk zë vend dhe nuk mund të përfshihet në asnjërën nga njësitë përbërëse të Bashkisë. Kjo do të ndihmonte në maksimizimin e efikasitetit të financimeve, duke bërë të mundur një plan për mirëmbajtjen e rrugëve dhe jo thjesht financime kur situata bëhet alarmante.
4. Hartimi i studimit të ndërthurjeve të rrugëve dytësore me ato kryesore dhe sidomos autostradën Milot – Morinë. Në vende të ndryshme hyrjet dhe daljet nuk janë sipas standarteve gjë që përbën rrezik për jetën e qytetarëve.
5. Hartimi i një studim më i hollësishëm në lidhje me mobilitetin e banorëve, por edhe me nevojat e tyre për transport dhe hartëzimi i pikë ndalesave të mjeteve që transportojnë banorët.

Faza e Dytë

6. Vendosija e linjës së transportit urban për qytetin e Kukësit
7. Ngritja e Stacioneve të Ndalimit të Udhëtareve në Zonat Urbane dhe Ndërrurbane;
8. Realizimi i ndërhyrjeve për përmirësimin dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore në qytetin e Kukësit dhe në të gjitha njësitet administrative

6. Maturimi i projektit

Mungojnë studimet

7. Kostot e projektit (në Euro)

Nr.	Aktivitetet	Buxheti per aktivitet (në Euro)
1	Inventarizimi i menjëhershëm dhe kategorizimi i rrugëve	10,000
2	Hartimi i strategjisë rrugore për zhvillimin e infrastrukturës rrugore të Bashkisë	25,000
3	Përllogaritja e kostove për mirëmbajtjen e rrugëve	2,000
4	Hartimi i studimit të ndërthurjeve të rrugëve dytësore	10,000
5	Hartimi i një studim më i hollësishëm në lidhje me mobilitetin e banorëve, por edhe me nevojat e tyre për transport.	20,000
6	Hartëzimi i Rrjetit Rrugor sipas klasifikimeve në tre kategori	50,000
7	Studimi dhe projektet e detajuar për rehabilitimin, sistemimin dhe asfaltimi i rrugëve në qytetin Kukës	100,000
8	Rehabilitimin, sistemimin dhe asfaltimi i rrugëve në qytetin Kukës	2,400,000
9	Studimi për rehabilitimin, sistemimin dhe asfaltimin i rrugëve në të gjithë njësitet e Administrimit të Bashkisë Kukës	1,000,000
10	Rehabilitimi, sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve në të gjithë njësitet e Administrimit	20,000,000



të Bashkisë Kukës	
TOTALI	23,617,000

2. Titulli I projektit	Ndërtimi i Rrugës turistike Topojan-Kroi i Kuq-Tërshenë-Bicaj
Lloji I projektit	<i>Infrastrukturore-Turistike</i>
Vendodhja e projektit	<i>Njësi administrative Topojan dhe Bicaj</i>
Vlera e Buxhetit ne total	<i>200.000 Euro</i>

1. Sfondi dhe analizimi I projektit

Turizmi është prioriteti kryesor i Strategjise Rajonale të Zhvillimit të Rajonit Kukës dhe zona e Gjallicës është zona e dytë prioritare për zhvillimin e turizmit pas Shishtavecit. Me anë të projekteve të aplikuara deri tani, janë prekur pothuajse të gjitha zonat turistike të rajonit. Një ndër to janë edhe bjeshkët e Gjallicës të cilat nuk kanë akses infrastrukture të zhvilluar për ti eksploruar këto zona. Kjo zonë gjatë gjithë stinës së verës frekuentohet shumë nga banorët e njësive administrative përreth për të shfrytëzuar këtë zonë mjaft të pasur bimore dhe kurative. Gjithashtu është rritur mjaft edhe numri i turistëve aventuresk në këto zona ende të pashfrytezuara. Domosdoshmeria e një rruge ka lindur për të gjithë këto faktorë edhe për faktin se edhe zona e Bicajve edhe zona e Topojanit kanë të njejtat vlera të cilat janë mjaft larg në distancë nga njera tjetra. Ngritja e infrastukturës dhe lidhja e këtyre dy zonave ndihmon në shfrytëzimin e një kurore të larmishme në një kohë shumë më të shkurtër se ekzistuesja.

2. Objektivi(at) specifik të projektit

OS1: Shkurtimi i distancës dhe arritshmëri me e madhe e vendeve turistike

OS2: Ndërveprim dhe bashkëpunim ndërnjësi administrativel

OS3: Rritja e numrit turistave vendas dhe te huaj dhe nxitja për investime në këto zona

3. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit

R.1 Infrastukturore turistike te ngritur ne zonen e Gjallices.

R.2 Shkurton distancen dhe ul koston e transportit per zonat perreth

R.3 Shfrytezim racional te pasurive natyrore

R.4. Rritje te numrit te turistave vendas dhe te huaj

4. Aktivitetet e projektit

1. Hartimi i projektit teknik për ndërtimin e rrugës
2. Ndërtimi i rrugës (vepra arti, sinjalistike rrugore, turistike etj)

5. Maturimi I projektit

Mungon një studim i zonës dhe është e domosdoshme të kryhet një studim I tillë për llojin e ndërhyrjes perfshi përcaktimin e shtigjeve turistike dhe sinjalistikës së nevojshme.

1. Kostot e projektit (në Euro)

Nr.	Aktivitetet	Buxheti aktivitet	per
1	Dizenjimi i projektit për rrugën	10.000	
2	Ndërtimi i rrugës (vepra arti, sinjalistike rrugore, turistike etj)	175.000	
3	Trajnim stafit të dy njësive administrative për promovimin e vlerave turistike	5.000	
4	Promovimi i vlerave natyrore të zonës me anë të fletëpalosjeve, guida,	10.000	



dokumentarë, aktivitete etj.	
TOTALI	200.000

3. Titulli I projektit	Zhvillimi e Sistemit të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane
Lloji i projektit	Infrastrukturore - Mjedisore
Vendodhja e projektit	Bashkia Kukës
Vlera e Buxhetit ne total	1,957,000Euro)

1. Sfondi dhe analizimi i projektit

Në Bashkinë e Kukësit shërbimi i menaxhimit të mbetjeve është shumë i kufizuar dhe lë shumë për të dëshiruar. Njësitë administrative në përgjithësi nuk e kanë këtë shërbim dhe kufizohet kryesisht në mbledhje të mbeturinave sipas një grafiku i cili nuk është i rregullt por sipas nevojave. Mungesa e kapaciteteve financiare për të ofruar shërbimin dhe mungesë të ndërgjegjësimit të banorëve, shoqërohet edhe me mungesën e mjeteve dhe të pikave të grumbullimit të mbetjeve në lagjet ose fshatrat e njësisë administrative. Në njësitë administrative ku ky shërbim ofrohet i cunguar (Shishtavec, Terthore) grumbullimi i mbeturinave bëhet me punonjës të këtyre njësive dhe me mjete të vogla, por jo mjete teknologjike. Njësi administrative Shishtavec shpenzon një shumë modeste për gjithë shërbimin e pastrimit 200 000 Leke/vit. Njësitë administrative kanë venddepozitime për mbetjet. Këto venddepozitime janë thjesht të miratuara nga këshillat e njësive përkatëse, por realisht nuk kanë standarte ose nuk mund të konsiderohen venddepozitime të mirëfillta.

Problematikë vazhdon të mbetet ndërgjegjësimi i banorëve të njësive administrative në lidhje me mbetjet plastike dhe amballazhet. Shpesh nëse nuk groposen (që në vetvete paraqet problemet e veta) ato hidhen në lumenj ose përrenj ose në vende të hapura.

2. Objektivi kryesor i projektit

Përmirësimi i ambjentit dhe shëndetit të popullsisë nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit dhe përpunimit të mbetjeve urbane

3. Objektivat specifike të projektit

OS1: Përmirësimi i skemës së menaxhimit të mbetjeve urbane

OS2: Promovimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe ekonomikisht të përballueshëm i tarifimit të shërbimeve

OS3: Përmirësimi i infrastrukturës të grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane,

OS4: Ndërtimi i Landfillit Kukës i përfunduar

4. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit

- R.1 Skema e grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane e zhvilluar
- R.2 Sistem tarifar ekonomikisht i qëndrueshëm i zhvilluar;
- R.3 Infrastruktura e grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane e zhvilluar
- R.4 Ndërtimi i Landfillit Kukës dhe funksionimi i tij.

Përfitues të këtij programi janë gjithë NjA-të dhe gjithë popullsia e Bashkisë.

Projekti mendohet të zgjasë për një periudhë me shumë se 3 -5 vjetecare, pasi është konceptuar në formën e një programi i cili do të mund të realizohet me dy faza. Faza e parë do fokusohet tek kryerja



e studimeve dhe strategjisë së ndërhyrjes dhe faza e dytë tek zhvillimi i sistemit të grumbullimit e menaxhimit të mbetjeve urbane, si dhe ngritja e landfill

2. Aktivitetet e projektit

Faza e Parë

Hartimi studimit për menaxhimin e mbetjeve dhe ndërgjegjësimin e popullsisë, duke përfshirë dhe studimin për kostimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë elementët e tij dhe një diferencim i tarifës së këtij shërbimi për zonën urbane dhe atë rurale në varësi të ofrimit të shërbimit.

Faza e Dytë

- Zbatimi i planit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane
- Investime në infrastrukturën e grumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve urbane

3. Maturimi i projektit

Ekziston një studim paraprak i hartuar nga projekti SELEA që ka bërë një analizë të menaxhimit të mbetjeve në rajonin e Kukësit.

4. Kostot e projektit (në Euro)

Nr	Aktivitetet	Buxheti per aktivitet
1	Hartimi i studimit të menaxhimit dhe tarifimit të mbetjeve urbane	30,000
2	Hartimi i studimit të tarifimit të mbetjeve urbane.	15,000
3	Zhvillimi i infrastrukturës së grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane.	22,000
4	Ndërtimi i Landfillit Kukës	1,890,000
TOTALI		1,957,000

9.2 Projekt – propozime në Fushën e Mbrojtjes së Ambjentit

1. Titulli I projektit	Pastrimi i Liqenit të Fierzës dhe Zonës Përreth tij
Lloji I projektit	Mjedisor- Turistik
Vendodhja e projektit	Bashkia Kukës
Vlera e Buxhetit ne total	200.000

1. Sfondi dhe analizimi I projektit

Liqeni i Fierzës ka një gjatësi prej 72km dhe sipërfaqe rreth 8,169 ha. Liqeni i Fierzës është i krijuar nga derdhja e lumenjve të Orinit te Bardhë, Drinit të Zi etj. Liqeni i Fierzës është i pasur me habitate dhe 13 lloje peshqsh, është i përshtatshëm për udhëtime turistike, peshkim etj. Me VKM Nr 88 Datë 01/03/1993 bregu i liqenit të Fierzës është shpallur zonë me përparësi për zhvillimin e turizmit.

Problemi më i madh që ekziston është se ky liqen ndotet shumë nga mbetjet urbane ku pjesa më e madhe vjen nga rrjedhjet e lumenjve të Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi, të cilat ndikojnë negativisht në cilësinë e ujit, faunës. ambjentit përreth, si dhe shfrytëzimin e terrenit për turizëm balnear dhe aktivitete ujore.

Për pastrimin e liqenit janë zbatuar vite më parë grante të vogla të financuara nga donatorë të ndryshëm por duke qënë se Liqeni I Fierzës ka një sipërfaqe të madhe dhe pastrimi me anë të mjeteve bashkohore kushton shumë, jemi munduar që me fondet që alokohen të konkurohet për një projekt mbi pastrimin e Liqenit.



Ky potencial natyror i pa shfrytëzuar, ka një kërkesë në rritje nga banorët për t'u vizituar dhe interes nga pushteti vendor për t'a shndërruar në një destinacion turistik.

Turizmi dhe mjedisi janë prioritetet kryesore në Strategjinë e Zhvillimit Rajonal 2012-2016 për Qarkun e Kukësit.

2. Objektivi(at) specifik të projektit

OS1: Përmirësimi i kushteve aktuale të liqenit të Fierzës, zhvillimi dhe ruajtja e faunës, si dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për atraksion turistik.

OS2: Hartimi i planit të veprimit për pastrimin dhe mirëmbajtjen e Liqenit të Fierzës

3. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit

- R1: Sipërfaqe ujore dhe breg liqeni i pastruar;
- R2: Komuniteti ka mundësinë e shijimit të një bregu të pastër nga mbeturinat urbane
- R3: Krijim kushtesh optimale për një faunë të zhvilluar dhe për peshkun si dhe për zhvillimin e turizmit
- R4: Peshk i shëndetshëm
- R5: Frekuentim më i madh në liqen
- R6: Mjedis i pastër

4. Aktivitetet e projektit

1. Vlerësimi i gjendjes aktuale
2. Rekrutimi dhe krijimi i grupit të punës.
3. Trajnimi dhe rritja e kapaciteteve të grupit të punës
4. Pastrimi i liqenit dhe zonës përreth tij
5. Përgatitja e fletëpalosjeve dhe lançimi në media i fushatës për sensibilizim
6. Bashkëpunim më i gjerë me vendet kufitare nga ku vjen rrjedhja e lumenjve

Projekti mendohet të zbatohet për një periudhë 2 vjecare. Përfitues të këtij projekti janë banorët e zonës, një numër i konsiderueshëm peshkatarësh, pushuesish, turistësh, grupesh interesi që merren me aktivitete ujore

Kostot e projektit

Nr.	Aktivitetet	Buxheti per aktivitet
1	Vlerësimi i gjendjes aktuale	10.000
2	Rekrutimi dhe krijimi i grupit të punës	20.000
3	Trajnimi dhe rritja e kapaciteteve të grupit të punës	10.000
4	Pastrimi i liqenit dhe zonës përreth tij	105.000
5	Përgatitja e fletëpalosjeve dhe lançimi në media i fushatës për sensibilizim	5.000
TOTALI		200.000

2. Titulli i projektit	Sistemimi i bregut të Liqenit dhe përshtatja në pikë turistike
Lloji i projektit	Mjedisor-Turistik
Vendodhja e projektit	Bashkia Kukës
Vlera e Buxhetit në total	150.000 Euro

7. Sfondi dhe analizimi i projektit



Liqeni i Fierzës është liqeni artificial më i madhi në vend. U krijuan në vitin 1978, mbi lumin e Drinit për krijimin e HEC të Fierzës. Shërben si nyje lidhëse mes Kukësit, Tropojës dhe Hasit. Sot, ky liqen përveç shfrytëzimit për industrinë energjitike ka dhe funksion turistik. E rrethon qytetin e Kukësit nga tre anët duke krijuar përshtypjen e një gadishulli. Me shpalljen e tij Park Natyror Rajonal është e rëndësishme që liqeni të shfrytëzohet në mënyrë sa më eficiente që përfitimi të jetë i dyanshëm. Sistemimi i bregut është një hap që i shërben mirë menaxhimit. Kjo sepse në stinën e verës bregu shfrytëzohet nga banorët e zonës për turizmin balnear dhe peshkimin. Gjithashtu përgjatë bregut do gjeni dhe biznese familjare që ofrojnë pushim të këndshëm dhe ushqim tradicional bio.

Ky potencial natyror i pa shfrytëzuar, ka një kërkesë në rritje nga banorët për t'u vizituar dhe interes nga pushteti vendor për ta shndërruar në një destinacion turistik.

8. Objektivi(at) specifik të projektit

OS1: Kthimi i kësaj bukurie natyrore në shërbim të rajonit, pasja e një ambjenti të pastër, të bukur, shplohës dhe mbi të gjitha kthimi në një destinacion turistik.

OS2: Kthimi në shërbim të komunitetit dhe ndikim në rritjen e bizneseve të vogla që ushtrojnë aktivitet në fushën e lundrimit, peshkimit, shërbimeve ambulante etj.

9. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit

R1: Ambjenti në bregun e Liqenit është bërë më i këndshëm dhe terheqës për turizëm

R2: Mundësi më të mëdha për ushtrim aktiviteti bizneseve të vogla lokale

R3: Rritje të numrit të vizitoreve dhe turistëve

R4: Rritje të ardhurash me 15 %

10. Aktivitetet e projektit

1. Përcaktimi i vijës së bregut për destinacion turistik
2. Pajisja me objekte dhe mjete të nevojshme
3. Mbushja e një vije bregu me rërë plazhi
4. Blerje varkash të vogla turistike
5. Dizajnimi dhe publikimi i 2000 fletepalosjeve
6. Publikim në median vizuale

Projekti mendohet të zbatohet në një periudhë 2 vjeçare

11. Maturimi i projektit

Nuk ka studime të meparshme në këtë drejtim. Si fillim lind nevoja për një takim me grupet e interesit dhe banorët që preken nga ujrat e liqenit të Fierzës për të informuar dhe për të marrë idetë e tyre. Me pas duhet të kryhet një studim i cili do të jetë dhe në kuader të planit të menaxhimit të liqenit të Fierzës si Park Natyror Rajonal ku duhet të përcaktohen llojet e nderhyrjeve si: bizneset, vendet e shfrytëzimit për turizmin balnear nga banorët, zonat që nuk do të nderhyhet etj.

12. Kostot e projektit

Nr.	Aktivitetet	Buxheti për aktivitet
1	Përcaktimi i vijës së bregut për destinacion turistik	20.000
2	Pajisja me objekte dhe mjete të nevojshme	70.000
3	Mbushja e një vije bregu me rërë plazhi	40.000
4	Blerje varkash të vogla turistike	16.000



5	Nenshkrimi i marreveshjes se bashkepunimit mes partnereve	0
6	Dizenjimi dhe publikimi I 2000 fletpalosjeve	2.000
7	Publikim ne median vizuale	2.000
TOTALI		150.000 Euro

3. Titulli I projektit	Pyllezimi i Grykes se Vanave
Lloji I projektit	Mjedisor-Turistik
Vendodhja e projektit	Zona Kukës – Shishtavec
Vlera e Buxhetit ne total	150.000 Euro

1. Sfondi dhe analizimi i projektit

Qarku Kukës ka një popullsi prej 117000 banorë ku 61.4 % e tyre jetojnë në zonat rurale. Segmenti rrugor Kukës-Shishtavec me një gjatësi prej 41 km lidh 19 fshatra të tre njësi administrativeve. E gjithë gjatësia e saj ka qënë vetëm me një kalim, e dëmtuar dhe e pakalueshme për automjetet e vogla. Ndërtimi i rrugës së re do çlirojë banorët nga izolimi disa muaj, për shkak të reshjeve të dendura të dëborës por edhe rrëshqitjes së dherave. 14 mijë banorë të njësi administrativeve Zapod, Shishtavec, Topojan tashmë mund të lidhen në një kohë shumë të shkurtër me qytetin e Kukësit. Me përfundimin e rruges fillon puna për gjelberimin anësor të saj e cila për momentin është e zhveshur. **Parashikohet që me përfundimin e rruges do të ketë një numër më të madh makinash që do të levizin për vetë faktin se zona e Shishtavecit është një zonë e pasur me bukuri natyrore dhe një ndër zonat më perparëse zhvillimin e turizmit.**

Pyllezimi i kësaj pjese të rruges do të japë pamje tërheqëse të Grykes së Vanave dhe zonës përreth. Gjithashtu Turizmi dhe Mjedisi janë prioritetet edhe të Strategjisë së Zhvillimit Rajonal 2012-2016, prandaj lind nevoja e përmirësimit të mjedisit natyror të rajonit si një aspekt kyç i identitetit dhe atraktivitetit të tij, sidomos duke shmangur të gjitha efektet negative në mjedis përmes aktiviteteve njerëzore.

2. Objektivi kryesor i projektit

Te kontribuojë në mbrojtjen e ambjentit dhe të eco-sistemit si dhe në mbrojtjen e jetës së banorëve nga ruajtja dhe eliminimi i zhkarjeve të tokës si rezultat i efekteve të erozionit.

3. Objektivat specifike të projektit

Objektivat specifike janë si më poshtë:

- OS1:** Të kontribuojë në përmirësimin e kurorës së pyjeve përgjatë 10 km të parë të rrugës Kukës – Shishtavec
- OS2:** Të kontribuojë në ndergjegjesimin e banorëve të zonës përreth për rëndësinë e pyllëzimit dhe mbrojtjes së pyjeve

4. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i këtij projekti do të jenë:

- R1: 10 km e parë të rrugës e pyllëzuar
- R2: Të paktën 15,000 fidanë të mbjellë
- R3: 15 banorë të trajnuar (5 banorë për njësi administrative)
- R4: 300 fletë palosje të prodhuara
- R5: 150 broshura të prodhuara

5. Aktivitetet e projektit



1. Krijimi i një komisioni me specialistë të pyjeve
2. Përcaktimi i temave të trajnimeve
3. Përcaktimi i pjesëmarrësve në trajnim
4. Organizimi i trajnimeve
5. Pregatitje fletë palosje, broshura
6. Përcaktimi i zonës ku do të bëhet pyllëzimi
7. Përcaktimi i llojit të drureve që do të mbillen
8. Pregatitja e tokës për mbjellje
9. Blerja e fidaneve
10. Mbjellja e fidaneve

Projektet mendohen të zbatohen në një periudhë 2 vjeçare

8. Maturimi projektit

Nuk është ndërmarrë një projekt i tillë në këto zona. Në propozim është përcaktuar dhe zhvillimi i një studimi paraprak për zonën e nderhyrjes, për pyllëzimin e kësaj zone që të vazhdojë të ruhet statusi i monumentit të natyres.

9. Kostot e projektit

Nr.	Aktivitetet	Buxheti aktivitet	per
1	Krijimi i një komisioni me specialiste të pyjeve	300	
2	Përcaktimi i zonave të nderhyrjes	1500	
3	Përcaktimi i temave të trajnimeve	300	
4	Përcaktimi i pjesëmarrësve në trajnim	300	
5	Organizimi i trajnimeve	1.800	
6	Pregatitje flete palosje, broshura	5.000	
7	Përcaktimi i zonës ku do të bëhet pyllëzimi , përcaktimi i llojit të drureve që do të mbillen	1.600	
8	Pregatitja e tokës për mbjellje	50.000	
9	Blerja e fidaneve	70.000	
10	Mbjellja e fidaneve	20.700	
	TOTALI	151.500	

7. Titulli i projektit	Evidentimi dhe Rehabilitimi i Mbetjeve Sterile dhe Karrierave si Rezultat i shfrytëzimit të Mineraleve
Lloji i projektit	Mjedisor
Vendodhja e projektit	Bicaj
Vlera e Buxhetit në total	200.000 Euro

1. Sfondi dhe analizi i projektit

Situata e krijuar nga shfrytëzimi i mineraleve para viteve 1990 në Gjergjan dhe shfrytëzimi i rërave karbonatike në njësinë administrative Bicaj është e rëndë. Pas ndryshimit të sistemit në këto dy vendburime u krijuan një gjendje shumë negative me pasoja të mëdha mjedisore. Gjendje e tillë u krijuan edhe si rezultat i krijimit të damkave sterile të skorjes së Uzines së shkrirjes së bakrit Rexhepaj - Njësi administrative Shtiqen e cila ndikon në ndotjen e ujërave të Liqenit të Fierzes. Problemi shqetësues është shfrytëzimi pas viteve 1997 dhe në vazhdim nga persona të pa licensuar të zonave mineral-mbajtëse në Qarkun tonë. Shfrytëzimi i karrierave realizohet nga subjekte e persona privat, në shumë raste pa kualifikimin e duhur dhe pa zbatuar projekte dhe



programe që shoqerojnë licensat.

Shpesh karrierat perfaqesojnë vetëm gropa ose germime me konture të pa rregullta pa shkallë pa ju përmbajtur sistemit të shfrytëzimit të parashikuar në projekte dhe c'ka është shumë shqetësuese pa marrë asnjë masë për rigjenerimin e ambjentit.

2. Qëllimi i Projekti

Promovimi i shfrytëzimit me efektivitet të karrierës karbonatike në mënyrë që të mbështet zhvillimi i industrisë së ndërtimit të rajonit dhe të sigurohet mbrojtja e ambjentit.

3. Objektivi(at) specifik të projektit

OS1: Njohja e gjendjes aktuale si rezultat i shfrytëzimit të mineraleve në qarkun Kukës

OS2: Përpilimi i raportit teknik për zgjidhjen e problemeve.

OS3: Kthimi i zonave të demtuara nga veprimtaria minerare në zonë anti-ndotje në mjedisin rrethues.

4. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit

R1: Banoret e zonave të nderhyrjeve do të jetojnë në kushte më të mira mjedisore dhe sigurie

R2: Qeverisja Qendrore dhe ajo lokale kanë informacionin e duhur për nderhyrje rehabilituese

R3: Bizneset në fushën minerare do të sensibilizohen për mbrojtjen e mjedisit

5. Aktivitetet e projektit

1. Ekspedita dhe vërtetime në terren për njohjen e sipërfaqeve të demtura
2. Analizim i fakteve të marra në terren
3. Takim me grupet e interesit.
4. Rehabilitim i zonave me prioritet të demtuara
5. Fushatë për sensibilizimin e kompanive të licensuara për mbrojtjen e mjedisit në zbatim të legjisacionit në fuqi

6. Kostot e projektit

Nr.	Aktivitetet	Buxheti aktivitet	per
1	Ekspedita dhe vërtetime në terren për njohjen e sipërfaqeve të demtura	30.000	
2	Analizim i fakteve të marra në terren	10.000	
3	Takim me grupet e interesit.	10.000	
4	Rehabilitimi për zonat me prioritet të demtuara	140.000	
5	Fushatë për sensibilizimin e kompanive të licensuara për mbrojtjen e mjedisit në zbatim të legjisacionit në fuqi	10.000	
TOTALI		200.000	



9.3 Projekt – propozime ne fushen e Zhvillimit të Turizmit dhe Ekonomise Lokale

8. Titulli I projektit	Përpilimi i hartës elektronike të Kukësit me synim promovimin e turizmit.
Lloji I projektit	<i>Zhvillim i qëndrueshëm mjedisor, social dhe ekonomik</i>
Vendodhja e projektit	<i>Bashkia Kukës</i>
Vlera e Buxhetit ne total	<i>200.000 Euro</i>

1. Sfondi dhe analizimi I projektit

Në ditët e sotme, faqet ëeb ofrojnë mënyra të reja për të vënë informacion në dispozicion të përdoruesit. Kjo krijon mënyra të reja dhe mjete që mund të përdoren për të krijuar informacionin për turistët dhe promovimin e destinacioneve turistike. Objektivi kryesor i kësaj pune është që të zhvillojë një aplikim Eëb për zhvillimin e turizmit në rajonin e Kukësit. Ky aplikacion i Eëbit përdor harta dinamike dhe karakteristika të përmbajtjes të gjeneruar nga përdoruesit, të cilat janë të fokusuar për të vënë në dispozicion informata të dobishme për turistët dhe promovimin e Natyrës dhe Turizmit aventurë në rajonin e Kukësit. Zhvillimet në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) kanë transformuar turizmin në mënyra të shumta në fusha të tilla si kërkesës së konsumatorëve dhe menaxhimit të faqes. Inputeve të ndryshme të informacionit për destinacionet mund të luajë një rol të madh në zgjedhjen e turistëve për pushime duke përdorur internetin si një mjet i privilegjuar për kryerjen e kësaj detyre.

E-Turizmi përfaqëson hulumtimin e kombinuar të TIK në turizëm i cili po ndryshon sektorin e turizmit me shpejtësi duke bërë thirrje për një adoptim të vazhdueshëm dhe integrimin e zhvillimeve të fundit të TIK në sektorin e turizmit.

Keshilli Qarkut Kukës ja doli në organizimin e disa të dhënave të caktuara, me rezultat informimin për vendimmarrjen për planifikimin strategjik dhe strategji të investimeve. Si rezultat i sukseseve dhe dështimeve të kaluara, është identifikuar një nevojë për të përdorur një softëare GIS të avancuar me mbështetjen e infrastrukturave teknologjike dhe trajnime të nevojshme dhe përmirësimet në kapacitetin vendor të mbledhjes së të dhënave, me qëllimin dhe synimin për të përmbushur objektivat e këtij veprimi. Përveç kësaj, vlerësohet harmonizimi i mbledhjes së të dhënave tilla dhe infrastrukturave teknologjike, duke lejuar përdorimin në maksimum të shkëmbimit të informacionit.

Për më tepër, konsiderohet rëndësia e përmirësimit të kapaciteteve vendore, gjithashtu, për bizneset, OJQ-të dhe njësitë e qeverisjes vendore, të cilat të furnizojnë me informacion dhe të dhëna Keshillin e Qarkut, Bashkinë dhe institucione të tjera. Keto të dhëna pasi mblidhen, mirëmbahen, analizohen dhe përhapen përsëri në publik.

2. Objektivi kryesor i projektit

Promovimi i turizmit, burimeve natyrore dhe pasurive kulturore në Zonen e Kukësit nëpërmjet përdorimit të sistemit të teknologjisë së informacionit.

3. Objektivat specifike të projektit

OS1: Të krijojë sistemin e mbledhjes, menaxhimit dhe shfrytëzimit të të dhënave, me theks në krijimin e një harte dixhitale në internet për qëllime turistike

OS2: Të promovuar dhe reklamuar potencialet turistike rajonale ndërkufitar përmes krijimit të një faqe interneti duke përdorur të dhënat gjeo-hapësinore

OS3: Të lehtësojë kërkimin e informacionit dhe orientojë lehtësisht turistët vendas e të huaj drejt pikave kryesore turistike dhe pasurive kombëtare natyrore e historike

4. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit



R1: Struktura te themeluar, te pajisur dhe të trajnuar për të menaxhuar dhe programuar të dhëna gjeo- hapësinore dhe harta.

R2: Harta Dixhitale e krijuar

R3: Ëëëeb-GIS i ngritur dhe funksional

R4: Ndërgjegjësimi i vazhdueshëm për asetet rajonale nëpërmjet shpërndarjes së informacionit të strukturuar dhe profesionale për turizëm, gjeo - hapësirë dhe social-kulturor

1. Aktivitetet e projektit

1. Fillimi i Projektit, Rekrutimi I stafit teknik dhe trajnim
2. Identifikimi I te dhenave qe do mblidhen
3. Mbledhja e informacionit ne menyre fizike
4. Dizenjimi I ëëëeb-GIS
5. Procesimi I te dhenave vektoriale
6. Te dhenat dhe dizenjimi I hartave
7. Sherbimi I hostimit te te dhenave gjeo-hapsinore dhe I domain-it
8. Ngarkimi I te dhenave
9. Dizenjimi I aplikacionit mobile dhe I ëëëbit.
10. Perktimi I portalit te ëëëbit
11. Pergatitja per raportin final dhe mbylljen e aksionit
12. Ëëëorkshop me Operatore turistik per promovimin e hartave ne GIS

Projekti mendohet te zbatohet per nje periudhe 2 vjecare

2. Maturimi I projektit

Veprimi i propozuar synon të vë një themel për të cilin të gjitha projektet, private apo publike, mund të rriten mbi; mbledhjen, organizimin, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit të saktë për rajonin. Ky është një hap i parë themelor dhe shume I nevojshem për arritjen e suksesit të qëndrueshëm afatgjatë në rajon. Një bazë të dhënash e organizuar dhe e centralizuar është themeli i domosdoshëm mbi të cilin rajoni mund të planifikojë dhe të rritet në mënyrë efektive

3. Kostot e projektit

Nr.	Aktivitetet	Buxheti per aktivitet
1	Fillimi i Projektit	1.000 Euro
2	Rekrutimi I stafit teknik dhe trajnim	36.000 Euro
3	Identifikimi I te dhenave qe do mblidhen	2.000 Euro
4	Mbledhja e informacionit ne menyre fizike	20.000 Euro
5	Dizenjimi i web-gis	20.000 Euro
6	Procesimi I te dhenave vektoriale	11.000 Euro
7	Te dhenat dhe dizenjimi I hartave	10.000 Euro
8	Sherbimi I hostimit te te dhenave gjeo-hapsinore dhe I domain-i	10.000 Euro
9	Ngarkimi I te dhenave	10.000 Euro
10	Dizenjimi I aplikacionit mobile dhe I ëëëbit.	20.000 Euro
11	Perktimi I portalit te webit	5.000 Euro
12	Pergatitja per raportin final dhe mbylljen e aksionit	5.000 Euro
13	Ëëëorkshop me Operatore turistik per promovimin e hartave ne GIS	10.000 Euro
14	Promovimi I projektit (flete palosje, harte turistike, guide, konferenca, seminare, tv)	40.000 Euro
TOTALI		200.000 Euro



7. Titulli I projektit	Krijimin e nje Moli ne Liqenin e Fierzes
Lloji I projektit	Infrastrukture-Turistik
Vendodhja e projektit	Liqeni I Fierzes
Vlera e Buxhetit ne total	120.000 Euro (studimi dhe projekti)

1. Sfondi dhe analizimi i projektit

Turizmi është prioriteti kryesor i Strategjise Rajonale të Zhvillimit të Rajonit Kukës dhe Liqeni i Fierzes është nje nder zonat prioritare për zhvillimin e turizmit.

Liqeni artificial i Fierzës, me një bosht gjatësor prej 70 km, sipërfaqe prej mijë hektarësh, thellësi deri 128 m dhe volum uji 2.7 miliard m³, është më i madhi në Shqipëri. Liqeni u krijua në vitin 1978 mbi lumin e Drinit për HEC- in e Fierzës dhe për rregullimin furnizimit me ujë të dy hidrocentraleve të tjerë të kaskadës së Drinit, Komanit dhe Fierzës.

Shërben edhe si nje lidhëse mes Kukësit, Tropojës, Hasit dhe Kukës. Ai është habitati i 13 llojeve të ndryshme peshqish , shumë lloje molusqesh, gaforresh dhe amfibësh. Udhëtimi me traget apo jaht në ujërat e tij është i magjishëm, pamjet që shpalosen befasisht në brigjet janë mbresëlënëse dhe të paharrueshme. Disa prej bizneseve turistike ne brigjet me te bukur ofrojne pushim te kendshem , ushqim te shijshem tradicional dhe turizem balnear ne ujerat e embla te liqenit .

Ky projekt duke u bazuar tek oferta qe ofron kjo zone synon jo vetem ne zhvillimin e zones si atraksion turistik por edhe ne rritjen e ndjeshme ekonomike per banoret e zonave perreth. Nepermjet anijes do lehtesohet qarkullimi uJOR si per banoret e zones ashtu edhe per vizitoret te vendit dhe te huaj.

Qëllimi i Projektit

Ky projekt ka për qëllim të zhvilloje uinfrastrukturen per ankorimin e varkave apo trageteve te lundrimin liqenor, qe sigurojne lundrimin neper liqen dhe shkurtojne distancat per zonat qe ndodhen pergjate brigjeve.

2. Objektivi(at) specifik te projektit

OS1: Kthimi i Liqenit te Fierzes ne atraksion turistik shfrytezues

OS4: Rritjen e numrit te vizitoreve ne Kukës

3. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit

R1: Rritja e numrit te punesuareve

R2: Zhvillimi i transportit uJOR

R3: Shfrytezim racional te pasurive natyrore

R5: Promovimi i zones

4. Aktivitetet e projektit

1. Studimi dhe projektimi per ngritjen e nje moli per ankorimin e varkave dhe trageteve per lundrimin liqenor. .



5. Kostot e projektit

Nr.	Aktivitetet	Buxheti per aktivitet
1	Studimi i zones nga specialiste te fushes dhe agjensite turistike per percaktimin e itenerareve.	120,000
TOTALI		120.000

10. Titulli I projektit	<i>Peshkezimi artificial I Liqenit te Fierzes dhe ujembledheseve te Zonës së Kukësit</i>
Lloji I projektit	Mjedisor – Zhvillim I Ekonomise Lokale
Vendodhja e projektit	Kukës
Vlera e Buxhetit ne total	200.000 Euro

1. Sfondi dhe analizimi I projektit

Vitet e fundit eshte vene re nje varferim krahasimisht i madh i mjediseve ujore me peshk si burim i mirefillte mireqenieje e te ardhurash nga punesimi. Kjo ka ardhur si pasoje edhe e peshkimit te pakontrolluar, por edhe si pasoje e mos furnizimit me peshk (rasate) te liqenit. Pervojat evropiane kane treguar se te gjitha zonat rurale qe kane shfrytezuar siperfaqet ujore ne akuakulture kane pasur nje bum ekonomik te dukshem.

Peshkimi pa kriter nga banoret e zones dhe mjetet e perdorura kane sjell reduktim te llojit te peshkut ne liqenin e Fierzes. Para viteve 90 ka qene ndermarrja e peshkimit me qender ne Shkoder dhe filial ne Kukës qe mbronte dhe kultivonte rasatin e peshkut. Kjo ndermarrje nuk ekziston me duke qene keshtu nje faktor tjeter qe ka ndikua ne reduktimin e peshkut. Lind nevoja e nje studimi dhe kthimin e rezervateve te vogla kryesisht te rezervuareve ekzistues ose dhe krijimin e rezervuareve te rinj.

2. Objektivi(at) specifik te projektit

OS1: Rritja e prodhimtarise peshkore ne Liqenin e Fierzes dhe te gjithë Ujembledhesit e tjere te Rajonit.

OS2: Ngritja e nivelit ekonomik te gjithë komunitetit te popullsisë banuese perreth pellgut ujembledhes te Liqenit..

OS2: Rindertimi dhe venia ne funksion e Qendres artificiale te kultivimit te larvave dhe rasateve te peshqeve.

3. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit

R1: Ekonomia e peshkimit ne liqenin e Fierzes eshte rehabilituar

R2: Rritje te te ardhurat e familjeve qe jetojne me peshkim.

R3: Legalizim i peshkimit personal dhe industrial

R4: Permiresim ne aspektin mjedisor permes pasurimit te faunes ne Liqeni e Fierze

4. Aktivitetet e projektit

1. Takime dhe seminare me grupet e interesit



2. Studim, projektim dhe rehabilitimin i rezervuareve të qendres së prodhimit industrial të akuakultures
3. Sensibilizim dhe takime bashkepunimi për parandalimin e demtimit të rasteve

Projekti mendohet të zbatohet në një periudhë 2 vjeçare

5. Maturimi i projektit

Aktualisht i vetmi projekt që po zbatohet është nga shoqata e peshkatave dhe lidhet me trajnimin e të rinjve për kultivimin dhe rritjen e peshkut.

6. Kostot e projekti (euro)

<i>N</i> <i>r</i> <i>.</i>	<i>Aktivitetet</i>	<i>Buxheti</i> <i>per</i> <i>aktivitet</i>
2	Studim, projektim dhe rehabilitimin i rezervuareve të qendres së prodhimit industrial të akuakultures	180.000
3	Sensibilizim dhe takime bashkepunimi për parandalimin e demtimit të rasteve	20.000
TOTALI		200,000

<i>11. Titulli i projektit</i>	<i>Përmirësimi i infrastruktures së Gjellbrimit të Qytetit të Kukësit</i>
Lloji i projektit	<i>Përmirësim infrastrukture</i>
Vendodhja e projektit	<i>Kukës</i>
Vlera e Buxhetit në total	<i>50.000 euro</i>

1. Sfondi dhe analizimi i projektit

Qyteti i Kukës është një qytet ku mungesa e ambjenteve të gjelbërta dhe zonave të sistemuara të gjelbërta duket ndjeshëm. Me iniciativën e Prefektit të Kukës është përgatitur projekti për rehabilitimin e sheshit kryesor të qytetit të Kukës, “Skënderbej”, projekt që parashikon, që të rehabilitojë dhe funksionalizojë një nga sheshet kryesorë të qytetit. Megjithatë nevojitet të kryhen nderhyrje dhe në zonat midis lagjeve të qytetit për të rritur sipërfaqen e hapsirave të gjelbërta.

Drejtoria e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Kukës në zbatim të programit të punës për shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta dhe drurëve dekorativ në qytet është në proces të mbjelljes së drurëve dekorativ të llojit “bli” në rrugët e Lagjes së Re. Deri në përfundim të programit mbeten për tu mbjellë dhe 95 rrënjë bli. Por me qëllim të rritjes së zonave të gjelbërta dhe përmirësimit të cilësive të ajrit e pamjes së qytetit nevojitet shtimi i zonave të gjelbërta në lagje të tjera.

2. Objektivi(at) specifik të projektit

- OS1:** Zgjerimi i zonave të gjelbërta të qytetit.
OS2: Krijimi i ambjenteve me të pastra dhe clodhese

3. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit

4. Aktivitetet e projektit

1. Krijimi i një komisioni me specialist të mjedisit
2. Përcaktimi i temave të trajnimeve për nxënësit dhe studentat e qytetit
3. Organizimi i Trajnimeve
4. Përzgjedhja e vendeve ku do të nderhyhet në shtimin e ambjenteve të gjelbërta



5. Percaktimi I llojeve te drureve qe do te mbillen
6. Blerja dhe mbjellja e fidaneve

5. Maturimi I projektit

Ekziston nje Projekt Ide per projektin

6. Kostot e projektit

Kostoja e projektit afro 50.000 Euro.

12.Titulli I projektit	<i>Ngritja e zyrës së informimit qytetar dhe zyra me një ndalesë</i>
Lloji I projektit	<i>Permiresim I sherbimit te bashkise ndaj qytetareve</i>
Vendoddhja e projektit	<i>Bashkia Kukës</i>
Vlera e Bugjetit ne total	<i>73,000 Euro</i>

1. Sfondi dhe analizimi i projektit

Gjatë dekadës së fundit, reformat e ndërmara nga Qeveria Qëndrore (regjistrimin e biznesit, licencave dhe lejeve të reformave, reforma autorizimit, etj) në mënyrë që të krijojnë një ambient miqësor dhe jo-burokratike si për biznesin dhe qytetarët, kaë prekur dhe janë përfshire edhe nën kompetencat e qeverisjes vendore. Është evoluar në mënyrë të konsiderueshme në drejtim të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe zgjidhjet e tjera inovative (ex: zyrat me një ndalesë) në ofrimin e shërbimeve publike dhe menaxhimin e brendshëm, por përdorimi i IT dhe zgjidhjeve të reja në qeverisjen vendore është mjaft i kufizuar dhe kryesisht. Bashkia e Kukësit deri më sot nuk ka mundur të ngrejë një strukturë të tillë e cila ka si qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve.

Në Bashkinë e ardhshme të Kukësit, nëpërmjet vendosjes në dispozicion të tyre të një stafi të specializuar i cili do të bëjë të mundur që kërkesat dhe problemet që ata kanë të marrin zgjidhje sa më të shpejtë. Me ndërtimin e kësaj zyre evitohet humbja e kohës nga qytetarët dhe bëhet e mundur rritja e cilësisë së shërbimit që ata do të marrin.

2. Objektivi specifik i projektit

Krijimi i infrastrukturës së nevojshme me qëllim lehtësimin e ofrimit të shërbimeve qytetarëve me qëllim ofrimin në kohë të shkurtër dhe rritjen e cilësisë së shërbimit.

3. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit

- R1:** Krijimi i mjediseve fizike modern te ofrimit të shërbimit ndaj publikut
- R3:** Menaxhim i përmiresuar i proceseve të punës dhe procedurave per ofrimin e sherbimeve ndaj komunitetit
- R4:** Instalimin e nje sitemi te integruar te informimit dhe komunikimit me publikun
- Zyra me një ndalesë do ti shërbejë gjithë qytetarëve të Bashkisë Kukës.*
- Nga ndërhyrja do të përfitojë Bashkia e Kukësit e cila me reformën e re territorial do të jetë edhe struktura qëndrore.*

4. Aktivitetet e projektit

- 1 Zhvillimi i projektit të detajuar për punimet e rehabilitimit dhe ndërtimit te ambjenteve fizike ndërhyrjes fizike.
- 2 Punimet për rehabilitimin fizik të ambjenteve ekzistuese



- 3 Pajisja me kompjutera dhe pajisje zyre
- 4 Instalimi i programeve softëare për kominikimin e integruar
- 5 Trajnime te ndryshme per stafin e bashkise dhe ZNJ
- 6 Prodhimi i materialeve informuese fletepalosje, guida etj.

5. Maturimi i projektit

Ekziston projekt ideja e zhvilluar nga Bashkia e Kukësit.

6. Kostot e projektit (euro)

<i>Nr.</i>	<i>Aktivitetet</i>	<i>Buxheti per aktivitet</i>
1	Zhvillimi i projektit të ndërhyrjes fizike .	3,000
2	Punimet për rehabilitimin fizik të ambjenteve ekzistuese	30000
3	Pajisja me kompjutera dhe pajisje zyre	10,000
4	Instalimi i programeve softëare për kominikimin e integruar	5000
5	Trajnime te ndryshme per stafin e bashkise dhe ZNJ	20000
6	Prodhimi i materialeve informuese fletepalosje, guida etj.	5000
TOTALI		73,000